



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Mbi përputhshmërinë e zbatimit të kontratës koncesionare për Markimin e Karburanteve”**

# **Raport Përfundimtar Auditimi**

**“Mbi përputhshmërinë e zbatimit të kontratës koncesionare për Markimin e Karburanteve”**

**Tiranë, Maj 2024**

<u>Nr.</u>	<u>PËRMBAJTJE</u>	<u>Faqe</u>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3</b>
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3	Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	4
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	<b>8</b>
1	Objekti i auditimit dhe qëllimi i auditimit.	8
2	Identifikimi çështjes	8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
4	Përgjegjësitë e audituesve	9
5	Kriteret e vlerësimit	9
6	Standardet e auditimit	10
7	Metodat e auditimit	10
8	Dokumentimi i auditimit	11
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>11</b>
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	11
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	12
2.1	<b>Auditimi i fazës së propozimit dhe miratimi i projektit</b>	<b>12</b>
2.1.1	Auditimi i propozimit të koncesionit, vlerësimit dhe vendimmarrjes për pranimin e tij	12
2.2	<b>Auditimi i fazës procedurale së prokurim publik dhe lidhja e kontratës</b>	<b>23</b>
2.2.1	Mbi përputhshmërinë e procedurës së prokurimit publik të kontratës me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës	23
2.2.2	Mbi vlerësimin e elementëve në kuadër të lidhjes së kontratës dhe ristrukturimi i saj	27
2.3	<b>Auditimi i zbatimit i kontratës</b>	<b>30</b>
2.3.1	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për koncesionin dhe identifikimi i risqeve nga ana e strukturave përgjegjëse	30
2.3.2	Auditimi i fazës së investimit të koncesionit	40
2.3.3	Akt Verifikim mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratës	48
2.4	<b>Auditimi i amendimit të kontratës</b>	<b>51</b>
2.4.1	Auditimi i amendimit të kontratës për një periudhë 1 vjeçare, mbi arsyet dhe kushtet që çuan në zgjatjen e kontratës	51
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	<b>60</b>

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 645/1, datë 11.09.2023, i ndryshuar me nr.645/2 Prot., datë 30.10.2023, miratuar nga Kryetari të Kontrollit të Lartë të Shtetit, u auditua Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, mbi “Mbi përputhshmërinë e zbatimit të kontratës koncesionare për Markimin e Karburanteve”.

### **I.2. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi**

-Dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit nuk ishte i inventarizuar, përbëhej kryesisht nga dokumentacion jo origjinal (i fotokopjuar), korrespondencat nuk ishin të plotësuara si një praktikë e vetme, si dhe disa prej dokumenteve ishin në formate të papërfunduara në versionin final.

-Propozimi i pakërkuar për dhënien me koncesion të këtij shërbimi nuk rezultoi të jetë mbështetur në prioritetet strategjike të qeverisë për periudhën në fjalë deri në momentin e propozimit për dhënien me koncesion të këtij shërbimi, nuk rezultoi të jetë kryer një studim me analiza të nevojshme kosto-përfitimit nga strukturat përkatëse, për të parashikuar kostot respektive të këtij shërbimi, për të identifikuar nëse ky projekt ka qenë i përballueshëm për buxhetin e shtetit dhe për të vlerësuar mbrojtjen e interesit të konsumatorëve lidhur me sasinë, cilësinë dhe nivelin e tarifës të aplikuar për këtë shërbim të markimit të karburanteve.

-Gjatë analizimit të zhvillimit të procedurës së dhënies me koncesion të procesit të markimit të karburanteve, nuk janë përfshirë dhe konsideruar grupet e interesit si në rastin e Shoqatës së Shoqërive të Hidrokarbureve, të cilët me anë të shkresës nr. 19279 Prot., datë 10.12.2012, kërkojnë të përfshihet si palë e interesuar për shqyrtimin e kontratës së koncesionit në marrjen e mendimeve dhe konsultimet nga Grupi i Identifikimit të Projektit (GIP), duke listuar dhe disa shqetësime në lidhje me qëllimin e kontratës së koncesionit. Gjithashtu dhe nga ana e Ministrisë së Financave, GIP, nuk i është kërkuar mendim/informacion shoqërive naftë nxjerrëse (si: B. P. A LTD), si palë kryesore interesi, duke sjellë problematika në procesin e zbatimit të koncesionit.

-Raporti përmbledhës i hartuar dhe i miratuar nga GIP gjatë fazës së zhvillimit të procedurës së koncesionit, nuk përmban analiza të kryera për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe të monitorimit. Vlerësimi i kryer nga GIP është sipërfaqësor, përmbledhës, paraqet vetëm konkluzione dhe nuk shoqërohet me studim të plotë në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga shoqëria G. F. I.

Nga auditimi i i procedurave të koncesionit, ka rezultuar se nuk janë zgjidhur apo marrë në konsideratë problematikat e lidhura me markimin e naftës bruto si dhe monitorimin e produktit solar/mazut, çështje këto të ngritur që në fillim të propozimit të pa kërkuar.

-Kontrata nuk parashikon formate tip raportimi se çfarë konkretisht duhet të monitorohet dhe si duhet të kryhet ky monitorim nga menaxheri i projektit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e më pas Ministria e Financave, pra mungojnë treguesit e matshëm të efektivitetit/performancës së këtij koncesioni.

-Ministria e Financave nuk ka ngritur një grup pune (të përhershëm për afatin e kontratës të miratuar me VKM nr. 200 datë 13.03.2013) për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate me

specialistë të fushës, ku të përfshiheshin së paku një ekonomist, një jurist dhe një inxhinier i fushës, me ndarje të qartë të detyrave, për mbikëqyrjen e përshtatshme të zbatimit të kontratës. -Sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë Koncesionare, për periudhën 2013 – 2022, rezultoi se nuk është ndjekur struktura e investimeve e paraqitur në shtojcën nr. 5 të Kontratës Koncesionare “Plani i Investimeve”, duke krijuar problematika në verifikimin e investimeve për zërat specifik. Gjithashtu referuar të dhënave të Pasqyrave Financiare rezulton së realizimi i investimeve është në masën 68%.

### **I. 3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit**

Ky auditim u krye në Drejtorinë e Koncesionit në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, për nënshkrimin dhe zbatimin e kontratën koncesionare “Për Shërbimin E Markimit dhe Monitorimit Të Karburanteve”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “G. F. I.” S.A. dhe “P. C. P” A.G” të miratuar me VKM nr. 200, datë 13.03.2013.

Procesi i auditimit u shtri edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në cilësinë e Autoritetit sipas VKM nr. 498, dt. 30.05.2013, “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, neni 1, pika 1.1.

Auditimi i Kontratës Koncesionare për Markimin e Karburanteve, është iniciuar mbi bazën e kërkesës për dokumentacion mbi fazën procedurale dhe dokumentacionin mbi zbatimin e kontratës. Gjatë kësaj fazë të mbledhjes së dokumentacionit, grupi i auditimit hasi vështirësi në mbledhjen e dokumentacionit dhe informacionit, pasi kontrata është e shtrirë në kohë për një periudhë 10 vjeçare, si dhe personat përgjegjës mbi ezaurimin e fazës procedurale nuk janë më në marrëdhënie pune me institucionin e Ministrisë së Financave. Gjithashtu grupit të auditimit, nga zyra e protokoll arkivës së institucionit, iu vu në dispozicion kopje e dokumentacionit (jo dokumente origjinale), pa një shkresë inventarizimi, pa një numër rendor protokollit dhe datë, dokumente të shpërndara në dosje të ndryshme.

Konstatime kryesore sipas drejtimeve të auditimit:

#### **I. Auditimi i fazës së propozimit dhe miratimi i projektit**

- Në lidhje me dokumentacionin e kërkuar nga grupi i auditimit, zyra e protokoll arkivës së institucionit, vuri në dispozicion kopje të dokumentacionit (jo dokumente origjinale), pa një shkresë inventarizimi, pa një numër rendor protokollit dhe datë, dokumente të shpërndara në dosje të ndryshme. Grupi i auditimit mori në shqyrtim kopjen e dokumentacionit, sistemimin e tyre, duke nxjerrë në dukje dokumentacionin me fashikujt që mungonin.
- Në lidhje me propozimin e pakërkuar, Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion fotokopje e dokumentit në gjuhën angleze në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Vendimin nr. 4, datë 19.6.2017, neni 4, pika 9, “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” “Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj”.

- Referuar sa më sipër propozimi i pa kërkuar për dhënien me koncesion të këtij shërbimi nuk rezulton të jetë mbështetur në prioritetet strategjike të qeverisë për periudhën në fjalë deri në momentin e propozimit për dhënien me koncesion të këtij shërbimi, nuk rezultoi të jetë kryer një studim me analiza të nevojshme kosto-përfitimit nga strukturat përkatëse, për të parashikuar kostot respektive të këtij shërbimi si dhe për të identifikuar nëse ky projekt ka qenë i përballueshëm për buxhetin e shtetit.
- Bazuar në datën e ardhjes të propozimit të pakërkuar nga G. I. F., që është data 07.12.2010, titullari i AK nuk ka respektuar afatin e përcaktuar në ligjin nr. 9663, dt.18.12.2006, neni 23, pika 2/a, i ndryshuar ku citohet: brenda 90 ditëve pas marrjes dhe shqyrtimit fillestar të propozimit të pakërkuar, autoriteti kontraktues përcakton nëse projekti koncesionar paraqet interes publik dhe për këtë vë në dijeni propozuesin.
- Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve me anë të shkresës nr. 19279 Prot., datë 10.12.2012, kërkon të jetë pjesë e grupit të punës për shqyrtimin e kontratës së koncesionit si palë e interesuar në marrjen e mendimeve dhe konsultimet nga GIP, duke listuar dhe disa shqetësime në lidhje me qëllimin e kontratës së koncesionit. Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion përgjigje nga përfaqësues të MFE në lidhje me shkresën e mësipërme, duke krijuar neglizhencë nga GIP në lidhje me detyrat e përcaktuara dhe qëllimin e krijimit të GIP. Gjithashtu nga ana e Ministrisë së Financave, GIP, nuk i është kërkuar mendim/informacion shoqërive naftënxjerrëse (si: B. P. A LTD), si palë kryesore interesi, duke sjellë problematika në procesin e zbatimit të koncesionit. (shtjelluar në Akt Konstatimet mbi zbatimin e kontratës).
- Raporti përmbledhës nuk përmban analiza të kryera nga GIP për marrjen me koncesion të shërbimit të markimit dhe të monitorimit. Vlerësimi i kryer nga GIP është sipërfaqësor, përmbledhës, paraqet vetëm konkluzione dhe nuk shoqërohet me studim të plotë në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga shoqëria G. F. I..
- Bonusi i pikëve në masën 8% i propozuar nga grupi i punës, për shoqërinë G. F. I. nuk krijon bindjen për mënyrën e vendosjes së pikëve, bazuar në kriteret e përcaktuara në urdhër. Gjithashtu me VKM nr. 609, dt. 24.08.2011 *“Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë”* u miratua bonusi i ndryshëm nga ai i propozuari pa një argumentim bashkëlidhur, konkretisht në masën 6% të pikëve për rezultatin teknik e financiar që i jepet shoqërisë propozuese.

## **II. Auditimi i fazës procedurale së prokurim publik dhe lidhja e kontratës**

- Në përbërjen e komisionit të vlerësimit të ofertave janë emëruar anëtare të cilët kanë marrë pjesë në komisionin e hartimit të dokumenteve të procedurës konkurruese, konkretisht znj. A. D., në kundërshtim me VKM nr. 27. Dt.19.01.2007, *“Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”* Kreu VIII, pika 1, i ndryshuar.
- Në raportin përmbledhës mbi vlerësimin e ofertave të projektit *“Për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë”* nr. 14859 Prot., datë 18.09.2012 citohet shqyrtimi i dokumentacionin ligjor dhe kualifikues por nuk listohet dokumentacioni i kërkuar konform kërkesave ligjore konkretisht VKM nr. 27. Dt.19.01.2007, *“Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”* Kreu

IX, pika 2 germa b, i ndryshuar. Gjithashtu siç citohet në raportin përmbledhës mungojnë testet fizike të kërkuara.

- Nga njoftimi i fituesit të publikuar deri në momentin e nënshkrimit të kontratës, ka kaluar një periudhë 5 mujore. Grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion procedura e plotë e ndjekur për negocimin e kontratës që nga ftesa për ofertues deri në lidhjen e kontratës, përfshirë dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave për caktimin e afateve të negocimit të kontratës”
- Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni mbi mbledhjet e mëposhme lidhur me negocimin e kontratës, si dhe procedurat e ndjekura nga Grupi i Punës deri në publikimit e VKM nr. 200, datë 13.03.2013 për “Miratimin e Kontratës së Koncesionit për Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “G. F. I.” S.A dhe “P. C. P.”A.G.”
- Në asnjë moment nuk ka trajtuar apo të marrë në konsideratë çështjen e markimit të naftës bruto si dhe monitorimin e solar/mazut, çështje këto të ngritura që në fillim të propozimit të pakërkuar.
- Kontrata nuk parashikon formate tip raportimi se çfarë konkretisht duhet të monitorohet dhe si duhet të kryhet ky monitorim nga menaxheri i projektit, DPD e më pas MFE, pra mungojnë treguesit e matshëm të efektivitetit / performancës së këtij koncesioni.
- Kontrata ka përcaktuar se koncesionari do të dorëzojë në përfundim të kohëzgjatjes së koncesionit tek Autoriteti Kontraktor të gjitha asetet e krijuara, të reja apo të rikonstruara së bashku me sistemet hardware dhe software me kushtin që të jenë funksionale dhe të ofrojnë të njëjtat cilësi shërbimi.
- Kontrata nuk parashikon se si do të procedohet me transferimin e pronësisë intelektuale apo teknologjisë sekrete (Solucioni i markimit të përdorur nga koncesionari), duke evidentuar kështu një risk të shtuar nëse në përfundimin e kontratës të gjitha asetet sistemet hardware dhe software do të rezultojnë jofunksionale duke sjellë pamundësinë e vijimit të ofrimit të shërbimit me largimin e Koncesionarit.
- Kontrata nuk ka parashikuar masa për parandalimin e lënies si kolateral të aseteve të kësaj kontrate për qëllimet e angazhimeve financiare të shoqërisë Koncesionare, duke përbërë kështu një risk të shtuar mbi efektet negative që mund t’i shkaktohen buxhetit të shtetit dhe funksionimit normal të këtij koncesioni.
- Kontrata nuk ka parashikuar penaltete për koncesionarin në rastet kur shërbimet e markimit dhe të monitorimit të ofruara nuk janë në përputhje me ofertën teknike, me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DSK si dhe përcaktimet e Shtojcës nr. 4 të kësaj kontrate.
- Me shkresën nr. 19279 prot., datë 10.12.2012 Shoqata e Hidrokarbureve i është drejtuar Ministrisë së Financave duke kërkuar përfshirjen e përfaqësuesve të tyre në grupin e punës, si palë e interesuar. Gjithashtu shoqata ka shprehur disa nga shqetësimet e saj në lidhje me implementimin e sistemit të markimit.
- Grupi i punës nuk ka marrë në konsideratë kostot shtesë që vijnë si rezultat i implementimit të sistemit operativ të markimit të karburantit dhe cila palë do të marrë përsipër mbulimin e këtyre kostove.

### **III. Auditimi i zbatimit i kontratës**

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e Autoritetit sipas VKM nr. 498, dt. 30.05.2013, neni 1, pika 1.1 dhe Ministria e Financave, në cilësinë e autoritetit kontraktor dhe institucionit mëmë qendror të DPD, nuk kanë ngritur një grup pune (të përhershëm për afatin e kontratës) për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate me specialistë të fushës, ku të përfshiheshin së paku një ekonomist, një jurist dhe një inxhinier i fushës, me ndarje të qartë të detyrave, për mbikëqyrjen e përshtatshme të zbatimit të kontratës.
- Edhe pse në kontratë është përcaktuar detyrimi i shoqërisë koncesionare për të garantuar trajnime të doganierëve shqiptarë, nga auditimi u konstatua se nuk është miratuar asnjë plan veprimi apo plan trajnimi, për të përcaktuar periodicitetin dhe shtrirjen e këtyre trajnimeve, me qëllim aftësimin e punonjësve të doganës në procesin e markimit dhe monitorimit të karburantit;
- Përpos mungesës së dokumentuar të hartimit dhe miratimit të planit të trajnimeve, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion apo procesverbal mbi trajnimet e ushtruara apo tematikat e trajnimeve.
- Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion informacion shtesë mbi ndryshimet dhe emërimet e Menaxherëve të Projektit përgjatë kohëzgjatjes së Kontratës Koncesionare.
- Mospërputhje ndërmjet zërave të aktiveve të raportuara në pasqyrat financiare të Shoqërisë Koncesionare dhe planit të investimit të paraqitur në shtojcën nr. 5 të Kontratës Koncesionare.
- Mungesë e informacionit në pasqyrat financiare me ndryshimet e ndodhura gjatë viteve në klasën e Aktiveve Afatgjata.
- Mungesë e informacionit mbi përmbushjen e detyrimit të shoqërisë koncesionare për kryerjen e investimit sipas afateve të përcaktuara në Aneksin 1 të Planit të Investimit

### **IV. Auditimi i amendimit të kontratës**

- Problematikat e këtij koncesioni nisin që në propozimin e projekt-idesë nga grupi i identifikimit të propozimit për markimin e monitorimin e naftës bruto si dhe solar/mazut. Nuk është marrë në konsideratë fakti se nafta bruto është një aset që nuk zotërohet nga shteti shqiptarë për rrjedhojë nuk lindin pretendime mbi përdorimin e këtij aseti. Nafta bruto nuk përfshihet si objekt i akcizës. Problematikë e cila vijon edhe me propozimet për amendimin e kontratës dhe në miratimin e saj.
- Gjithashtu nga ana e Ministrisë së Financave, GP, nuk i ka kërkuar mendim/informacion shoqërive (si: B. P. A LTD) dhe Shoqërisë së Hidrokarbureve.
- Në asnjë moment nuk u mor në konsideratë një vlerësim teknik mbi zbatimin e detyrimeve respektive të kontratës koncesionare. Në amendimin e kontratës u morën në konsideratë vetëm pretendimet e G. F. I. në lidhje në mosplotësimin e kushteve të kontratës dhe jo anasjelltas.
- Nuk janë ndërmarrë veprime konkrete për të eliminuar pengesat e hasura për zbatim të plotë të kontratës si shkak -pasojë e veprimeve /mosveprimeve që në miratimin e kontratës dhe amendimit të saj.
- Autoritetet përgjegjëse nuk kanë një analizë mbi efektivitetin apo përfitimet e shtetit shqiptar nga kjo kontratë që me nënshkrimin e saj.
-

## **II. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 645/1, datë 11.09.2023, i ndryshuar me nr.645/2 Prot., datë 30.10.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, u krye auditimi mbi “Mbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë Financiare të Zbatimit të Kontratës Koncesionare për Markimin e Karburanteve”, nga grupi i auditimit:

- E. K. (*Përgjegjës Grupi*)
- K. H. (*anëtarë*)
- T. Gj. (*anëtarë*)
- A. Xh. (*anëtarë*)
- G. G. (*anëtarë*)
- E. Sh. (*anëtarë*)

Zhvillimi i auditimit është asistuar edhe nga konsulentët e angazhuar, R. A. Sh.p.k në kuadër të kontratës së shërbimit të konsulencës Nr.352/14 Prot. Datë 11.10.2022, e lidhur midis Kontrollit të Lartë të shtetit dhe R. A. Sh.p.k., të financuar nga Sekretariati i Shtetit për Bashkëpunim Ekonomik (SECO i Zvicrës).

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

### **Objekti dhe qëllimi i auditimit:**

Objekti i auditimit është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë, dhe rregullshmërisë financiare të kontratës koncesionare, nëpërmjet një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen në të gjitha aspektet materiale me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj. Qëllimi i auditimit është raportimi mbi gjetjet dhe konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit nëpërmjet sigurimit të një evidence të mjaftueshme, të saktë dhe të plotë, mbështetur për standardet e auditimit (ISSAI/FPP-100,400,4000), ku ne të japim siguri të arsyeshme, në dhënien e opinionit të auditimit nëse subjekti i audituar ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe të evidentojmë devijimet nga kriteret e pranuar, shkeljen e parimeve të rregullshmërisë dhe korrektësisë/përshtatshmërisë, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese.

### **Identifikimi i çështjes:**

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë që lidhet me këtë koncesion nga propozimi i tij, deri në 31.12.2023, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e tij.

Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e strukturës përkatëse pranë MFE dhe DPD të cilat monitorojnë ecurinë e realizimit të objektivave dhe detyrimeve të kësaj kontrate, masat e marra në rastet e konstatimit të mos zbatimit të tyre, etj.



**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:**

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Nga Ministria e Financave, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të kësaj kontrate, përgjegjësitë e strukturave lidhur me këtë kontratë përfshijnë kryesisht strukturat pranë Drejtorisë së Koncesioneve si përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare si dhe zyrtarët e përfshirë për marrjen në konsideratë të propozimit të pa kërkuara deri në lidhjen e kontratës si dhe të amendimit të kushteve të saj.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e monitoruesit të zbatimit të kontratës.

**Përgjegjësitë e audituesve:**

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

**Kriteret e vlerësimit:**

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

Kushtetuta dhe Ligji nr. 154.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Urdhri i Ministrit të Financave nr. 64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” ;

Rregullore e Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;

Ligji Nr. 9663, datë 08.12.2006, i ndryshuar “Për koncesionet”;

Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar

Rregullore e Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;

Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;

Vendim nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”

VKM nr. 200, datë 13.03.2013 për “Miratimin e Kontratës së Koncesionit për Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve

### **Standardet e auditimit:**

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*“ që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*“ që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.

### **Metodat e auditimit:**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera ,me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimet e auditimit;

c. Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

d. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

### **Dokumentimi i auditimit:**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

## **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**

Koncesionari ka paraqitur më 07.12.2010 një propozim të pakërkuar në lidhje me Koncesionin e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit të karburanteve, propozim i cili është pranuar nga Autoriteti Kontraktual, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka pranuar përmes Vendimit Nr. 609, datë 24.08.2011, “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me Koncesion të shërbimit të Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë”, dhënien me Koncesion të Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve në Republikën e Shqipërisë duke përcaktuar Ministrinë e Financave si Autoritetin Kontraktues;

Objekti i Koncesionit është kryerja, nga Koncesionari, e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit, për qëllime fiskale, në Republikën e Shqipërisë. Shërbimi i Markimit dhe Monitorimit do të kryhet mbi Produktet e Markimit dhe Monitorimit të përcaktuara në Aneksin VII, pika 2, të Dokumenteve të procedurës së konkurrimit për dhënien e Koncesionit “Mbi shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë”, të përfshira në Shtojcën 4 të Kontratës “Shërbimet e Markimit dhe Monitorimit”.

Çmimi i Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit për njësi do të jetë 614 (gjashtëqind e katërmbëdhjetë) Lekë për 1000 (njëmijë) Litra të markuar (pa TVSH).

Koncesionari do të jetë përgjegjës për ofrimin e Shërbimeve të Markimit dhe Monitorimit, të cilat specifikohen në mënyrë të detajuar në Shtojcën 4 të Kontratës “Shërbimet e Markimit dhe Monitorimit”, ndaj çdo Subjekti të Detyruar. Koncesionari do të jetë përgjegjës për krijimin dhe administrimin e një rrjeti pikash shitjeje ku Subjektet e Detyruara, do të drejtohen për blerjen e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit dhe pagesën e Çmimit. Koncesionari mbledh drejtpërdrejt Çmimin e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit.

Subjektet e Detyruara, do t'i paraqesin Koncesionarit një dokument që provon pagesën e Çmimit të Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit, në mënyrë që të përfitojnë nga Koncesionari Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit.

Koncesionari çdo muaj do t'i japë Autoritetit Kontraktues një përmbledhje të detajuar në lidhje me sasinë e karburantit të markuar dhe monitoruar gjatë muajit paraardhës.

Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues një Tarifë Koncesionare të barabartë me 2.5% (dy pikë pesë përqind) të ardhurave vjetore që realizohen nga shitja e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit, siç rezulton nga Pasqyrat Financiare të po atij viti.

Tarifa Koncesionare do të paguhet nga Koncesionari brenda 4 (katër) muajve të parë të secilit vit kalendarik bazuar në Pasqyrat Financiare të audituara, nëse është e aplikueshme, që i përkasin vitit financiar paraardhës.

Kohëzgjatja e Koncesionit është 10 (dhjetë) vjet duke filluar nga Data Efektive.

## **2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit**

Ky auditim u krye në Drejtorinë e Koncesionit në Ministrinë e Financave, për nënshkrimin dhe zbatimin e kontratës koncesionare “Për Shërbimin E Markimit dhe Monitorimit Të Karburanteve”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “G. F. I.” S.A. dhe “P. C. P” A.G” të miratuar me VKM nr. 200, datë 13.03.2013.

Procesi i auditimit u shtri edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në cilësinë e Autoritetit sipas VKM nr. 498, dt. 30.05.2013, “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, neni 1, pika 1.1.

Auditimi i Kontratës Koncesionare për Markimin e Karburanteve, është iniciuar mbi bazën e kërkesës për dokumentacion mbi fazën procedurale dhe dokumentacionin mbi zbatimin e kontratës. Gjatë kësaj fazë të mbledhjes së dokumentacionit, grupi i auditimit hasi vështirësi në mbledhjen e dokumentacionit dhe informacionit, pasi kontrata është e shtrirë në kohë për një periudhë 10 vjeçare, si dhe personat përgjegjës mbi ezaurimin e fazës procedurale nuk janë më në marrëdhënie pune me institucionin e Ministrisë së Financave. Gjithashtu grupit të auditimit, nga zyra e protokoll arkivës së institucionit, iu vu në dispozicion kopje e dokumentacionit (jo dokumente origjinale), pa një shkresë inventarizimi, pa një numër rendor protokollit dhe datë, dokumente të shpërndara në dosje të ndryshme. Grupi i auditimit mori në shqyrtim kopjen e dokumentacionit, sistemimin e tyre, duke nxjerrë në dukje dokumentacionin me fashikujt që mungonin.

### **2.1 Auditimi i fazës së propozimit dhe miratimi i projektit**

#### ***2.1.1 Auditimi i propozimit të koncesionit, vlerësimit dhe vendimmarrjes për pranimin e tij***

Dhënia me koncesion e shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë është iniciuar me dorëzimin pranë Ministrisë së Financave të Propozimit të pa kërkuar datë 07.12.2010 nga shoqëria G. F. I.

Operatori Ekonomik ka shprehur interes për të projektuar, ngritur dhe vënë në zbatim një sistem kombëtar për “*Markimin dhe monitorimin e karburanteve në Republikën e Shqipërisë*”. Sipas shkresës së operatorit, bashkëlidhur duhet të ishin profili i kompanisë dhe një prezantim i shkurtër për projektin e markimit dhe monitorimit të karburanteve. Grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion shkresa e plotë.

Me shkresën nr. 2188/2 Prot., datë 01.02.2011 Ministria e Financave informon operatorin ekonomik për shqyrtimin e propozimit të paraqitur në përputhje me procedurat e përcaktuara

në ligjin nr. 9663, dt.18.12.2006 “Për koncesionet” i ndryshuar, duke vijuar me tej me verifikimin e dokumentacioneve përkatëse në zbatim të kuadrit ligjor.

Bazuar në nenin 4, pika 1, i ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për Koncesionet” i ndryshuar, ky ligj zbatohet për dhënien e koncesioneve nga autoritetet kontraktuese për veprimtaritë ekonomike, në këta sektorë:

- a) në transport (hekurudhat, transportin hekurudhor, portet, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, parkimet, transportin publik);
- b) në prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike e të ngrohjes;
- c) në prodhimin, shpërndarjen dhe administrimin e ujit, në trajtimin, mbledhjen, shpërndarjen dhe administrimin e ujërave të zeza, ujitjen, drenazhimin, pastrimin e kanaleve e të digave;
- ç) në grumbullimin, transportimin, përpunimin dhe administrimin e mbetjeve të ngurta;
- d) në telekomunikacion;
- dh) në arsim dhe sport;
- e) në shëndetësi;
- ë) në turizëm dhe kulturë;
- f) në infrastrukturën e burgjeve;
- g) në projektet e riciklimit, rehabilitimit të tokës dhe pyjeve, në parqet industriale, të strehimit, të ndërtesave qeveritare, shërbimeve të mirëmbajtjes së teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturës së bazës së të dhënave;
- gj) në shpërndarjen e gazit natyror;
- h) në kontratat e administrimit apo në kryerjen e shërbimeve publike, përfshirë edhe ato të sektorëve të sipërpërmendur.

Bazuar në nenin 4, pika 2 ku citohet së “Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, autorizon zbatimin e koncesioneve edhe në sektorë të tjerë”, procedurat e ndjekura nga Ministria e Financave si zbatim i kësaj kërkesë ligjore, për përfshirjen në prioritetet strategjike të këtij shërbimi, nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit.

Ky shërbim deri në dhënien me koncesion realizohej nga Institucioni Qendror Teknik dhe drejtoritë e doganave.

Në vijim të shqyrtimit të propozimit të pakërkuar nga G. F. I., Drejtori i Drejtorisë së Legjislacionit znj. L. R. me anë të Memos së datës 13.01.2011 i sqaron Ministrit të Financave z. R. B. dhe Sekretarit të Përgjithshëm z. A. P. me anë të opinionit ligjor që sistemi kombëtarë për Amalizimin dhe vëzhgimin e karburanteve të naftës bruto nuk gjen mbështetje ligjore në nenin 4, pika 1 dhe në rastin konkret duhej një opinion teknik i specializuar nëse ky projekt do të sillte një impakt pozitiv për ekonominë.

Në vijim të korrespondencës, me anë të Memos së datës 19.01.2011, znj. L. R. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Legjislacionit i sqaron Ministrit të Financave z. R. B. që nuk kanë pasur informacion lidhje me “Amalizimin dhe vëzhgimin e karburanteve dhe naftës bruto” pasi shprehja është terminologji teknike e fushës. Në Memo theksohet edhe procedura që duhet të ndiqej nga Autoriteti Kontraktues për dhënien me koncesion të këtij shërbimi publik referuar propozimit të pakërkuar të shoqërisë G. F. I..

Me shkresën nr. 2531/1 Prot., datë 02.02.2011 Ministri i Financave z. R. B. i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve të caktojë përfaqësuesit respektivë për pjesëmarrjen në grupin e punës që do të shqyrtojë projektin e

propozuar me objekt “Analizimin dhe vëzhgimin e karburanteve dhe naftës bruto”.

Me shkresën nr. 2998/2 Prot., datë 09.02.2011 Ministri i Financave z. R. B. i drejtohet Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) të caktojë përfaqësuesit për pjesëmarrjen në grupin e punës që do të shqyrtojë projektin e propozuar me objekt “Analizimin dhe vëzhgimin e karburanteve dhe naftës bruto”.

Me shkresën nr. 2998/6 Prot., datë 14.02.2011 Ministri i Financave z. R. B. i drejtohet Ministrisë së Mjedisit të caktojë përfaqësuesit për pjesëmarrjen në grupin e punës që do të shqyrtojë projektin e propozuar me objekt “Analizimin dhe vëzhgimin e karburanteve dhe naftës bruto”.

Ministria e Mjedisit me shkresën nr. 891/1, datë 25.02.2011 konfirmon përfaqësuesin e saj në Grupin e Identifikimit të Propozimit për dhënien me koncesion të sistemit kombëtar me objekt “Analizimin dhe vëzhgimin e karburanteve dhe naftës bruto”.

Në vijim të procedurës Ministri i Financave me Urdhrin nr. 25, dt. 01.03.2011 ka miratuar ngritjen e Grupit për Identifikimin e Propozimit (GIP) për dhënien me koncesion të shërbimit të Amalizimit të karburanteve dhe të naftës bruto në Republikën e Shqipërisë .

Sipas urdhrin të Ministrit të Financave përbërja e Grupit të Punës për Identifikimit e Propozimit (GIP) është si më poshtë:

Znj. M. V.	Ministria e Financave	Kryetar
Z. Sh. H.	Ministria e Financave	Anëtar
Znj. A. D.	Ministria e Financave	Anëtar
Znj. S. T.	Ministria e Financave	Anëtar
Z. K. T.	Ministria e Financave	Anëtar
Z. S. L.	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	Anëtar
Z. A. B.	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	Anëtar
Z. B. B.	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	Anëtar
Z. S. V.	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Anëtar
Z. E. Gj.	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Anëtar
Znj. O. M.	ATRAKO	Anëtar
Z. K. A.	Ministria e Mjedisit	Anëtar

Grupi i mësipërm ka pasur një ndryshim në përbërje me urdhrin e Ministrit të Financave me nr. 25/1 datë 20.05.2011 me nr. 4882/1 Prot., ku anëtari i grupit të ATRAKO znj. O. M. është zëvendësuar me z. G. V..

Në përbërjen e grupit të mësipërm janë përfaqësuesit e institucioneve kompetente por në urdhër nuk specifikohen profesionet e përfaqësuesve për ti shërbyer detyrave të ngarkuara për shqyrtimin e propozimit të pakërkuar (specialist fushe konkretisht ekonomist, jurist, inxhinier apo teknik ose specialistë mjedisi).

Në përcaktimet e Urdhrin të titullarit të Ministrisë së Financave, GIP ka këto kompetenca:

- Identifikon propozimin dhe përcakton nëse projekti koncesionar paraqet interes publik;
- Vlerëson propozimin lidhur me përputhshmërinë e tij me objektivat strategjike kombëtare dhe sektoriale të zhvillimit;
- Vlerëson rentabilitetin dhe fizibilitetin e projektit të kërkuar me koncesion;
- Vlerëson propozimin dhe përcakton bonusin, në rastin e propozimeve të pa kërkuara, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 3 të Urdhrin.

Nga titullari i autoritetit kontraktor nuk është respektuar afati ligjorë për ngritjen e grupit të punës për identifikimin e propozimit konkretisht grupi i punës u ngrit me Urdhrin nr. 25, dt. 01.03.2011 “Për ngritjen e Grupit të Punës mbi Propozimin për marrjen me koncesion të projektit të Amalizimit të karburanteve dhe naftës bruto në Republikën e Shqipërisë”. Vonesat në kohë për ngritjen e këtij komisioni pamundësuan respektimin e afatit të parashikuar për vlerësimin dhe pranueshmërinë e propozimit të pa kërkuar për tu shprehur nëse projekti koncesionarë paraqet interes publik dhe për këtë të informojë propozuesin e propozimit të pa kërkuar referuar në ligjin nr. 9663, dt.18.12.2006, i ndryshuar, nenit 23, pika 2/a.

Raporti përmbledhës me shkresën nr. 13969/1 Prot., “*Mbi ecurinë e shqyrtimit të propozimit të pa kërkuar të shoqërisë G. F. I.*” drejtuar Ministrit të Financave i hartuar nga GIP nuk ka datë të shënuar si një element i rëndësishëm në kundërshtim me ligjin nr. 9154, dt. 06.11.2003 “Për arkivat”. Nisur nga ky fakt grupi i auditimit nuk ka siguri për kohën dhe saktësinë e përgatitjes së këtij dokumenti duke mos evidentuar respektimin e afatit të parashikuar në ligjin nr. 9663, dt.18.12.2006, i ndryshuar, nenit 23, pika 3/a, “*Autoriteti kontraktues, brenda 6 muajve nga marrja e dokumentacionit, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 2 të këtij neni, vendos për pranimin ose refuzimin e projektit të mundshëm koncesionar, që rrjedh nga propozimi i pakërkuar.*”

Për shqyrtimin e propozimit të pakërkuar GIP, e ka bazuar punën e tij duke shqyrtuar përputhshmërinë e dokumentacionit të depozituar nga shoqëria G. F. I. me kriteret ligjore të treguesve të mëposhtëm:

- *Studimin e fizibilitetit teknik cili përmban të dhëna të mjaftueshme për konceptin ose teknologjinë e parashikuar në propozim;*
- *Plan biznesin e projektit (duke përfshirë por pa u limituar me një model financiar dhe një plan për financimin e projektit);*
- *Një studim për ndikimin në mjedis;*
- *Nëse Propozimi dhe koncesioni si formë ka rentabilitet dhe përshtatshmëri financiare;*
- *Nëse projekti koncesionar është i mundshëm ose jo për tu zbatuar.*

Për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë, Ministria e Financave me anë të shkresës nr. 6084 Prot., datë 16.03.2011, ka kërkuar nga G. F. I. të dhëna shtesë për projektin e propozuar në lidhje me fizibilitetin financiar (duke përfshirë por pa u limituar, një plan biznesi për kohëzgjatjen e projektit, plan për financimin e tij), studim për ndikimin në mjedis si dhe fizibilitetin teknik dhe të dhëna të tjera për teknologjinë e parashikuar në propozim.

Shoqëria G. F. I. në datën 18.04.2011, ka dorëzuar pranë Ministrisë së Financave, dokumentacionin shtesë në lidhje me zhvillimin e projektit nga ana teknike, financiare dhe ndikimin në mjedis por raporti për ndikimin në mjedis nuk ndodhet fizikisht në dosje.

*Përsa i përket projekti nga ana teknike propozuesi ofron një sistem të avancuar dhe të integruar në fushën e shënjestimit dhe kontrollit të karburanteve që quhet Petromark. Ky sistem përbëhet nga këto elemente: shënjestuesi, sistemi automatik i kompjuterizuar i injektimit, sistemi PORTATIV për kontrollin e karburanteve, sistemi i monitorimit dhe kontrollit të karburanteve. Propozuesi ka shpjeguar metodologjinë për vënien në punë të këtij sistemi. Në lidhje me ndikimin në mjedis, për aq sa shkruhet në raport ky koncesion do të ndikojë në përmirësimin e treguesve të cilësisë së ajrit duke rritur cilësinë e lëndëve djegëse të automjeteve.*

Ndër të tjera në raportin përmbledhës të GIP, përshkruhet:

*Ky projekt do të ketë një ndikim të përgjithshëm afatgjatë shumë pozitiv në mjedis duke implementuar një sistem monitorimi që do të eliminojë abuzimin me cilësitë e lëndëve djegëse dhe nuk kërkon një projekt të madh ndërtimi.*

*Në lidhje me planin e biznesit subjekti ka paraqitur disa tabela në lidhje me ecurinë e investimit që kërkohej. Ato përmbajnë shpenzime kapitale, të ardhurat, kostot operative, burimet e financimit, flukset e parasë dhe qëndrueshmërinë financiare.*

*Kjo kontratë nuk do të ketë mbështetje buxhetore dhe investimi do të financohet nga shoqëria koncesionare. Treguesit e performancës në këtë kontratë janë sasia e karburantit të markuar në litra, çmimi i shënjimit dhe numri i kontrolleve të shoqërisë koncesionare. Sipas planit të biznesit kostoja totale për zbatimin është përlogaritur në vlerën 184.659.360 lekë ose 1.886.000 \$, skema e financimit do të mbulohet plotësisht nga kapitali i shoqërisë. Pasqyrat Financiare janë paraqitur në tre opsione të cila ndryshojnë nga njëra tjetra në varësi të volumit të parashikuar të karburanteve të shënjuar dhe çmimit të shërbimit të shënjimit.*

Grupi i punës GIP pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga kompania arrin në konkluzionin se projekti koncesionarë i propozuar është i mundshëm dhe vetë koncesioni si formë ka rentabilitet dhe përshtatshmëri financiare.

Propozohet që bonusi i pikëve për shoqërinë G. F. I. të jetë 8% e pikëve të garës si më poshtë:

Nr	Kriteret	Pikët Max	Vlerësimi/Bonusi i Pikëve
1	Studimi mbi ndikimin në mjedis	3	3
2	Plan Biznesi	4	3
3	Studimi i fizibilitetit	3	2
	Shuma	10	8

Bonusi i pikëve në masën 8% i propozuar nga grupi i punës, për shoqërinë G. F. I. nuk është i argumentuar për kriteret e analizuara dhe mënyrën e vendosjes së pikëve, bazuar në kriteret e përcaktuara në urdhër.

Gjithashtu me VKM nr. 609, dt. 24.08.2011 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënie me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë” u miratua bonusi i ndryshëm nga ai i propozuari pa një argumentim bashkëlidhur, konkretisht në masën 6% të pikëve për rezultatin teknik e financiar që i jepet shoqërisë propozuese.

***Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për sa më sipër u konstatua se:***

- Nga Ministria e Financave, grupit të auditimit iu vunë në dispozicion vetëm tre procesverbale të mbajtura nga GIP përkatësisht për mbledhjet në datat 01.03.2011, 28.04.2011 dhe 02.06.2011. Në procesverbalin e datës 01.03.2011 GIP nga kryetari znj. M. V. ka përcaktuar në vija të përgjithshme kronologjinë e ecurisë së veprimtarisë së komisionit në përputhje me legjislacionin në fuqi, si më poshtë:

Procesverbali i mbledhjes së datës 01.03.2011, i zbardhur me datë 04.03.2011 rezulton i pa firmosur nga anëtarë z. Sh. H., përfaqësues i MF. Deklaratat e konfliktit të interesit janë me



datë 04.03.2011 dhe nuk janë firmosur nga tre anëtarë z. Sh. H.(MF), z. S. L. (DPD) si dhe znj. O. M.. Përfaqësuesi i ATRAKO-s znj. O. M. është zëvendësuar me z. G. V. me urdhrin e Ministrit nr. 25/1 datë 20.05.2011 me nr. 4882/1 Prot., por që rezulton të ketë firmosur procesverbalin e mbledhjes së datës 01.03.2011, zbardhur me datë 04.03.2011. Në procesverbal citohet që është caktuar mbledhja e radhës me datë 15.03.2011 ku do të identifikohet, përcaktohet dhe të shpreheshin zyrtarisht nëse ky propozim paraqet ose jo interes publik por që nuk iu vu në dispozicion grupit të auditimit procesverbali përkatës i mbledhjes së datës së parashikuar (15.03.2011).

- Në procesverbalin e datës 28.04.2011, pa praninë e kryetares së komisionit të GIP, citohet prania e pesë anëtarëve të GIP (përfaqësues të DPD, DPT dhe Ministrisë së Financave). Shpjegohet shkurtimisht se në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Financave, shoqëria G. F. I. ka paraqitur të dhëna të tjera në lidhje me projektin e propozuar. Në përfundim u caktua që vlerësimi i planit të biznesit paraprak të bëhet nga përfaqësuesit e MF dhe ATRAKO, studimi i fizibilitetit të bëhet nga përfaqësuesit e DPD dhe DPT si dhe studimi i ndikimit në mjedis nga përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit. Në këtë procesverbal data e mbledhjes së radhës nuk u caktua por përfaqësuesve iu kërkua që në mbledhjen e ardhshme të sillen zyrtarisht qëndrimet institucionale mbi propozimin e pakërkuar. Nga grupi i auditimit u konstatua se procesverbali i datës 28.04.2011 është i firmosur nga 10 anëtarë nga 5 anëtarë të deklaruar pjesëmarrës në këtë mbledhje të organizuar.
- Me shkresën nr. 9884 Prot, dt. 01.06.2011, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave paraqet qëndrimin institucional në lidhje me dhënien me koncesion të shërbimit të analizimit të karburanteve dhe naftës bruto në Republikën e Shqipërisë. Sipas kësaj shkrese mbledhja e radhës për anëtarët e GIP ishte caktuar dt. 02.06.2011 ku do të paraqiten për shqyrtim mendimet dhe konkluzionet nga institucionet përkatëse. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion anëtarët përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) shprehen me rezerva në lidhje me këtë koncesion dhe e argumentojnë si më poshtë:

- *Objekti i punës së propozuar nga kompania e interesuar nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me funksionet e rregulluara me ligj për administratën doganore.*
- *Nga studimi rezulton se kompania e interesuar merr përsipër të bëjë kontrollin dhe monitorimin e shpërndarjes të karburanteve pa verifikuar cilësinë e karburanteve. Kontrolli i cilësisë së karburanteve administrohet nga IQT në përputhje me kuadrin ligjorë dhe propozimi nuk e prek këtë funksion.*
- *Në material është e paqartë procedura që do të ndiqet për të siguruar që shënjesi lidhet me produktin që është në cilësinë e përcaktuar këtu është e rëndësishme koordinimi i koncesionarit me IQT (Inspektorati Qendror Teknik).*
- *Me rezerva shprehen edhe për procedurën e kontrollit i cili do të kryhet pranë distributorëve, kështu nuk garantohet konfidencialiteti dhe pavarësia e kontrollorëve në raport me të kontrolluarit. Duke qenë se ky kontroll bëhet nga subjekt privat duhet të identifikohen mekanizmat e kontrollit të kontrollorëve dhe besueshmërisë së tyre.*
- *Eksperiencat e referuara në propozim janë vende të pa zhvilluara dhe jo vende të BE, ku për më tepër nuk kanë të njëjtin model (në Gjeorgji ky shërbim aplikohet nga një kompani private që e përdor shënjesin për të mbrojtur markën e produkteve të veta, ndërsa në Uganda shënjimi bëhet nga një agjenci shtetërore e cila kompaninë e cila bën shënjimin e ka marrë si nënkontraktorë pra jo të pavarur).*

- *Plani i biznesit dhe përfitimet që burojnë duhet të jenë më të argumentuara.*
- *Sipas përfaqësuesve të doganës kjo skemë shënjimi paraqit interes për të gjitha produktet dhe nënproduktet e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese vendas me qëllim mbikëqyrje. Kontrolli i cilësisë së karburanteve të importuara të garantohet si deri tani nga IQT dhe Autoriteti Doganor.*

Ky qëndrim është i firmosur nga 3 (tre) përfaqësuesit e doganës, anëtarë të GIP (S. L.; A. B.; B. B.).

Sipas dokumentacionit, mbledhja e radhës së GIP është mbajtur më dt. 02.06.2011. Sipas proces verbalit znj. M. V. ka kërkuar nga secili anëtarë mendimin apo konkluzionet e arritura. Përfaqësuesit e DPT deklarojnë se e kanë dërguar me Email pranë Ministrisë së Financave mendimin e tyre në lidhje me propozimin e pakërkuar. Kryetarja e GIP kërkon nga përfaqësuesit e DPT që opinioni i përfaqësuesve të DPT të formalizohet me qëndrim zyrtarë. Përfaqësuesit e ATRAKO-s kërkojnë kohë për tu konsultuar në lidhje me skemën e mbledhjes së tatimeve, me mënyrën se si do të lidhet sistemi me administratën tatimore si dhe në lidhje me procedurën e shënjimit.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit shprehen se nuk kanë përfitim të drejtpërdrejtë por duke pasur parasysh se një nga qëllimet e këtij sistemi është cilësia e karburantit që përdoret kjo paraqet interes në përmirësimin e cilësisë së ambientit por shprehen me skepticizëm pasi duhet ta shohin konkretisht nëse aktiviteti ka ndotje ambientale.

Në lidhje me rezervat e mësipërme kryetarja e GIP i propozon grupit të punës që të ftojë përfaqësuesit e G. F. I. në mbledhjen e ardhshme për sqarime në lidhje me paqartësitë e konstatuara nga studimi i materialit. Mendimi i kryetares u aprovua nga të gjithë anëtarët, gjithashtu anëtarja e komisionit znj. S.T. (Përfaqësuese e Ministrisë së Financave) propozon idenë e një takimi me përfaqësues të Inspektoratit të Kontrollit të Cilësisë për të verifikuar nëse kanë përplasje kompetencash ligjore e nënligjore të cilat mund të shoqërohen me ndryshime në legjislacion. Ky propozim nuk u pranua nga ana e komisionit me pretendimin se ky shërbim nuk ka lidhje me funksionin e këtij institucioni. Si përfundim në fund të kësaj mbledhje sipas proces verbalit Kryetarja e komisionit kërkon nga ATRAKO dhe DPT të shprehin mendimet institucionale në mënyrë të shkruar të zgjeruar dhe konkretë, si dhe i kërkon znj. S. T. të njoftojë përfaqësuesit e G. I. F. për mbledhjen e radhës e cila u caktua në dt. 07.06.2011, ora 10.00.

Proces verbali i datës 02.06.2011 nuk është i firmosur nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave z. Sh. H.. Grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion dokumentacioni në lidhje me mbledhjet apo takimet vijuese ku të pasqyrohen diskutimet, propozimet, përfundimet apo edhe qëndrimet institucionale të DPT, ATRAKO, dhe Ministrisë së Mjedisit të kërkuara.

Midis grupit të identifikimit GIP dhe Shoqërisë G. F. I. nuk dokumentohet shqyrtimi në lidhje me rezervat e shprehura nga përfaqësuesit e institucioneve kompetente.

Si përfundim anëtarët e grupit të punës kanë arritur në konkluzionin se projekti koncesionarë i propozuar është i mundshëm e se propozimi i paraqitur ka interes publik si dhe vetë koncesioni si formë ka rentabilitet dhe përshtatshmëri financiare. Në vijim të procedurës në mbështetje të nenit nr. 23, pika 3/a, të ligjit nr. 9663, dt. 18.12.2006, "Për koncesionet", i ndryshuar, GIP i propozon për miratim rekomandimet titullarit të autoritetit kontraktues (Ministrisë së Financave). Në vijim të praktikës titullari i Ministrisë së Financave me shkresën nr. 13969

Prot., dt. 08.07.2011 u ka kërkuar mendim për projekt VKM (për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë, Ministrisë së Drejtësisë, dhe Ministrisë së Ekonomisë). Në vijim të korrespondencës me shkresën nr. 5092/3 Prot, dt. 01.08.2011 Ministria e Ekonomisë është shprehur me rezerva duke paraqitur komentet dhe mendimet për këtë projekt akt për të cilën konkretisht shprehet se: (shënimi) markimi, mund të bëhen për rastin kur në treg lejohen të tregtohen më shumë se një lloj produkti (karburant), por gjithnjë i kontrolluar nga institucioni shtetëror përgjegjës për kontrollin cilësor të karburanteve, kurse monitorimi i trafikut (tregut) të lëndëve djegëse duhet të jetë një paketë ekskluzive e shtetit nëpërmjet strukturave përgjegjëse dhe të caktuara më ligj. Ministria e Financave me shkresën nr. 13969/4 Prot., dt. 12.08.2011, i kërkon rishikim duke i vënë në dispozicion sqarime shtesë. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion grupit të auditimit nga Ministria e Ekonomisë nuk ka shkresë në lidhje me rivlerësimin e këtij akt-vendimi. Me shkresën nr. 4955/1 Prot., dt. 14.07.2011 Zv. Ministri i Drejtësisë shprehet se: propozimi është një projekt fiskal që lidhet me kontrollin tatimor të pagesave dhe detyrimeve tatimore për karburantet dhe nuk ka qëllim parësor kontrollin e cilësisë së karburanteve dhe për rrjedhojë dhënia e këtij projekti është përgjegjësi shtetërore e Ministrisë së Financave.

Përmes Vendimit nr. 609 dt. 24.08.2011 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë”, Këshilli i Ministrave ka pranuar dhënien me koncesion të këtij shërbimi duke përcaktuar Ministrinë e Financave si Autoritetin Kontraktues.

***Për sa më sipër, nga ana e grupit të auditimit u konstatua:***

- Në lidhje me dokumentacionin e kërkuar nga grupi i auditimit, zyra e protokoll arkivës së institucionit, vuri në dispozicion kopje të dokumentacionit (jo dokumente origjinale), pa një shkresë inventarizimi, pa një numër rendor protokollit dhe datë, dokumente të shpërndara në dosje të ndryshme. Grupi i auditimit mori në shqyrtim kopjen e dokumentacionit, sistemimin e tyre, duke nxjerrë në dukje dokumentacionin me fashikujt që mungonin.
- Në lidhje me propozimin e pakërkuar, Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion fotokopje e dokumentit në gjuhën angleze në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Vendimin e Këshillit të Lartë të Arkivave në RSH nr. 4, datë 19.6.2017, neni 4, pika 9, “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” ku përcaktohet se: “Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj”.
- Referuar sa më sipër propozimi i pakërkuar për dhënien me koncesion të këtij shërbimi nuk rezulton të jetë mbështetur në prioritetet strategjike të qeverisë për periudhën në fjalë bazuar në nenin 4, pika 1, i ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për Koncesionet” i ndryshuar, deri në momentin e propozimit për dhënien me koncesion të këtij shërbimi.
- Nuk rezultoi të jetë kryer një studim me analiza të nevojshme kosto-përfitim nga strukturat përkatëse, për të parashikuar kostot respektive të këtij shërbimi si dhe për të identifikuar

mundësinë e kryerjes së investimit dhe ofrimit të këtij shërbimi nga vetë strukturat shtetërore, jo në përputhje me parashikimin e ligjit nr. 9663, dt.18.12.2006, neni 9, pika 2 citohet: “Ministritë përgjegjëse ose organet e njësisë të qeverisjes vendore, me asistencën e Njesisë së Trajtitit të Koncesioneve, kryejnë analizën e rentabilitetit dhe të përshtatshmërisë financiare, për të gjykuar nëse duhet të zbatohet një koncesion i mundshëm. Kjo analizë bazohet në parimet e vlerës për para, në përputhshmërinë e koncesioneve të mundshme me objektivat strategjike kombëtarë dhe objektivat strategjike të sektorit, në rentabilitetin teknik dhe tregtar të koncesionit të mundshëm dhe aftësinë e tij për të tërhequr koncesionarë të mundshëm dhe financime private.

**1. Titulli i gjetjes:** Propozimi i pakërkuar nuk mbështetet në prioritetet strategjike referuar nenit 4 të Ligjit nr. 9663, dt.18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar.

**Situata:** Propozimi i pakërkuar për dhënien me koncesion të këtij shërbimi nuk rezulton të jetë mbështetur në prioritetet strategjike të qeverisë për periudhën në fjalë deri në momentin e propozimit për dhënien me koncesion të këtij shërbimi. Gjithashtu nuk rezultoi të jetë kryer një studim me analiza të nevojshme kosto-përfitimit nga strukturat përkatëse, për të parashikuar kostot respektive të këtij shërbimi, për të identifikuar nëse ky projekt ka qenë i përballueshëm për buxhetin e shtetit dhe për të vlerësuar mbrojtjen e interesit të konsumatorëve lidhur me sasinë, cilësinë dhe nivelin e tarifës të aplikuar për këtë shërbim të markimit të karburanteve.

**Kriteri:** Ligji nr. 9663, dt.18.12.2006, “Për koncesionet” i ndryshuar neni 4, “fusha e zbatimit të koncesionit” dhe neni 9, pika 2 citohet: *“Ministritë përgjegjëse ose organet e njësisë të qeverisjes vendore, me asistencën e Njesisë së Trajtitit të Koncesioneve, kryejnë analizën e rentabilitetit dhe të përshtatshmërisë financiare, për të gjykuar nëse duhet të zbatohet një koncesion i mundshëm. Kjo analizë bazohet në parimet e vlerës për para, në përputhshmërinë e koncesioneve të mundshme me objektivat strategjike kombëtarë dhe objektivat strategjike të sektorit, në rentabilitetin teknik dhe tregtar të koncesionit të mundshëm dhe aftësinë e tij për të tërhequr koncesionarë të mundshëm dhe financime private.*

**Ndikimi/Efekti:** Vendim-marrje e paargumentuar dhe e pabazuar në tregues financiarë, teknike të pabazuara në objektivat strategjike kombëtar dhe sektorial, me pasoja në zbatimin e koncesionit dhe arritjen e rezultateve.

**Shkaku:** Mosrespektimi i detyrimeve ligjore të zyrtarëve publik, mungesa e vlerësimeve të mirëfillta nga ana e tyre,

**Rëndësia:** E Lartë

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Financave të marrë masat që për koncesionet e mundshme në të ardhmen, të kryejë analiza të detajuara, të cilat duhet të bazohen në respektimin e parimeve të vlerës për para, në përputhshmëri me objektivat strategjike kombëtarë dhe sektorial, në rentabilitetin teknik dhe tregtar të koncesionit, etj., me qëllim mbrojtjen e interesave shtetërore dhe të konsumatorëve lidhur me sasinë, cilësinë dhe nivelin e shërbimit që do të përfitohet.

Bazuar në datën e ardhjes të propozimit të pa kërkuar nga G. I. F., që është data 07.12.2010, titullari i AK nuk ka respektuar afatin e përcaktuar në ligjin nr. 9663, dt.08.12.2006, neni 23, pika 2/a, i ndryshuar ku citohet: brenda 90 ditëve pas marrjes dhe shqyrtimit fillestar të propozimit të pakërkuar, autoriteti kontraktues përcakton nëse projekti koncesionar paraqet interes publik dhe për këtë vë në dijeni propozuesin.

**2. Titulli i gjetjes:** Mosrespektim i afateve ligjore në lidhje me shprehjen e interesit publik të projektit koncesionar

**Situata:** Gjatë analizimit të zhvillimit të procedurës mbi pranimin e propozimit të pakërkuar të dhënies me koncesion të markimit dhe monitorimit të karburanteve, rezulton se është tejkualuar afati ligjor 90 ditor i parashikuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9663, datë 08.12.2006, i ndryshuar “Për koncesionet”, neni 23, pika 2/a.

**Kriteri:** Ligji nr. 9663, datë 08.12.2006, i ndryshuar “Për koncesionet”, neni 23, pika 2/a.

**Ndikimi/Efekti:** Marrja e vendimeve jo në përputhje me afatet ligjore të parashikuara.

**Shkaku:** Mosrespektimi i detyrimeve ligjore të zyrtarëve publik, mungesa e vlerësimeve të mirëfillta nga ana e tyre.

**Rëndësia:** E Lartë

**2.1 Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave të marrin masa për zbatimin e procedurave për vlerësimin dhe miratimin e projekteve koncesionare me dokumentacion të plotësuar, si dhe të respektojnë afatet ligjore mbi shprehjen e interesit mbi propozimet e pakërkua në lidhje me miratimin e zhvillimin e koncesioneve.

**3. Titulli i gjetjes:** Problematika të konstatuara me përfshirjen e palëve të interesit.

**Situata:** Gjatë analizimit të zhvillimit të procedurës së dhënies me koncesion të procesit të markimit të karburanteve, rezulton se nuk janë përfshirë dhe konsideruar grupet e interesit si në rastin e Shoqatës së Shoqërive të Hidrokarbureve, të cilët me anë të shkresës nr. 19279 Prot., datë 10.12.2012, kanë kërkuar të përfshihen si palë e interesuar për shqyrtimin e kontratës së koncesionit në marrjen e mendimeve dhe konsultimet, duke listuar dhe disa shqetësime në lidhje me qëllimin e kontratës së koncesionit. Gjithashtu dhe nga ana e Ministrisë së Financave, nuk i është kërkuar mendim/informacion shoqërive naftënxjerrëse (si: B. P. A LTD), si palë kryesore interesi, duke sjellë problematika në procesin e zbatimit të koncesionit.

**Kriteri:** Ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” neni 9

**Ndikimi/Efekti:** Deformim i vendim-marrjes në krahasim me propozimin dhe shqyrtimin e tij, me pasoja në zbatimin e koncesionit dhe arritjen e rezultateve

**Shkaku:** Mosrespektimi i detyrimeve ligjore të zyrtarëve publik, mungesa e vlerësimeve të mirëfillta nga ana e tyre.

**Rëndësia:** E Lartë

**3.1 Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Avokaturës së Shtetit, ATRAKO, Autoritetit të Konkurrencës, apo edhe institucione të tjera të angazhuara në dhënien e mendimeve gjatë fazës së hartimit të kontratave koncesionare, përpara miratimit të projekt akteve përkatëse të kësaj fushe, të marrin masat për njoftimin, konsultimin publik dhe shqyrtimin e problematikave të palëve të interesit, me qëllim harmonizimi dhe garantimin e barazisë në të drejtat dhe detyrimet mes palëve.

**4. Titulli i gjetjes:** Analiza dhe raporte jo të detajuara nga ana e GIP

**Situata:** Raporti përmbledhës i hartuar dhe i miratuar nga Grupi i Punës (GIP) gjatë fazës së zhvillimit të procedurës së koncesionit, nuk përmban analiza të kryera për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe të monitorimit. Vlerësimi i kryer nga GIP është sipërfaqësor, përmbledhës, paraqet vetëm konkluzione dhe nuk shoqërohet me studim të plotë në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga shoqëria G. F. I..

**Kriteri:** Ligji nr. 9663, datë 08.12.2006, i ndryshuar “Për koncesionet”, kreu II, neni 9 pika 2  
**Ndikimi/Efekti:** Deformim i vendim-marrjes në krahasim me propozimin dhe shqyrtimin e tij, me pasoja në zbatimin e koncesionit dhe arritjen e rezultateve

**Shkaku:** Mosrespektimi i detyrimeve ligjore të zyrtarëve publik, mungesa e vlerësimeve të mirëfillta nga ana e tyre.

**Rëndësia:** E Lartë

**4.1 Rekomandimi:** Ministria e Financave gjatë hartimit të Raportit Përmbledhës në lidhje me propozimet e pakërkua për zhvillimin e koncesioneve të bazohet në urdhrin e titullarit mbi kompetencat e tyre si dhe të hartojë analiza të detajuara konkretisht si: analiza e rentabilitetit dhe përshtatshmërisë financiare dhe vlerës për para, të përputhshmërisë së projektit të koncesionit me objektivat strategjike kombëtare, të rentabilitetit teknik dhe përputhshmërisë financiare si dhe aftësisë së projektit për të tërhequr koncesionarë të mundshëm dhe financime private.

**5. Titulli i gjetjes:** Mungon vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës

**Situata:** Gjatë fazës së vlerësimit të propozimit të pakërkua, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk rezultojnë të ketë një vlerësim nga Autoriteti i Konkurrencës, të procedurave koncesionare të marrë në konsideratë vlerësimin nga ana e Autoritetit të Konkurrencës sipas legjislacionit në fuqi.

**Kriteri:** Pika 1 e nenit 69 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ku shprehimisht citohet germa b “Organet e administratës qendrore dhe vendore kërkojnë vlerësimin e Autoritetit për çdo projekt akt normativ që, në mënyrë të veçantë, ka të bëjë me b) vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara; 2. Autoriteti vlerëson shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës që rrjedh nga projekt aktet, sipas pikës 1 të këtij neni si autoriteti kompetent që garanton mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.”

**Ndikimi/Efekti:** Deformim i vendim-marrjes në krahasim me propozimin dhe shqyrtimin e tij, me pasoja në zbatimin e koncesionit dhe arritjen e rezultateve

**Shkaku:** Mosrespektimi i detyrimeve ligjore të zyrtarëve publik, mungesa e vlerësimeve të mirëfillta nga ana e tyre.

**Rëndësia:** E Lartë

**5.1 Rekomandimi:** Ministria e Financave, të procedurave koncesionare të marrë në konsideratë vlerësimin nga ana e Autoritetit të Konkurrencës sipas legjislacionit në fuqi, gjatë zhvillimit të procedurave koncesionare të marrë në konsideratë vlerësimin nga ana e Autoritetit të Konkurrencës sipas legjislacionit në fuqi.

Bonusi i pikëve në masën 8% i propozuar nga grupi i punës, për shoqërinë G. F. I. nuk krijon bindjen e arsyeshme e të argumentuar për mënyrën e vendosjes së pikëve, bazuar në kriteret e përcaktuara në urdhër. Gjithashtu me VKM nr. 609, dt. 24.08.2011 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë” është miratuar bonusi i ndryshëm nga ai i propozuari pa një argumentim bashkëlidhur, konkretisht në masën 6% të pikëve për rezultatin teknik e financiar që i jepet shoqërisë propozuese.

Studim për ndikimin në mjedis si dhe fizibilitetin teknik dhe të dhëna të tjera për teknologjinë e parashikuar në propozim subjekti G. F. I. i ka paraqitur për një periudhë 20 vjeçare. GIP duke e cilësuar objektin e dhënies së koncesionit si shërbim, këtë periudhë e vlerëson si shumë të gjatë për të parandaluar efektet negative që ndikojnë në uljen e konkurrencës dhe në uljen e cilësisë së shërbimit. Për këtë arsye afati i dhënies së koncesionit është vendosur për një periudhë 10 vjeçare. Referuar sa më sipër nga GIP nuk është vlerësuar skema financiare (value for money) e këtij projekti si dhe nuk janë pasqyruar në analizën e fizibilitetit ndryshimi i periudhës në kohë (10 vjet).

## **2.2 Auditimi i fazës procedurale së prokurim publik dhe lidhja e kontratës**

### **2.2.1 Mbi përputhshmërinë e procedurës së prokurimit publik të kontratës me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës**

Nga grupi i auditimit në zbatim të Ligjit nr. 9663, dt. 18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar, është audituar procedura e prokurimit publik për dhënien me koncesion të projektit të shërbimit dhe markimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton si më poshtë:

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 609, dt. 24.08.2011 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë”, është vendosur Ministria e Financave si Autoritet Kontraktues për kryerjen e procedurës ligjore për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu u miratua bonusi prej 6% të pikëve për rezultatin teknik e financiarë në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) që i jepet shoqërisë G. F. I. për dhënien me koncesion të këtij shërbimi.

Me anë të urdhrimit të titullarit të Ministrisë së Financave z. R. B., me nr. 68, dt.13.10.2011 me nr. 13969/8 prot, “Për fillimin e procedurave ligjore për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë” ka urdhëruar që:

- Procedura konkurruese e përzgjedhjes për dhënien me koncesion të shërbimi të jetë pa procedurë para kualifikuese dhe me një fazë.
- Ngritjen e njësisë për hartimin e dokumenteve të procedurës, kërkesave për kualifikim dhe kriterëve të vlerësimit për këtë procedurë konkurruese të përzgjedhjes:
  - V. K. (ekonomiste) kryetare (Ministria e Financave)
  - S. T.(juriste) anëtarë (Ministria e Financave)
  - K. T. (jurist) anëtarë (Ministria e Financave)
  - G. V. (ekonomist) anëtarë (ATRAKO)

Në kundërshtim me përcaktimet ligjore konkretisht kreu VIII pika 5 e VKM nr.27 datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, ku citohet “2 (dy) anëtarë të Njësisë së Hartimit të Dokumenteve janë nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve”, ku në përbërje të grupit të njësisë së hartimit të dokumenteve të procedurës ka vetëm një përfaqësues nga ATRAKO.

Ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO) për miratimin e dokumenteve të garës dhe shqyrtimit të ofertave:

- D. T. (sekretar i përgjithshëm) MF
- M. V. (anëtarë) MF
- A. D. (anëtarë) MF
- V. Xh. (anëtarë) DPT
- G. G. (anëtarë) DPD
- A. P. (anëtarë) ATRAKO
- E. M. (anëtarë) ATRAKO

si dhe ngarkohet ATRAKO që të ndjekë procedurën për përzgjedhjen e konsulentit ndërkombëtarë.

Me datë 08.01.2024 pas shumë kërkesave dhe komunikimeve zyrtare e verbale, grupit të auditimit iu vu në dispozicion një set dokumentesh të emërtuara “Shtojca 2, Dokumentet e procedurës konkurruese për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimin të karburanteve në Republikën e Shqipërisë”), të cilat janë të pa firmosura nga anëtarët e njësisë së hartimit të dokumenteve që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore konkretisht kreu VIII pika 8 e VKM nr.27 datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, ku citohet “Procesi i hartimit të dokumenteve të garës pasqyrohet në regjistrin e koncesioneve. Dokumentet e hartuara, nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Hartimit të Dokumenteve”

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të mësipërm, kriteret e kualifikimi dhe specifikimet teknike janë të paargumentuara në kundërshtim me përcaktimet ligjore kreu VIII pika 6 e VKM nr.27 datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, ku citohet “Njësia e Hartimit të Dokumenteve është përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të garës, kërkesave për kualifikim dhe kriterëve të vlerësimit”

Dokumentet standarde përmbajnë një program orientues si përmbledhje për procedurën:

#### Programi i Parashikuar për Procedurën\*

Veprimtaria	Data e Synuar
Ftesa për Ofertë	26.03.2012
Lëshimi i dokumentave të procedurës konkurruese	26.03.2012
Dorëzimi i pyetjeve dhe komenteve mbi dokumentat e procedurës konkurruese	Jo me vonë se 1/3 e periudhës së mbetur nga data e hapjes
Lëshimi i dokumentave të procedurës konkurruese të ndryshuara	Sipas pikës 2.4.3 e DSPK.
Dorëzimi i Ofertës nga Ofertuesit	14.05.2012
Vlerësim i Ofertave/Përzgjedhja e Ofertuesit Fitues	Deri në 30 ditë
Njoftimi i Ofertuesit Fitues	15 ditë nga vendimi i KVO
Dorëzimi i Sigurimit të Kontratës, Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës të nënshkruara dhe Formularit të Kontratës	Para nënshkrimit të kontratës
Negotimi dhe nënshkrimi i Kontratës Koncesionare	30 ditë nga fillimi i negociimeve
Dhënia e mendimit të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve	Brenda 45 ditë pas nënshkrimit të kontratës
VKM për miratimin e kontratës koncesionare	Brenda 21 ditëve nga nënshkrimi

\*Plani i punës është paraqitur vetëm si model udhëzues



Kriteret e vlerësimit të cituara në DST janë si më poshtë:

<b>Kriteri Teknik</b>			
<b>Kriteret e vlerësimit</b>	<b>Vlera e Pikëve</b>	<b>Pikët e kriterit</b>	<b>Formula e përlogaritjes së pikëve për ofertën</b>
Koha e vënies në funksion	Vlerën Min. të Kriterit	5	$Pk = Vmin/Vo * 5$
Koha e monitorimit	Vlerën Min. të Kriterit	10	$Pk = Vmin/Vo * 10$
Numri i inspektimeve mujore.	Vlerën Maks. të kriterit	10	$Pk = Vo/Vmax * 10$
Koha e transmetimit të dhënave	Vlerën e mini. të kriterit	5	$Pk = Vmin/Vo * 5$
Detektimi i përzierjeve jashtëligjshme.	Vlerën Min. të Kriterit	10	$Pk = Vmin/Vo * 10$
<b>Totali</b>		<b>40</b>	
<b>Kriteri Financiar</b>			
Çmimi i shërbimit	Vlerën min. të kriterit	50	$Pk = Vmin/Vo * 50$
Fee Koncesionare	Vlerën maks. të kriterit	10	$Pk = Vo/Vmax * 10$
<b>Total</b>		<b>60</b>	
<b>Totali i pikëve</b>		<b>100</b>	<b>Zpk</b>

Dokumentacioni në lidhje me procesverbalin e mbajtur nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si dhe dokumentacioni i sjellë nga ofertuesi nuk iu vu në dispozicion grupit të auditimit.

Nga raporti përmbledhës mbi vlerësimin e ofertave “Për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve kuptohet që ka një ndryshim në përbërjen e komisionin e vlerësimin ku znj. M. V. zëvendësohet me z. S. L. por Grupit të Auditimit nuk iu vu në dispozicion urdhri i titullarit për zëvendësim.

Mungesë në lidhje me dokumentacionin e procesit të vlerësimit nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Procedurës vërehet se nga data e zhvillimit të procedurës deri në njoftimin e fituesit dërguar për botim në buletin e njoftimeve publike ka kaluar afati ligjor i përcaktuar në VKM nr.27 datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” i ndryshuar kreu IX pika 3 germa c.

Në buletin e njoftimeve publike datë 26.03.2012 autoriteti kontraktues Ministria e Financave ka publikuar Ftesën për Ofertë për Koncesionin e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve në Republikën e Shqipërisë. Afati i fundit për hapjen e ofertave u caktua data 14.05.2012. Në buletin e datës 09.04.2012 është publikuar një ndryshim i pikës 5.2.3 në kriteret e vlerësimit:

6. Çmimi – është çmimi i shitjes në lekë pa TVSH i shërbimit të Markimit dhe Monitorimit për 1000 litra. Pikët Max për këtë kriter i jepen ofertës me çmimin më të ulët.

Në lidhje me ndryshimin e kriterit të mësipërm, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion procesverbal i mbi argumentimin e këtij ndryshimi. Rëndësia e ndryshimit të kriterit të mësipërm është e lartë pasi fillimisht ishte caktuar çmimi tavan në vlerën 200 lek për 1000 litra (i pa argumentuar).

Ministria e Financave me shkresën nr. 14859/2 prot., datë 21.09.2012 dërgon për botim njoftimin e fituesit, bashkimin e shoqërive G. F. I. S.A, P. C. P. AG dhe C. I. S.A., me ofertë të paraqitur me datë 14.05.2012 në procedurën konkurruese me objekt “ Për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë” për vlerën totale të investimit prej 4.170 mijë dollarë, afërsisht 446.190.000 lekë. G. F. I. S.A, P. C. P. AG dhe C. I. S.A iu kërkua që të paraqesë pranë Ministrisë së Financave: kopjen e vënies në dizeni për formularin e kontratës së nënshkruar dhe sigurimin e kontratës së

përcaktuar në kushtet e veçanta të kontratës siç përcaktohet në dokumentet standarde i cili u botua në buletinin datë 01.10.2013.

Me shkresën nr. 14859/3 datë 01.10.2012 G. F. I. përcjell në Ministrinë e Financave kopjen e vënies në dijeni për formularin e kontratës së nënshkruar, si dhe deklarorin e angazhohet të realizojë sigurimin e kontratës siç përcaktohet në dokumentet standarde në masën 5% të vlerës së projektit, në një total prej 208.500 USD.

**6. Titulli i gjetjes:** Problematika dhe mungesë dokumentacioni në fazën e procedurës së përzgjedhjes

**Situata:** Nga auditimi i fazës së zhvillimit të procedurës së koncesionit, rezulton se nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Procedurës nuk janë zbatuar detyrimet në lidhje me dokumentacionin e procesit të vlerësimit si dhe zbatimin e afatit ligjor të publikimit sipas kërkesave të VKM nr. 27, dt.19.01.2007, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” i ndryshuar, Kreu IX, pika 2 germa b.

- Gjithashtu mungon dokumentacioni thelbësor i procedurës si: Procesverbalet që vërtetojnë analizën që ka bërë NJHD dhe KVO; Subjektet pjesëmarrëse në procedurë; Procedura e ndjekur (me një fazë); Mënyra e përzgjedhjes së fituesit; Regjistrin e koncesionit për projektin konkret që është përgjegjësi e Njesisë së hartimit të dokumentacionit/KVO.

- Në përbërjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave janë emëruar anëtarë të cilët kanë marrë pjesë në Komisionin e Hartimit të Dokumenteve të procedurës konkurruese, konkretisht znj. A. D., në kundërshtim me VKM nr. 27. Dt.19.01.2007, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” i ndryshuar, Kreu VIII, pika 1.

- Në raportin përmbledhës mbi vlerësimin e ofertave të projektit “Për dhënie me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë” nr. 14859 Prot., datë 18.09.2012 citohet shqyrtimi i dokumentacionin ligjor dhe kualifikues, por nuk listohet dokumentacioni i kërkuar konform kërkesave ligjore konkretisht VKM nr. 27. Dt.19.01.2007, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” i ndryshuar, Kreu IX, pika 2 germa b.

-Gjithashtu siç citohet në raportin përmbledhës mungojnë testet fizike të kërkuara. Nga njoftimi i fituesit të publikuar deri në momentin e nënshkrimit të kontratës, ka kaluar një periudhë 5 mujore.

- Grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion procedura e plotë e ndjekur për negocimin e kontratës që nga ftesa për ofertë deri në lidhjen e kontratës, përfshirë dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave për caktimin e afateve të negocimit të kontratës.

**Kriteri:** VKM nr.27 datë 19.01.2007 ‘Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve’ i ndryshuar kreu IX pika 3 germa c, Kreu VIII, pika 1, i ndryshuar, Kreu IX, pika 2 germa b, i ndryshuar

**Ndikimi/Efekti:** Kjo pjesë e rëndësishme e procedurës del tepër e paqartë dhe me mungesë të theksuar transparence, pasi nuk ekziston një arsyetim në zgjedhjet e kriterëve e kërkuara.

Lë vend për deformim të vendim-marrjes, me pasoja në zbatimin e koncesionit.

**Shkaku:** Mosrealizimi i detyrave konkrete sipas komisioneve përkatëse të cilat duheshin të argumentoheshin me procesverbalet e nevojshme.

**Rëndësia:** E Lartë

**6.1 Rekomandimi:** Ministria e Financave të analizojë problematikat mbi zhvillimin e procedurës së koncesionit të markimit dhe monitorimit të karburanteve duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, si dhe në të ardhmen të marrin masa për vijimin e procedurave për publikimin, vlerësimin dhe miratimin e projekteve koncesionare me dokumentacion të plotë.

**2.2.2 Mbi vlerësimin e elementëve në kuadër të lidhjes së kontratës dhe ristrukturimi i saj**  
Pas shpalljes së “G. F. I.” S.A, si subjekti fitues i procedurës së tenderimit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka nisur procedurat për hartimin e kontratës dhe elementëve të saj. Në fund të praktikës për përzgjedhje e përfaqësuesve nga organet kompetente, me urdhrin nr. 61, datë 31.10.2012 të Ministrit të Financave z. R. B. është ngritur grupi i punës “Për negocimin e kontratës koncesionare”, i përbërë nga:

- Znj. S. S. – përfaqësues i Ministrisë së Financave
- Znj. A. M. – përfaqësues i Ministrisë së Financave
- Z. E. Q. – përfaqësues i Ministrisë së Financave
- Z. R. Gj. – përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave
- Z. A. Xh. – përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
- Znj. J. C. – përfaqësues i Avokaturës së Shtetit
- Znj. V. Gj. – përfaqësues i Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve

Në datën 03.12.2012 është mbajtur procesverbali në lidhje me zhvillimin e mbledhjes ndërmjet Grupit të Punës dhe përfaqësuesve të Shoqërisë Koncesionare, me qëllim negocimin e Kontratës Koncesionare. Nga anëtarët e grupit të punës të AK nuk ishin të pranishëm Z. E. Q. dhe Znj. J. C.. Nga ana ATRAKO-s morën pjesë dy konsulentët z. E.H dhe z. E. Sh. Për Konsorciumit ishin të pranishëm:

- Z. G. G. – përfaqësues i Konsorciumit dhe CEO i G. F. I. – së
- Z. A. H. – përfaqësues i P. C. P. A.G.
- Znj. E. M. – përfaqësues i zyrës ligjore të Konsorciumit
- Z. D. D. – konsulent i Konsorciumit

Në procesverbal citohet që gjatë mbledhjes është diskutuar mbi draft kontratën e përgatitur nga Grupi i Punës, e cila i dorëzohet Shoqërisë Koncesionare për shqyrtim.

Gjithashtu është trajtuar çështja e marrjes së konfirmimit nga Autoriteti Kontraktues për ndryshimin e përbërjes së konsorciumit nga bashkim i tre kompanive, G. F. I. S.A, P. C. P. A.G. dhe C. I. S.A, në bashkimin e vetëm dy kompanive G. F. I. S.A dhe P. C. P. A.G. Pajisja e kompanisë G. F. I. S.A me certifikatën ISO 27001:2005 e bën pjesëmarrjen e kompanisë C. I. S.A të panevojshme.

Në përfundim të mbledhjes u dakortësua që mbledhja e radhës do të zhvillohet në datë 04.12.2012, ora 12:00. Procesverbali i mbledhjes së datës 03.12.2012 u firmos nga 3 prej pjesëmarrësve konkretisht, Znj. S. S., Znj. A. M. dhe Z. A. Xh..

Në datën 04.12.2012 është mbajtur procesverbal në lidhje me zhvillimin e mbledhjes ndërmjet Grupit të Punës dhe përfaqësuesve të Shoqërisë Koncesionare, me qëllim negocimin e Kontratës Koncesionare. Nga anëtarët e grupit të punës të AK nuk ishin të pranishëm Z. E. Q.,

Znj. J. C. dhe Z. A. Xh.. Nga ana ATRAKO–s morën pjesë dy konsulentët z. E.H dhe z. E. Sh.  
Për Konsorciumit ishin të pranishëm:

- Z. G. G. – përfaqësues i Konsorciumit dhe CEO i G. F. I. – së
- Z. A. H. – përfaqësues i P. C. P. A.G.
- Znj. E. M. – përfaqësues i zyrës ligjore të Konsorciumit
- Z. D. D. – konsulent i Konsorciumit
- Znj. T. Z. – përfaqësuese e zyrës ligjore Z.K

Në procesverbal citohet që në fillim të mbledhjes Grupi i Punës shprehet se diskutimi mbi draft kontratën duhet të vijojë pas marrjes së konfirmimit nga AK për ndryshimin e përbërjes së Konsorciumit. Nga ana e përfaqësuesve të Konsorciumit u kërkua vijimin e negociimit për arsye se OE G. F. I. S.A, e ka fituar e vetme fazën e parë të propozimit të pakërkuar dhe në fazën e dytë është bashkuar me OE C. I. S.A, e cila zotëronte 10% te aksioneve dhe është tërhequr me dëshirën e saj. Sa më sipër, referuar pretendimeve të përfaqësuesve të Konsorciumit, si dhe nisur nga praktikat të njëjta të mëparshme trajtuar nga Avokatura e Shtetit dhe Ministria e Ekonomisë, ky fakt nuk duhet të përbëjë problem për vijueshmërinë e negociimit të Kontratës. Palët u dakortësuan për kalimin në diskutim dhe trajtimin nen për nen të draft kontratës.

Në vijim të mbledhjes janë trajtuar propozimet e Konsorciumit dhe nga ana e AK u pranuan 8 prej propozimeve, nuk u pranua 1 prej tyre, dhe u lënë për diskutim të mëtejshëm 13 prej propozimeve.

Në përfundim, u ra dakord që Koncesionari të plotësojë anekset e propozuara nga AK në kontratë, bazuar në dokumentat e ofertës. Versioni i ndryshuar nga Koncesionare do t'i dërgohet për diskutim Grupit të Punës. Procesverbali i mbledhjes së datës 04.12.2012 u firmos nga 4 prej pjesëmarrësve konkretisht, Znj. S. S., Znj. V. Gj., Znj. A. M. dhe Z. R. Gj..

Nga dokumentacioni i administruar, me shkresën nr. 14859/2 prot., datë 10.01.2013 nga ana e Ministrisë së Financave është konfirmuar ndryshimi i përbërjes së konsorciumit nga bashkim i tre kompanive, G. F. I. S.A, P. C. P. A.G. dhe C. I. S.A, në bashkimin e vetëm dy kompanive G. F. I. S.A dhe P. C. P. A.G.

**Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni mbi mbledhjet e mëpasshme lidhur me negociimin e kontratës, si dhe procedurat e ndjekura nga Grupi i Punës deri në publikimit e VKM nr. 200, datë 13.03.2013 për “Miratimin e Kontratës së Koncesionit për Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “G. F. I.” S.A dhe “P. C. P.”A.G.”**

**7. Titulli i gjetjes:** Mungesa në dokumentacion dhe mangësi në elementet e VKM-së nr. 200, dt. 13.03.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur midis MFE dhe bashkimit të përkohshëm të “G. F. I.” s.a dhe “P. C. P.” A. G, i ndryshuar

**Situata:** Nga auditimi i procedurave të koncesionit, ka rezultuar se nuk janë zgjidhur apo marrë në konsideratë problematikat e lidhura me markimin e naftës bruto si dhe monitorimin e produktit solar/mazut, çështje këto të ngritur që në fillim të propozimit të pa kërkuar.

-Kontrata nuk parashikon formate tip raportimi se çfarë konkretisht duhet të monitorohet dhe si duhet të kryhet ky monitorim nga menaxheri i projektit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e më pas Ministria e Financave, pra mungojnë treguesit e matshëm të efektivitetit/performancës së këtij koncesioni.

-Kontrata nuk parashikon se si do të procedohet me transferimin e pronësisë intelektuale dhe të teknologjisë sekrete (Solucioni i markimit të përdorur nga koncesionari), duke evidentuar kështu një risk të shtuar nëse në përfundimin e kontratës të gjitha asetet, sistemet hardware dhe software do të rezultojnë jofunksionale duke sjellë pamundësinë e vijimit të ofrimit të shërbimit me largimin e Koncesionarit.

-Kontrata nuk ka parashikuar masa për parandalimin e lënies si kolateral të aseteve të kësaj kontrate për qëllimet e angazhimeve financiare të shoqërisë Koncesionare, duke përbërë kështu një risk të shtuar mbi efektet negative që mund t'i shkaktohen buxhetit të shtetit dhe funksionimit normal të këtij koncesioni.

-Kontrata nuk ka parashikuar penalitete për koncesionarin në rastet kur shërbimet e markimit dhe të monitorimit të ofruara nuk janë në përputhje me ofertën teknike, me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DSK si dhe përcaktimet e Shtojcës nr. 4 të kësaj kontrate.

**Kriteri:** Ligji Nr. 9663, datë 08.12.2006, i ndryshuar “Për koncesionet” pika 2/a, neni 23 si dhe pika 2/c, neni 23;

Urdhëri nr. 61, datë 31.10.2012 të Ministrit të Financave z. R. B. së grupit të punës “Për negociimin e kontratës koncesionare”.

**Ndikimi/Efekti:** Mangësi të konstatuara përgjatë zbatimit të kontratës, ndikuar nga mangësitë/paqartësitë/problematikat në draftimin e termave të saj.

**Shkaku:** Mos dokumentimi i plotë dhe mangësi në hartimin e disa elementeve të rëndësishëm të kontratës.

**Rëndësia:** E lartë

**7.1 Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave të marrin masat për analizimin e situatës duke identifikuar përgjegjësitë përkatëse në parregullsitë e evidentuara në kontratën e nënshkruar, dhe të ndër marrë masa të menjëhershme ligjore për eliminimin e tyre, si dhe shqyrtimin e mundësive reale për hartimin e dokumentacioneve sqaruese/plotësuese sipas rastit, me efekte deri në përfundim të afatit të projektit.

Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Avokaturës së Shtetit, ATRAKO, Autoritetit të Konkurrencës apo edhe institucione të tjera të angazhuara në dhënien e mendimeve gjatë fazës së hartimit të kontratave koncesionare, përpara miratimit të projekt ligjeve përkatëse, të marrin masat që garantojnë mbrojtjen e interesave të shtetit, nëpërmjet korrigjimit të këtyre parregullsive në mënyrën e formulimit të kontratave që mund të hartohen e miratohen në të ardhmen.

## **2.3 Auditimi i zbatimit i kontratës**

### ***2.3.1 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për koncesionin dhe identifikimi i risqeve nga ana e strukturave përgjegjëse***

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për koncesionin është kryer bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, të cituara rast pas rasti përgjatë trajtimit. Në kuptimin e ligjit të lartpërmendur, menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, me qëllim për të adresuar risqet dhe për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Referuar nenit 19 të ligjit për MFK, zbatimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kryhet sipas komponentëve të mëposhtëm të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

- 1. Mjedisi i kontrollit.*
- 2. Menaxhimi i riskut.*
- 3. Veprimtaritë e kontrollit.*
- 4. Informacioni dhe komunikimi.*
- 5. Monitorimi.*

### **Mjedisi i kontrollit**

Grupi i parë i komponentëve të kontrollit të brendshëm përshkruan kushtet bazë të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli (i brendshëm) në një njësi të caktuar. Tek mjedisi i kontrollit do të përfshihen integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politika menaxheriale dhe stili i punës, struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Nga vlerësimi i mjedisit të kontrollit, rezultuan parregullsitë, si më poshtë:

-Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e Autoritetit sipas VKM nr. 498, dt. 30.05.2013, neni 1, pika 1.1 dhe autoritetit përgjegjës për aktivitetin në doganat e RSH, dhe Ministria e Financave, në cilësinë e autoritetit kontraktor dhe institucionit mëmë qendror të DPD, nuk kanë ngritur një grup të mirëfilltë pune (të përhershëm për afatin e kontratës) për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate me specialistë të fushës, ku të përfshiheshin së paku një ekonomist, një jurist dhe një inxhinier i fushës, me ndarje të qartë të detyrave, për mbikëqyrjen e përshtatshme të zbatimit të kontratës.

**8. Titulli i gjetjes:** Parregullsi lidhur me krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli (i brendshëm)

**Situata:** Ministria e Financave nuk ka ngritur një grup pune (të përhershëm për afatin e kontratës të miratuar me VKM nr. 200 datë 13.03.2013) për monitorimin dhe zbatimin e kësaj kontrate me specialistë të fushës, ku të përfshiheshin së paku një ekonomist, një jurist dhe një inxhinier i fushës, me ndarje të qartë të detyrave, për mbikëqyrjen e përshtatshme të zbatimit të kontratës.

**Kriteri:** Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.1 dhe pika 3.2.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e ngritjes së një strukture të përshtatshme organizative për mbikëqyrjen e kontratës kanë sjellë mungesën e vlerësimit të performancës së Partneritetit Publik Privat të ofrimit të shërbimit

**Shkaku:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e Autoritetit sipas VKM nr. 498, dt. 30.05.2013, “Për përcaktimin e procedurave të shënjitimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, neni 1, pika 1.1, dhe Ministria e Financave, në cilësinë e autoritetit kontraktor dhe institucionit mëmë të DPD, nuk kanë ngritur një grup të mirëfilltë pune (të përhershëm për afatin e kontratës) për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate dhe nuk ka detajuar procedurën e kryerjes së monitorimit dhe vlerësimit të kontratës koncesionare

**Rëndësia:** E lartë

**8.1 Rekomandimi:** Ministria e Financave të marrë masa për:

(i) ngritjen e një grupi pune (të përhershëm për afatin e kontratës) për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate me specialistë të fushës, monitorimin periodik të përmbushjes së objektivave dhe indikatorëve.

(ii) hartimin e procedurave të detajuara të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së këtij Konçesioni, duke përfshirë mënyrën si do të kryhet monitorimi i plotë periodik e gjithëvjetor, detyrat dhe përgjegjësitë specifike të personave përgjegjës, etj..

Pika 7.2.2 Neni XI i Kontratës së Koncesionit parashikon se “Koncesionari në përputhje me Shtojcën 8 të kësaj kontrate, “Trajnimi i Personelit”, do të realizojë trajnime të vazhdueshme për të gjithë personelin e Koncesionarit, i cili është i punësuar apo angazhuar në kryerjen e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit, si edhe të personelit të administratës shtetërore të përfshirë në procesin e monitorimit”.

Shtojca 8 e kontratës koncesionare parashikon realizimin e trajnimeve për:

- Procedura e operacioneve të testimit të fushës së analizatorëve/detektorëve
- Procedurat e testimit të kamionëve cisternë
- Pamje e përgjithshme e sistemit të injektimit
- Procedura e furnizimit me shënjues
- Prodhimi i shënjuesit (për punonjësit e koncesionarit)
- Pajisjet e shënjitimit manual ose të dhënat operative të sistemit të injektimit
- Siguria

**Për sa më sipër, grupi i auditimit ka konstatuar, si më poshtë:**

Edhe pse në kontratë është përcaktuar detyrimi i shoqërisë koncesionare për të garantuar trajnime të doganierëve shqiptarë për, nga auditimi u konstatua se nuk është miratuar asnjë plan veprimi apo plan trajnimi, për të përcaktuar periodicitetin dhe shtrirjen e këtyre trajnimeve, me qëllim aftësimin e punonjësve të doganës në procesin e markimit dhe monitorimit të karburantit;

- Përpos mungesës së dokumentuar të hartimit dhe miratimit të planit të trajnimeve, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion apo procesverbal mbi trajnimet e ushtruara apo tematikat e trajnimeve.

Në kushtet kur Kontrata e Koncesionit është drejt përfundimit të afatit mungesa e zhvillimit të trajnimeve të stafit të DPD krijon riskun e pamundësisë së marrjes në dorëzim të aseteve të Koncesionit për shkak të mungesës së njohurive.

**9. Titulli i gjetjes:** Mungesë e organizimit të trajnimeve për punonjësit e doganës

**Situata:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e autoritetit të përcaktuar në Vendimin nr. 498, datë 30.05.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjitimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, nuk ka hartuar dhe miratuar asnjë plan veprimi apo plan trajnimi, për të përcaktuar periodicitetin dhe shtrirjen e këtyre trajnimeve, aftësimin e punonjësve të doganës në procesin e markimit dhe monitorimit të karburantit;

Përpos mungesës së dokumentuar të hartimit dhe miratimit të planit të trajnimeve, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion apo procesverbal mbi trajnimet e ushtruara apo tematikat e trajnimeve.

**Kriteri:** - Kontrata koncesionare, Pika 7.2.2, Neni XI

- Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.1 “Mjedisi i Kontrollit të Brendshëm”;

**Ndikimi/Efekti:** Moskryerja e trajnimeve të vazhdueshme dhe periodike krijon risk për pamundësinë e marrjes në dorëzim të koncesionit, në përfundim të afatit të kontratës, për shkak të mungesës së njohurive.

**Shkaku:** Autoriteti Kontraktues nuk ka ndërmarrë asnjë masë që shoqëria koncesionare të përmbushë detyrimin e trajnimit të personelit të administratës shtetërore të përfshirë në procesin e monitorimit.

**Rëndësia:** E lartë

**9.1 Rekomandimi:** Nga ana e Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të merren masa për hartimin dhe miratimin e planeve periodike mujore dhe vjetore për trajnimin e punonjësve të administratës shtetërore të përfshirë në procesin e monitorimit të kontratave koncesionare.

**Menaxhimi i riskut**

Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave.

Përpos të gjitha korrespondencave të vazhdueshme mbi risqe që mund të cenojnë efikasitetin e këtij shërbimi, nga auditimi rezultoi se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e Autoritetit sipas VKM nr. 498, dt. 30.05.2013, “Për përcaktimin e procedurave të shënjitimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, neni 1, pika 1.1 dhe Ministria e Financave, në cilësinë e autoritetit kontraktor dhe institucionit mëmë të DPD, nuk kanë hartuar dhe miratuar një regjistër ose strategji risku mbi këtë proces, ku në vijim të risqeve të identifikuara, të arsyetohet përgjigja ndaj riskut dhe të merren masa. Pika 3.2 “Menaxhimi i riskut” të Manualit



të MFK përcakton se strategjia e menaxhimit të riskut, e hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, duhet të rishikohet dhe përditësohet rregullisht (çdo tre vjet).

Referuar germës *c* të pikës 2.2.9 të Kapitullit II “Rolet dhe aktorët në sistemin e MFK-së” të Manualit të MFK, Menaxherët e njësive publike janë përgjegjës për identifikimin dhe zhvillimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që rrezikojnë arritjen e objektivave dhe përmbushjen e suksesshme të veprimtarive të strukturës për të cilën janë përgjegjës brenda njësisë.

**10. Titulli i gjetjes:** Mungesë e përfshirjes së aktivitetit të kontratës koncesionare në Regjistrin e Riskut

**Situata:** Ministria e Financave në cilësinë e autoritetit kontraktor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e autoritetit të përcaktuar në Vendimin e KM nr. 498, datë 30.05.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, nuk kanë hartuar dhe miratuar regjistër ose strategji rrishtu mbi këtë proces, ku në vijim të risqeve të identifikuara, të arsyetohet përgjigja ndaj riskut dhe të merren masat përkatëse.

**Kriteri:** Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.2 “Menaxhimi i Riskut”, pika 2.2.9 e Kapitullit II “Rolet dhe aktorët në sistemin e MFK-së”, germa *c*.

**Ndikimi/Efekti:** Mos përmbushja e detyrimit për hartimin e Regjistrit të Riskut ka sjellë në mungesën e vlerësimin dhe kontrollit të risqeve për arritjen e qëllimeve të kontratës koncesionare.

**Shkaku:** Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar dhe vlerësuar risqet e këtij procesi.

**Rëndësia:** E lartë

**10.1 Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me qëllim hartimin e Regjistrit të Riskut për aktivitete e procese që lidhen me shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, me qëllim identifikimin, vlerësimin dhe minimizimin e risqeve përkatëse.

### **Veprimtaritë e kontrollit**

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve.

Harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit dhe plani i kontrollit të brendshëm

Përgatitja e një *harte me proceset e punës* garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

*Gjurma e auditimit* është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar, si dhe për t’i verifikuar ato. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët

e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Gjurma e auditimit e pajis menaxhimin e lartë me një vizion të qartë për:

- Ecurinë e proceseve;
- Objektivat e proceseve;
- Strukturat brenda dhe jashtë njësisë që përfshihen në proces;
- Aktivitetet e ndryshme të procesit;
- Sistemet e TI-së që mbështesin proceset;
- Afatin e zbatimit të aktiviteteve që janë pjesë e proceseve;
- Burimet e përdorura dhe produktet e përfuara;
- Boshllëqet e mundshme të kontrolleve dhe/ ose kontrollet e mbivendosura;
- Dokumentet ligjore, financiare, ose të një natyre tjetër, që rregullojnë dhe mbështetin aktivitetet që janë pjesë e këtyre proceseve.

*Plani i Kontrollit të Brendshëm* është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.

Kontrollet duhet të sigurojnë:

- Autorizimet;
- Përputhshmërinë ligjore;
- Ndarjen e detyrave;
- Plotësinë;
- Efikasitetin & Efektivitetin.

Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion mbi hartimin dhe miratimin e hartës së procesit të punës, gjurmës së auditimit dhe planit të kontrollit të brendshëm, sipas formatit të kërkuar nga Manuali i MFK, për procesin e kryerjes së markimit dhe monitorimit të karburantit; njësitë përgjegjëse për procesin sipas hallkave përkatëse, etj.

**11. Titulli i gjetjes:** Mungesë e hartimit dhe miratimit të hartës së procesit të punës, gjurmës së auditimit dhe planit të kontrollit të brendshëm

**Situata:** Ministria e Financave në cilësinë e autoritetit kontraktor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e autoritetit të përcaktuar në Vendimin e KM nr. 498, datë 30.05.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, nuk kanë hartuar dhe miratuar hartën e procesit të punës, gjurmën e auditimit dhe planin e kontrollit të brendshëm, sipas formatit të kërkuar nga Manuali i MFK, për procesin e kryerjes së markimit dhe monitorimit; njësitë përgjegjëse për procesin sipas hallkave përkatëse, etj.

**Kriteri:** Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3 “Veprimtaritë e Kontrollit”  
**Ndikimi/Efekti:** Mungesë e ekzistencës së uniformitetit në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera/ përgjegjësitë dhe afatet për kryerjen e një aktiviteti, mos verifikimin e aktiviteteve të kryera; si dhe mos menaxhimin e risqeve kryesore dhe mosdhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.

**Shkaku:** Autoriteti Kontraktues nuk ka hartuar hartën e procesit të punës, gjurmën e auditimit dhe planin e kontrollit të brendshëm.

**Rëndësia:** E mesme

**11.1 Rekomandimi:** Nga ana e Titullarëve të Ministria e Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të merren masa për hartimin dhe miratimin e hartës së procesit të punës, gjurmën e auditimit dhe planin e kontrollit të brendshëm sa i përket procesit të kryerjes së markimit dhe monitorimit njësitë përgjegjëse për procesin sipas hallkave përkatëse, etj. në një formë të tillë që t'i shërbejë monitorimit të kontratës së koncesionit dhe garantimin e informacionit të plotë lidhur me gjetjet që kanë të bëjnë me këtë proces pune.

Dokumentimi, arkivimi dhe ruajtja e informacionit/dokumentacionit

Procedurat për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike. Dokumentimi përfshin hartimin e provave të shkruara për vendimet e marra, ngjarjet e ndodhura, veprimet dhe transaksionet e kryera, etj. Dokumentimi duhet të jetë i plotë, i saktë dhe në kohën e duhur. Procedurat e dokumentimit përfshijnë procedurat që lidhen me qarkullimin e dokumentacionit, të cilat përmbajnë urdhrin për qarkullimin dhe përdorimin e dokumenteve të prodhuara dhe të marra. Procedurat e dokumentimit duhet të mundësojnë ndjekjen e çdo dokumenti, veprimi, apo procesi në njësi ku të tregohet saktësisht se kush ka kryer çfarë, kur dhe ku, qëllimin dhe llojin e aktit/dokumentit që është lëshuar me këtë rast. Rakordimi i të dhënave. Titullari duhet gjithashtu të garantojë se të dhënat nga dokumente, apo burime të ndryshme krahasohen për t'u siguruar për përputhshmërinë e tyre.

Dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit nuk ishte i inventarizuar, përbëhej kryesisht nga dokumentacion jo origjinal (i fotokopjuar), korrespondencat nuk ishin të plotësuara si një praktikë e vetme, si dhe disa prej dokumenteve ishin në formate të papërfunduara në versionin final, në kundërshtim me Normat Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat".

**12. Titulli i gjetjes:** Parregullsi në ruajtjen e dokumentacionit lidhur me kontratën koncesionare

**Situata:** Nga auditimi rezultoi se nuk kishte inventar të dokumenteve të vendosura në dispozicion Grupit të Auditimit; korrespondencat nuk ishin të plotësuara si një praktikë e vetme; shumica e dokumentave në dosje ishin fotokopje ose në formate të papërfunduara në versionin final, veprime në kundërshtim me Normat Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat".

**Kriteri:** Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë

**Ndikimi/Efekti:** Mungesë e mundësisë për analizë nga vetë institucioni apo edhe palëve të tjera të përfshira të dokumentacionit lidhur me kontratën koncesionare.

**Shkaku:** Mungesa e një akti me detajimin e mënyrës dhe njësisë përgjegjëse për ruajtjen e çdo dokumentacioni të lidhur me kontratën koncesionare, zbatimin e saj, monitorimin, etj.

**Rëndësia:** E mesme

**12.1 Rekomandimi:** Nga ana e Titullarit të Ministrisë së Financave të merren masa për hartimin e një urdhri ose udhëzimi për hartimin e gjurmës së auditimit për koncesionet dhe në

këtë kuadër, disiplinimin në mënyrë përfundimtare nga njësia përgjegjëse, të mënyrës së administrimit, protokollimit, ruajtjes, digjitalizimit dhe arkivimit të dokumentacionit të kontratave koncesionare dhe atyre PPP, duke përfshirë të gjithë fazat e tyre

## **Monitorimi**

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës. Në kuadrin e kontratës koncesionare, monitorimi dhe raportimi janë procese përmes të cilave të mund t'i kushtohet vëmendje ecurisë së zbatimit të saj, përmbushjes së detyrimeve si dhe arritjes së objektivave të vendosura.

Procedurat e vendosura për monitorim duhet të jenë në përputhje me kulturën dhe rregullat e brendshme të njësisë, si dhe të garantojnë përshtatshmërinë me rregullat. Monitorimi i vazhdueshëm mundëson vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të sistemeve të kontrollit, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit. Vlerësimi dhe monitorimi bëhet nëpërmjet:

- Monitorimit të vazhdueshëm;
- Vetëvlerësimit;
- Auditimit të brendshëm.

Auditimi i Brendshëm konsiston në një aktivitet që ofron garanci objektive ose këshilla, i konceptuar për t'i shtuar vlerën dhe përmirësuar operacionet e njësisë publike. Ai i vjen në ndihmë njësisë për arritjen e objektivave të veta, duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të riskut, kontrollit dhe proceseve qeverisëse të njësisë publike.

Mbi rolin dhe përgjegjësitë e MFE në monitorimin e kontratës koncesionare “Për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve”

Në përputhje me Nenin 6 të kontratës Koncesionare, “*Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktues*”

### **6.1. Autoriteti Kontraktues do të ushtrojë të drejtat e parashikuara më poshtë:**

i. Autoriteti Kontraktues ka të drejtën që të monitorojë, inspektojë, kontrollojë dhe mbikëqyrë çdo fazë të zbatimit të Kontratës, nëpërmjet personave të autorizuar prej tij, me qëllim që të verifikojë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Koncesionit. Kontrolli i ushtruar nga ana e Autoritetit Kontraktues do të përfshijë kontrollin teknik mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara nga Koncesionar.

ii. Koncesionari do të pajisë Autoritetin Kontraktues me një detektor/analizator, i cili mund të përdoret nga ky i fundit gjatë gjithë periudhës 10 vjeçare të kohëzgjatjes së Koncesionit. Detektori/analizatori do t'i jepet Autoritetit Kontraktues nga Koncesionari falas dhe kalibrimi i tij do të kryhet në përputhje me të njëjtat kushte kalibrimi të vendosura për Pajisjet dhe Makineritë e Koncesionarit. Detektori/analizatori në dispozicion të Autoritetit Koncesionar do të përdoret me qëllimin e vetëm të monitorimit të aktivitetit të Koncesionarit në përputhje me të drejtat e monitorimit që Autoriteti Kontraktues ka kompetencën të kryejë sipas kësaj Kontrate. Detektori/analizatori nuk do të përdoret nga Autoriteti Kontraktues për asnjë qëllim tjetër, përveç atij të përmendur në këtë nen.

iii. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën që të ushtrojë mbikëqyrjen e përgjithshme çdo 6 muaj, gjatë zbatimit dhe funksionimit të Kontratës, në mënyrë që të verifikojë se kryerja e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit,

cilësia dhe konformiteti i tyre janë në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate dhe me Projektin e paraqitur nga Koncesionar dhe të miratuar nga Autoriteti.

iv. Përveç sa parashikohet në paragrafin 6.1.iii me sipër, në rastet kur sipas informacioneve të arsyeshme dhe të besueshme Autoriteti Kontraktues është në dijeni të mos përmbushjes së detyrimeve të kësaj Kontrate, mund të ushtrojë monitorimin në çdo kohë.

v. Në rast të shkeljes së kushteve të Kontratës së Koncesionit të vërejtura gjatë monitorimit dhe mbikëqyrjes së përgjithshme, Koncesionar do të njoftohet me shkrim në lidhje me masat që do të ndërmerren dhe detyrimet që duhet të përmbushen, si dhe në lidhje me mënyrën dhe kushtet e përmbushjes së tyre.

Nga dokumentacioni i administruar konstatohet se ana e MFE është kryer vetëm një kontroll mbi ofrimin e shërbimeve nga Koncesionari. Kontrolli është i kryer nga grupi i MFE i ngritur me urdhër të titullarit të MFE nr. 68, datë 21.02.2022.

1. Grupit të auditimit nuk i janë vënë në dispozicion raportet periodike 6 – mujore të kryera nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me pikën iii, neni 6.1 të Kontratës Koncesionare.

2. Në përputhje me pikën v, neni 6.1, në raportet e administruara të monitorimit, nuk rezulton të jetë dokumentuar në asnjë rast përcjellja e rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve. Gjithashtu nuk rezulton të jetë dokumentuar procesi i ndjekjes së marrjes së masave nga ana e Koncesionarit për zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga grupet e punës, si dhe për minimizimin apo eliminimin e risqeve të drejtpërdrejta e të tërthorta që ndikojnë në buxhetin e shtetit.

Mbi strukturat përgjegjëse për monitorimin e kontratës së koncesionit të markimit dhe monitorimit në dogana

Nga **Ministria e Financave**, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të kësaj kontrate, strukturat përgjegjëse për monitorimin e saj sipas detyrave funksionale të pozicionit rezultojnë:

Nga **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave**, përfaqësuesit ekzekutiv të autoritetit në kontratë dhe autoritetit përgjegjës për aktivitetin në doganat e RSH rezultojnë:

a. Menaxheri i projektit, Në zbatim të nenit 22 të kontratës, pika 4 “Përfaqësimi i Palëve”, e cila parashikon emërimin e një Menaxher Projekti i cili do të jetë përgjegjës, në emër të Palës, të marrë komunikimet mbi të gjitha çështjet e lidhura me ekzekutimin e Kontratës së Koncesionit.

Në zbatim të shtojcës nr. 10 të Kontratës Koncesionare menaxheri i projektit për autoritetin kontraktues do të kryejë këto detyra si vijon:

- a. Të jetë pika kryesore e kontaktit me Koncesionarin për llogari të Autoritetit Kontraktues
- b. Në përputhje me aktet rregullatorë të miratuara nga Autoriteti Kontraktues të miratojë aktivitetet e projektit, përfshirë dhënien e informacioneve që kërkohen nga Koncesionari, për aspekte të ndryshme të zbatimit të kontratës
- c. Të raportojë tek Autoriteti Kontraktues për progresin e zbatimit të Kontratës rast pas rasti dhe në mënyrë periodike
- d. Të raportojë tek Autoriteti Kontraktues për të gjitha problematikat e hasura dhe çështjet e tjera që lidhen me zbatimin e kontratës dhe të propozojë zgjidhje përkatëse

Me urdhërin nr. 115 datë 23.10.2017 të Ministrit të Financave është emëruar z. A. K. në cilësinë e menaxherit të projekti të Autoritetit Kontraktues.

Me urdhërin nr.280, datë 23.11.2020 “Për një ndryshim në urdhrin nr.115, datë 23.10.2017,” Për emërimin e z. P. D. menaxherit të projektit të autoritetit kontraktues të kontratës së koncesionit” për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve”, i ndryshuar.

**13. Titulli i gjetjes:** Mos plotësim i pozicionit vakant të Menaxherit të Projektit për vitin 2023 dhe 2024

**Situata:** Nga auditimi, për vitin 2023 deri në datën e auditimit në terren rezulton i paplotësuar pozicioni i Menaxherit të Projektit, në kundërshtim me nenin 22 të kontratës, pika 4 “Përfaqësimi i Palëve”, e cila parashikon emërimin e një Menaxher Projekti i cili do të jetë përgjegjës, në emër të Palës, të marrë komunikimet mbi të gjitha çështjet e lidhura me ekzekutimin e Kontratës së Koncesionit.

**Kriteri:** VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur midis MFE dhe bashkimit të përkohshëm të “G. F. I.“ S.A dhe “P. C. P“ A. G, i ndryshuar, Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Kontrata Koncesionare, neni 22

**Ndikimi/Efekti:** Autoriteti Kontraktues nuk kanë emëruar Menaxher Projekti për vitin 2023 dhe 2024 duke krijuar vështirësi në komunikimin me Koncesionarin dhe raportimin tek Autoriteti Kontraktues

**Shkaku:** Mos plotësim i pozicionit të Menaxherit të Projektit për vitin 2023 dhe 2024 nga Autoriteti Kontraktues

**Rëndësia:** E lartë

**13.1 Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të marrin masat që të mos krijohen vakanca në lidhje me pozicionin e Menaxherit të Projektit, duke garantuar vijueshmërinë mbi zbatimin dhe përmbushjen e kushteve të kontratës.

**b.** Nga dokumentacioni i administruar konstatohet se ana e DPD janë ushtruar kontrollet mbi ofrimin e shërbimeve nga Koncesionari dhe janë përcjellë me shkresat si më poshtë vijon:

-Shkresa nr. 23349/1 prot., datë 23.11.2016, nga DPD drejtuar MFE ku dërgohet raport mbi kontrollin e ushtruar ndaj koncesionarit G. F. I. sipas programit vjetor të kontrollit me nr. 5027/1 prot., datë 26.04.2016.

-Shkresa me nr. 14148, viti 2016 jep raportin e kontrollit të ushtruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në kompaninë koncesionare G. F. I. A., sipas program kontrollit nr. 5027/1 prot., dt. 26.04.2016

-Shkresa nr. 4871/4 prot., datë 04.08.2017 nga drejtoria e Koncesioneve të MFE drejtuar G. F. I., mbi raportin e ushtruar nga DPD në G. F. I., referuar Urdhrit nr. 30, date 07.04.2017 te Ministrit të Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka zbatuar programin vjetor të kontrollit të kompanisë Koncesionare "G. F. I. A." sh.p. k, për vitin 2017.

***Grupit të Auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacion mbi kontrollet e ushtruara në vitet në vijim.***

Monitorimi i sasive të karburantit të markuar dhe monitoruar:

Drejtoria e Kontrollit të Akcizës dhe Pas zhdoganimit e DPD disponon dokumentacion për vitin 2022 dhe 2023 në lidhje me raportet e monitorimit dhe markimit në vijim të punës së kryer nga specialistët e G. F. I. A. dhe atyre të DPD. Për periudhat e mëparshme nuk janë vënë në dispozicion raporte përkatëse.

Dokumentacioni i administruar nga Grupi i Auditimit në lidhje me raportimin dhe monitorimin e zbatimit të Kontratës Koncesionare, nga ana e MFE dhe DPD, është i paplotë dhe nuk jep informacion për kontrollet e kryera përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Gjithashtu konstatohet se të njëjtat problematika në ofrimin e shërbimeve përsëriten vit pas viti dhe nuk rezultojnë të jenë marra masa për zgjidhjen e tyre apo të jenë vendosur sanksione.

Monitorimi i kontratës së markimit dhe monitorimit të karburantit, nuk mund të mbetet vetëm në kuadër të verifikimit të ofrimit të shërbimit, e cila nuk përbën vlerësimin e performancës së kontratës koncesionare apo ofrimit të shërbimit.

Kuptimi i monitorimit të një kontrate koncesionare/PPP lidhet në mënyrë direkte me vlerën e shtuar që ofron shërbimi i ofruar nga shoqëria koncesionare. Arsyeja se përse një shërbim ofrohet përmes procedurave të Partneritetit Publik-Privat është pikërisht fakti që një shoqëri private mund ta ofrojë më me efektivitet dhe efikasitet këtë shërbim pasi strukturat shtetërore nuk kanë kapacitetin e mjaftueshëm për ta bërë këtë. Në këtë kuadër, konstatohet se nga MFE dhe DPD nuk është ndërmarrë asnjë hap për të orientuar monitorimin e kontratës koncesionare në kuadër të vlerësimit të performancës së saj dhe vlerës së shtuar të ofrimit të shërbimit të monitorimit dhe markimit.

**14. Titulli i gjetjes:** Parregullsi lidhur me monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontratës koncesionare

**Situata:** Nga auditimi rezultojnë se dokumentacioni i administruar nga Grupi i Auditimit në lidhje me raportimin dhe monitorimin e zbatimit të Kontratës Koncesionare, nga ana e MFE dhe DPD, është i paplotë dhe nuk jep informacion për kontrollet e kryera përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Gjithashtu konstatohet se të njëjtat problematika në ofrimin e shërbimeve përsëriten vit pas viti dhe nuk rezultojnë të jenë marrë masa për zgjidhjen e tyre apo të jenë vendosur sanksione.

Nga MFE dhe DPD nuk janë ndërmarrë hapa për të orientuar monitorimin e kontratës koncesionare në kuadër të vlerësimit të performancës së saj dhe vlerës së shtuar të ofrimit të shërbimit të monitorimit dhe markimit dhe se nuk mund të mbetet vetëm në kuadër të verifikimit të ofrimit të shërbimit.

**Kriteri:** - VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur midis MFE dhe bashkimit të përkohshëm të “G. F. I.” S.A dhe “P. C. P” A.G, i ndryshuar

- Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

**Ndikimi/Efekti:** Autoriteti Kontraktues nuk kanë ngritur një strukturë të përshtatshme organizative për mbikëqyrjen e kontratës dhe vlerësimit të përmbushjes së përfitimeve që rezultojnë nga partneriteti publik privat në ofrimin e shërbimeve

**Shkaku:** Mungesa e një strukturë të përshtatshme organizative për mbikëqyrjen e kontratës kanë sjellë mungesën e vlerësimit të performancës së Shoqërisë Koncesionare për ofrimin e të markimit dhe monitorimit.

**Rëndësia:** E lartë

**14.1 Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masat për ngritjen e një grupi pune për kryerjen e një analize të plotë kosto përfitim me qëllim konstatimin e problematikave, marrjen e masave për zgjidhjen e tyre ose vendosjen e sanksioneve; si dhe vlerësimin performancës së shoqërisë koncesionare dhe vlerës së shtuar të ofrimit të shërbimit të monitorimit dhe markimit.

### **2.3.2 Auditimi i fazës së investimit të koncesionit**

Sa i përket auditimit të këtij drejtimi, subjektet (MFE dhe DPD) nuk kanë vendosur në dispozicion të grupit të auditimit informacion/dokumentacion lidhur me: afatet e fillimit të investimit; shpronësime të mundshme; leje ndërtimi; vonesa në fillimin e punimeve në urat e ngarkimit së bashku me arsyet/penalitetet përkatëse; përmbushja e etapave të parashikuara në kryerjen e ndërtimit dhe montimit të pajisjeve; shmangie nga projekti në ndërtim dhe shkaqet e këtyre shmangieve së bashku me pasojat përkatëse.

### **Mbi investimet e kryera sipas parashikimeve në Kontratën Koncesionare**

Lidhur me vlerën e investimit, shtojca 5 “Plani i investimeve dhe Oferta Financiare” parashikon investimet që duhet të kryhen gjatë kohëzgjatjes së kontratës nga shoqëria koncesionare G. F. I.” S.A. dhe “P. C. P” A.G”

Në Planin e Investimeve janë përcaktuar zërat e mëposhtëm të sqaruar si në vijim:

- Shpenzimet Kapitale (CAPEX)

Shpenzimet Kapitale janë si në vijim:

a. Shoqëria HQ dhe njësia e prodhimit të shënjesit – USD 900,000 (ekuivalenti 900,000,000 ALL)

I. Zyrat e Menaxhimit

II. Njësitë e magazinimit

- 5 kontenierë 10,000 litra
- Pompa elektrike dhe sisteme injektimi
- Zona logjistike – 1000 m<sup>2</sup>

a. Analizuesit për monitorim – vlerësuar USD 750,000 (ekuivalenti 750,000,000 ALL)

b. Infrastruktura IT dhe Software – vlerësuar USD 230,000 (ekuivalenti 230,000,000 ALL)

c. Njësitë e shënjimit(8 -12) – vlerësuar USD 950,000 – 1,450,000 (ekuivalenti -950,000,000 ALL – 1,450,000,000 ALL)

d. Sistemi automatik i shënjimit – vlerësuar USD 620,000 (ekuivalenti 620,000,000 ALL)

e. Mjetet e monitorimit – 5SUV në të gjithë vendin – vlerësuar USD 150,000 (ekuivalenti 150,000,000 ALL)

f. Pajisjet dhe të tjera – vlerësuar USD 70,000 (ekuivalenti 70,000,000 ALL)

Totali 417,000,000 ALL (ose ekuivalenti USD 4,170,000)

- Kapitali i punës OPEX – vlerësuar USD 900,000 për 6 (gjashtë) muaj

Kapitali OPEX i kërkuar për projektin është si më poshtë:

a. Inventari i shënjesit për 6 (gjashtë) muaj në magazinën qendrore

b. Inventari i shënjesit për 2 (dy) muaj në çdo njësi shënjimi



c. Fuqia punëtore e vlerësuar për prodhimin, shënjim dhe testim është afërsisht 85 punonjës

**Tabela 2:** Projektioni i vlerës së investimit për 10 vite sipas Planit të Investimit të shoqërisë koncesionare

Në lekë

PLANI I INVESTIMEVE												
Parashikimi në lekë	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	1
<b>Totali i shpenzimeve kapitale</b>												<b>449,109,000</b>
Godina (depozita) dhe asetet fikse	39,956,700											39,956,700
Makineri dhe pajisje	131,178,600					124,070,400					124,070,400	379,319,400
Infrastruktura IT	29,079,000											29,079,000
pajisje zyre	753,900											753,900
<b>Bilanci i hapjes</b>												
Godina (depozita) dhe asetet fikse	39,956,700	39,957,783	37,009,893	35,159,399	33,401,429	31,731,357	30,144,789	28,637,550	27,205,672	25,845,389	24,553,119	
Makineri dhe pajisje	131,178,600	118,060,740	94,448,592	75,558,874	60,447,099	124,070,400	99,256,320	79,405,056	63,524,045	50,819,236	124,070,400	
Infrastruktura IT	29,079,000	29,444,125	19,083,094	14,312,320	10,734,240	8,050,680	6,038,010	4,528,508	3,396,381	2,547,286	1,910,464	
pajisje zyre	753,900	678,510	542,808	434,246	347,397	277,918	222,334	177,867	142,294	113,835	91,068	
<b>TOTALI</b>	<b>200,968,200</b>	<b>183,141,158</b>	<b>151,084,387</b>	<b>125,464,839</b>	<b>104,930,165</b>	<b>164,130,355</b>	<b>135,661,454</b>	<b>112,748,891</b>	<b>94,268,392</b>	<b>79,325,745</b>	<b>150,625,052</b>	

Me shkresën nr. 18628/2 prot., datë 03.10.2016 nga ana e DPD është përcjellë në Ministrinë e Financave raportimi i kontrollit të ushtruar në koncesionarin "G. F. I. A."shpk.

Në total plani i investimeve, sipas shtojcës nr. 5 të kontratës, deri në vitin e pestë të kontratës është 200,968,200 lekë dhe 449,109,100 lekë në total si 10 vjeçar. Sipas analizës së DPD për investimet e kryera gjatë periudhës 2013 – 31.07.2016 ka rezultuar se:

- Plani i investimeve në total sipas kontratës është 200,968,200 lekë, nga të cilat është realizuar 179,043,220 lekë ose 89.1%, me diferencë në vlerë absolute 21,924,981 lekë.
- Nuk është zbatuar struktura e investimeve sikurse është parashikuar në kontratë Shtojca nr.5):
  - Nga të dhënat rezulton se janë kryer më shumë investime se janë parashikuar në kontratë në zërin "ndërtime gjithsej - ndërtime, përmirësime, toka" - nga plani prej 39,956,700 leke është realizuar shuma për 113,171,759 ose +73,215,059 leke më shumë se plani.
  - Në zërin "orendi e pajisje zyre" nga 753,900 lekë janë realizuar në fakt 6,245,120 lekë ose + 5,491,220 leke më shumë se plani.
  - Rezulton të jenë kryer më pak se parashikimi në kontratë investime, në zërin "makineri

e pajisje gjithsej - makineri e pajisje, instalime të përgjithshme, mjete transporti"- nga plani prej 131,178,600 leke, janë realizuar në fakt 44,978,295 lekë ose – 86,200,306 lekë më pak se plani.

- Në zërin "infrastruktura IT" nga plani prej 29,079,000 lekë, janë realizuar në fakt 14,648,046 lekë, ose – 14,430,954 lekë, më pak se plani.
- Në llogarinë nr. 212 "ndërtime" është përfshirë edhe zëri "Përmirësime në qiramarrje" në shumën 7,640,879 lekë. Vlerësojmë se sipas klasifikimit ekonomik të llogarive kontabël zëri "Përmirësime në qiramarrje" klasifikohet si shpenzime qiraje dhe jo si investim.

Në vitin 2017 nga ana e DPD është kryer serish kontrolli i investimeve të kryera nga shoqëria Koncesionare, ku kanë rezultuar të njëjtat problematika si në vitin 2016. Nga të dhënat e administruara në vitin 2017 plani i investimeve në total sipas kontratës është 200,968,200 lekë, nga të cilat është realizuar 181,247,434 lekë ose 90%, me diferencë në vlerë absolute 19,720,766 lekë.

Me shkresën nr. 7878/1 prot., datë 10.05.2021 nga ana e DPD është përcjellë në Ministrinë e Financave raportimi lidhur me monitorimin dhe verifikimin e kontratës së koncesionit. Sa i përket detyrimit për kryerjen e investimeve nga shoqëria Koncesionare, DPD ka konstatuar se sipas raportimeve të koncesionarit, bazuar në Pasqyrat Financiare të audituara të vitit 2020, koncesionari ka realizuar investime në shumën 309,175,765 lekë. Neni 1 i kontratës parashikon që shuma totale e investimeve është 4,170,000 USD. Rrjedhimisht, përlllogaritet që koncesionari ka realizuar rreth 73% të totalit të investimeve. Ky nivel realizimi lidhet edhe me faktin se markimi i naftës bruto nuk ka filluar ende dhe koncesionari, për shkaqe jashtë kontrollit të tij, nuk ka arritur të kryejë plotësisht investimet që lidhen me markimin e naftës bruto.

Grupit të auditimit nuk i janë vënë në dispozicion raportet periodike të kontrollit të ushtruar në shoqërinë koncesionare, në përputhje me nenin 6, pika 6.1, iii "Mbikëqyrja e Përgjithshme". Gjithashtu rezulton se në kontrollet e ushtruara me qëllim verifikimin e kryerjes së investimeve, grupet e punës të AK i janë referuar vetëm pasqyrave financiare dhe informacionit të sjellë nga shoqëria koncesionare. Nga ana e AK nuk rezulton të jenë kryer verifikime fizike për kryerjen e investimeve në përputhje me planin e investimeve sipas shtojcës nr. 5 të Kontratës Koncesionare.

Nga auditimi rezultoi konstatoi se nga ana e Autoriteti Kontraktor nuk është kryer një vlerësim i thelluar i investimit, duke u bazuar në dokumentacion vërtetues e justifikues për të nxjerrë një vlerë të investimit të kryer, si dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim të mirëfilltë për analizimin e shkaqeve që kanë sjellë moskryerjen e këtij vlerësimi, për të nxjerrë personat përgjegjës dhe për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e situatës.

**15. Titulli i gjetjes:** Mungesë e vlerësimit të investimit të shoqërisë koncesionare nga ana e autoriteteve shtetërore

**Situata:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në përmbushje të rolit dhe kompetencave ligjore, ka ushtruar kontrolle në përmbushje të pikës 5.8 të Kontratës Koncesionare në vitet 2016, 2017

dhe 2021. Me shkresën nr. 18628/2 prot., datë 03.10.2016, dhe shkresën nr. 7878/1 prot., datë 10.05.2021, nga ana e DPD janë përcjellë në Ministrinë e Financave raportimet e kontrolleve të ushtruar në koncesionarin “G. F. I. A.” shpk mbi monitorimin dhe zbatimin e Kontratës Koncesionare, ndër të tjera edhe mbi vlerësimin e investimit.

Konkluzionet e grupeve të punës mbi vlerësimin e investimit nuk janë bazuar në situacione punimesh, fatura dhe dokumentacion tjetër me natyrë vërtetuese, por vetëm në pasqyrat financiare dhe argumentet e shoqërisë koncesionare.

Pavarësisht korrespondencave vijuese ndërmjet palëve të përfshira në proces, Ministrisë së Financave, autoriteteve doganore, shoqërisë koncesionare, autoriteteve shtetërore, jo vetëm që nuk kanë kryer një vlerësim të thelluar të investimit, duke u bazuar në dokumentacion vërtetues e justifikues për të saktësuar vlerën e investimit të kryer, por nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim të mirëfilltë për analizimin e shkaqeve që kanë sjellë moskryerjen e këtij vlerësimi, për të nxjerrë përgjegjësitë dhe për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e situatës.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, shoqëria nuk rezulton të ketë përmbushur plotësisht këto detyrime pasi nga analiza e DPD, investimi i kryer nga shoqëria koncesionare rezulton në vlerë më të ulët se ai i parashikuar në propozim si dhe nga ana e strukturave të ngarkuara me monitorimin e kësaj kontrate nuk rezulton të jenë ndërmarrë hapa konkrete mbi evidentimin e situatës dhe marrjen e masave ndaj shoqërisë koncesionare.

**Kriteri:** VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur midis MFE dhe bashkimit të përkohshëm të “G. F. I.” S. A dhe “P. C. P” A. G, i ndryshuar.

Kontrata Koncesionare dhe Shtojcat e kontratës

Plani i Biznesit të shoqërisë koncesionare, ku bën pjesë dhe Plani i Investimit

**Ndikimi/Efekt:** Vlera më e ulët e investimit faktik në raport me propozimin ndikon në kthimin më herët në kohë (më i shpejtë) të investimit të shoqërisë si dhe në përqesimin e treguesve financiarë për AK në terma të normës së brendshme të kthimit dhe kohës së kthimit nga investimi dhe përmirësimin e këtyre treguesve për shoqërinë koncesionare.

**Shkaku:** Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk kanë kryer një analizë të thelluar mbi zbatimin e detyrimeve të shoqërisë koncesionare, të parashikuara në kontratë dhe në propozim.

**Rëndësia:** E lartë

**15.1 Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masat për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga MFE dhe DPD, me qëllim (i) kryerjen e një vlerësimi të plotë mbi ecurinë e zbatimit të kontratës koncesionare edhe monitorimin e komponentëve të saj, (ii) evidentimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në përmbushjen e detyrimeve nga ana e shoqërisë koncesionare, si dhe (iii) përllogaritjen e impaktit financiar të këtyre mos përmbushjeve nga ana e shoqërisë koncesionare, në raport me propozimin.

Nga ana e grupit të auditimit u analizuan zërat përbërës të llogarisë së Aktiveve Afatgjata për periudhën 2013 – 2020 sipas Pasqyrave Financiare të shoqërisë Koncesionare. Sa më sipër konstatohet se ka një mospërputhje të vlerës së investimit të kryer për këtë periudhë, sipas pasqyrave financiare, dhe vlerës së paraqitur në raportin e kontrollit të ushtruar nga DPD me nr. 7878/1 prot., datë 10.05.2021. Konkretisht nga analiza e pasqyrave financiare rezulton se

vlera e investimit të kryer për periudhën 2013 – 2020 është 227,619,107 lekë, ndërsa në raportin me nr. 7878/1 prot., datë 10.05.2021 të DPD rezulton se vlera e investimit është 309,175,765 lekë. Pra diferenca mes dy analizës së kryer nga grupi i auditimit dhe vlerësimit të DPD është -81,556,658 lekë.

Grupi i auditimit analizoi zërat përbërës të llogarisë së Aktiveve Afatgjata për periudhën 2013 – 2022 sipas Pasqyrave Financiare të shoqërisë Koncesionare. Sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrat financiare konstatohet se nuk është ndjekur struktura e investimeve e paraqitur në shtojcën nr. 5 të Kontratës Koncesionare “Plani i Investimeve”, duke krijuar problematika në verifikimin e investimeve për zërat specifik. Gjithashtu referuar të dhënave të Pasqyrave Financiare rezulton së realizimi i investimeve është në masën 68%, sipas tabelës së mëposhtme.

EMERTIMI	TOTALI PLAN	TOTALI FAKTIK	DIFERENCA FAKT NGA PLANI	Në përqindje
Toka	-	27,558,990		
Ndërtesa	39,956,700	-		
Përmirësim në Qiramarrje	-	19,073,079		
<b>TOTALI</b>	39,956,700	46,632,069	6,675,369	
Makineri dhe pajisje	255,249,000	83,855,841		
Mjete transporti	-	33,015,918		
<b>TOTALI</b>	255,249,000	116,871,759	(138,377,241)	
Kompjutera dhe pajisje informatike	29,079,000	50,964,687		
<b>TOTALI</b>	29,079,000	50,964,687	21,885,687	
Orendi dhe pajisje zyre	753,900	7,019,542		
<b>TOTALI</b>	753,900	7,019,542	6,265,642	
<b>TOTALI</b>	<b>325,038,600</b>	<b>221,488,057</b>	<b>(103,550,543)</b>	<b>68%</b>

**16. Titulli i gjetjes:** Mospërputhje ndërmjet zërave të aktiveve të raportuara në pasqyrat financiare të Shoqërisë Koncesionare dhe planit të investimit të paraqitur në shtojcën nr. 5 të Kontratës Koncesionare.

**Situata:** Sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë Koncesionare, për periudhën 2013 – 2022, rezultoi se nuk është ndjekur struktura e investimeve e paraqitur në shtojcën nr. 5 të Kontratës Koncesionare “Plani i Investimeve”, duke krijuar problematika në verifikimin e investimeve për zërat specifik. Gjithashtu referuar të dhënave të Pasqyrave Financiare rezulton së realizimi i investimeve është në masën 68%.

**Kriteri:** -VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur midis MFE dhe bashkimit të përkohshëm të “G. F. I.” S.A dhe “P. C. P” A. G, i ndryshuar.

-Kontrata Koncesionare dhe Shtojcat e kontratës

-Plani i Biznesit të shoqërisë koncesionare, ku bën pjesë dhe Plani i Investimit

**Ndikimi/Efekti:** Ndryshimet në strukturën e investimeve krijojnë vështirësi për verifikimin e realizimit të planit të investimit sipas shtojcës nr. 5 të kontratës koncesionare.

**Shkaku:** Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk kanë kryer një analizë të thelluar mbi zbatimin e detyrimeve të shoqërisë koncesionare, të parashikuara në kontratë dhe në propozim.

**Rëndësia:** E lartë

**16.1 Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga MFE dhe DPD, me qëllim (i) kryerjen e një vlerësimi të plotë të

investimit, duke evidentuar devijimet e mundshme nga propozimi fillestar, (ii) evidentimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në përmbushjen e detyrimeve nga ana e shoqërisë koncesionare, si dhe (iii) përlllogaritjen e impaktit financiar të këtyre mos përmbushjeve nga ana e shoqërisë koncesionare, në raport me propozimin.

- Nga auditimi rezultoi se kanë ndodhur pakësime në zërat e llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale, konkretisht:

- Llogaria 212 “Ndërtesa” është pakësuar plotësisht në vlerën 77,971,890 lekë, në vitin 2019.
- Llogaria 213 “Makineri dhe Pajisje” është pakësuar në vlerën 1,645,346 lekë, në vitin 2018.
- Llogaria 2182 “Kompjuteri dhe pajisje informatike” është pakësuar në vlerën 879,705 lekë, në vitin 2018.

Në shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare nuk ka asnjë informacion mbi arsyet përse kanë ndodhur këto pakësime, të cilat ndikojnë në mënyrë direkte në përmbushjen e detyrimit të kryerjes së investimeve sipas shtojcës nr. 5 të kontratës.

- Në llogarinë nr. 212 "Ndërtim", nga viti 2013 deri në vitin 2018 është përfshirë edhe zëri "Përmirësime në qiramarrje" në vlerë totale 19,073,079 lekë. Vlerësojmë se sipas klasifikimit ekonomik të llogarive kontabël zëri "Përmirësime në qiramarrje" klasifikohet si shpenzime qiraje dhe jo si investim, duke krijuar rritje artificiale të vlerave të investimit.
- Në klasën e Aktiveve Afatgjata Jo materiale janë përfshirë shpenzime nisje në vlerën 31,227,670 lekë, në vitin 2018, por nuk ka asnjë shpjegim apo analizë analitike se kujt i referohet kjo vlerë dhe për cilën pjesë të planit të investimit është kryer.

**17. Titulli i gjetjes:** Mungesë e informacionit në pasqyrat financiare me ndryshimet e ndodhura gjatë viteve në klasën e Aktiveve Afatgjata.

**Situata:** Sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë Koncesionare, për periudhën 2013 – 2022, rezultoi se kanë ndodhur pakësime në zërat e llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale, konkretisht:

- Llogaria 212 “Ndërtesa” është pakësuar plotësisht në vlerën 77,971,890 lekë, në vitin 2019.
- Llogaria 213 “Makineri dhe Pajisje” është pakësuar në vlerën 1,645,346 lekë, në vitin 2018.
- Llogaria 2182 “Kompjuteri dhe pajisje informatike” është pakësuar në vlerën 879,705 lekë, në vitin 2018.

Në shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare nuk ka asnjë informacion mbi arsyet përse kanë ndodhur këto pakësime, të cilat ndikojnë në mënyrë direkte në përmbushjen e detyrimit të kryerjes së investimeve sipas shtojcës nr. 5 të kontratës.

Në llogarinë nr. 212 "Ndërtim", nga viti 2013 deri në vitin 2018 është përfshirë edhe zëri "Përmirësime në qiramarrje" në vlerë totale 19,073,079 lekë. Vlerësojmë se sipas klasifikimit ekonomik të llogarive kontabël zëri "Përmirësime në qiramarrje" klasifikohet si shpenzime qiraje dhe jo si investim, duke krijuar rritje artificiale të vlerave të investimit

Në klasën e Aktiveve Afatgjata Jo materiale janë përfshirë shpenzime nisje në vlerën 31,227,670 lekë, në vitin 2018, por nuk ka asnjë shpjegim apo analizë analitike se kujt i referohet kjo vlerë dhe për cilën pjesë të planit të investimit është kryer.

**Kriteri:** -VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur midis MFE dhe bashkimit të përkohshëm të “G. F. I.” S.A dhe “P. C. P” A. G, i ndryshuar.

-Kontrata Koncesionare dhe Shtojcat e kontratës

-Plani i Biznesit të shoqërisë koncesionare, ku bën pjesë dhe Plani i Investimit

- Ligji nr. 25/2018, “Për Kontabilitetin Dhe Pasqyrat Financiare”

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e informacionit mbi lëvizjet në zërat e aktiveve afatgjata krijon vështirësi në verifikimin e realizimit të investimit të kryer nga shoqëria koncesionare në përputhje me shtojcën nr. 5 të kontratës.

**Shkaku:** Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk kanë kryer një analizë të thelluar mbi zbatimin e detyrimeve të shoqërisë koncesionare, të parashikuara në kontratë dhe në propozim.

**Rëndësia:** E lartë

**17.1 Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga MFE dhe DPD, me qëllim (i) kryerjen e një vlerësimi të plotë të investimit, duke evidentuar devijimet e mundshme nga propozimi fillestar, (ii) evidentimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në përmbushjen e detyrimeve nga ana e shoqërisë koncesionare, si dhe (iii) përlogaritjen e impaktit financiar të këtyre mos përmbushjeve nga ana e shoqërisë koncesionare, në raport me propozimin.

Në Aneksin 1, të planit të investimit të kontratës koncesionare paraqitet afati (në ditë) për përmbushjen e detyrimeve lidhur me fillimin e ofrimit të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburantit, në vendndodhjet si më poshtë vijon:

**Tabela 1: Aneksi 1 mbi fillimin e aktiviteteve**

	Aktiviteti	Vendndodhje	Fillimi I aktivitetit (të jetë të paktën 30 ditë përpara markimit)	Fillimi I markimit
1	Mazut dhe Solar markim manual	Rafineria Fier	Fillim i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses & instalime	01.07.2013
2	Terminal karburanti, markim manual	Terminali T. i në Porto Romano	Fillim i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses & instalime	01.07.2013
3	Terminal karburanti, markim manual	Terminali i karburantit A. në Porto Romano	Fillim i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses & instalime	01.07.2013
4	Terminal karburanti, markim manual	Terminali i karburantit K. në Porto Romano	Fillim i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses & instalime	01.07.2013
5	Njësitë lëvizëse të markimit të vendosura nëpër makina Mobile marking units, by car	Doganat, Kufiri	Fillim i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses & instalime	01.07.2013
6	Njësitë e inspektimit XRF	Identifikim i vendndodhjes së produkteve të naftës në Shqipëri	Fillim i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses & instalime	01.07.2013
7	Markimi automatik i naftës bruto	Terminali i ngarkimit i B. P. në Fier	Fillim i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses & instalime	01.08.2013
8	Markimi manual i naftës bruto	Terminali i ngarkimit i T. O. në Visokë	Fillim i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses & instalime	01.10.2013
9	Markimi manual i naftës bruto	Terminali i ngarkimit i S. O. në Usojë	Fillim i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses & instalime	01.10.2013
10	Markimi manual i naftës bruto	Terminali i ngarkimit i S. O. në Gorisht	Fillim i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses & instalime	01.10.2013

Sa i përket procesit të fillimit të operacioneve të markimit dhe të monitorimit grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë dokumentacion që vërteton përmbushjen e detyrimit të kryerjes së investimit nga shoqëria koncesionare sipas afateve të përcaktuara në Aneksin 1 të planit të

investimit. Gjithashtu Grupit të auditimit nuk i janë vënë në dispozicion shkresat njoftuese mbi fillimin e operacioneve në vendndodhjet e përcaktuara sa më sipër.

**18. Titulli i gjetjes:** Mungesë e informacionit mbi përmbushjen e detyrimit të shoqërisë koncesionare për kryerjen e investimit sipas afateve të përcaktuara në Aneksin 1 të Planit të Investimit.

**Situata:** Nga auditimi mbi kryerjen e investimeve nga shoqëria koncesionare në zbatim të pikës 5.8 të Kontratës koncesionare e cila përcakton, ndër të tjera, detyrimin e shoqërisë për të kryer investimin sipas afatit të parashikuar në përputhje me Shtojcën 5 të Kontratës, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion që vërteton përmbushjen e detyrimit të kryerjes së investimit nga shoqëria koncesionare sipas afateve të përcaktuara në Aneksin 1 të Planit të Investimit.

**Kriteri:** -VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur midis MFE dhe bashkimit të përkohshëm të “G. F. I.” S.A dhe “P. C. P” A. G, i ndryshuar.

-Kontrata Koncesionare dhe Shtojcat e kontratës

-Plani i Biznesit të shoqërisë koncesionare, ku bën pjesë dhe Plani i Investimit

**Ndikimi/Efekt:** Pamundësi në verifikimin e përmbushjes së detyrimit të shoqërisë koncesionare për kryerjen e investimit sipas afateve të përcaktuara në Aneksin 1 të Planit të Investimit

**Shkaku:** Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk kanë kryer një analizë të thelluar mbi zbatimin e detyrimeve të shoqërisë koncesionare, të parashikuara në kontratë dhe në propozim.

**Rëndësia:** E lartë

**18.1 Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga MFE dhe DPD, me qëllim (i) kryerjen e një vlerësimi të plotë të investimit, duke evidentuar devijimet e mundshme nga propozimi fillestar, (ii) evidentimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në përmbushjen e detyrimeve nga ana e shoqërisë koncesionare, si dhe (iii) përlllogaritjen e impaktit financiar të këtyre mos përmbushjeve nga ana e shoqërisë koncesionare, në raport me propozimin.

### ***2.3.3 Rezultatet e verifikimit të kryer mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratës***

Në lidhje me zbatimin dhe monitorimin e kontratës koncesionare, grupi i auditimit zhvilloi dhe një verifikim në terren me objekt si më poshtë:

Kontroll për të verifikuar nëse shërbimet e markimit dhe monitorimit të ofruara nga koncesionari janë në përputhje me Ofertën Teknike, me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit si dhe kontratën koncesionare “Për Shërbimin E Markimit dhe Monitorimit Të Karburanteve”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “G. F. I.” S.A. dhe “P. C. P” A.G” të miratuar me VKM nr. 200, datë 13.03.2013.

Verifikimi i objektit të mësipërm u krye në ambientet e terminalit Porto Romano, Durrës.

Pas negocimit dhe miratimit të kontratës me VKM nr. 200, datë 13.03.2013, operacionet e markimit të karburanteve në terren kanë nisur në 14.08.2013, ndërsa procesi i monitorimit të tregut të karburanteve të rafinuara ka nisur në datë 23.06.2014.

Sipas shtojcës 4 të kontratës së koncesionit është parashikuar se karburantet që do të shënjohehen për qëllime fiskale janë:

1. Naftë D1 me kod doganor 27101943
2. Naftë D2 me kod doganor 27101946, 27101948
3. Benzinë pa plumb
4. Solar/ Mazut
5. Naftë bruto

Shërbimi i markimit përbën një proces që konsiston në injektimit e markuesit/shënjesit nga ana e koncesionarit në produktet e markimit. Për këtë arsye, është parashikuar paraprakisht nga shtojca 2 (bashkëlidhur kontratës) se markuesi duhet të ketë jetëgjatësi dhe të ruajë specifikimet e karburantit që markohet. Markuesi Petromark tm është miratuar nga Këshilli i Ministrave me anë të VKM –së nr. 498, datë 30.05.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. Produktet e markimit dhe monitorimit duhet të gjenden pranë terminaleve të cilat përdoren nga subjektet e detyruara, si subjekte që kryejnë aktivitet me produktet e markimit dhe janë që detyrohen të paguajnë detyrimet fiskale. Në mënyrë që të realizohet ky proces i markimit të naftës bruto, duhet që ajo të përmbushë kushtet e viskozitetit, pra të jetë në gjendje të lëngshme.

Pas kryerjes së testeve të markimit, lind si domosdoshmëri monitorimi apo kontrolli i këtyre rezultateve përfundimtare, nëpërmjet pajisjeve të monitorimit të cilat duhet të jenë të lehta dhe të thjeshta për t’u përdorur, pa pasur nevojë për ndonjë aftësi specifike të operatorëve. Rezultatet përfundimtare mund të jenë “kaluese” ose “ngelëse”. Për këtë pjesë të procesit, është dhënë garanci nga koncesionari, në trajtën e një deklaratë ku personi i autorizuar i koncesionarit ka garantuar se rezultatet e testeve përfundimtare përfitohen në vend, nga laboratorit i lëvizshëm, Brenda 10 minutave, pa qenë nevoja për një miratim në një laborator qendror.

### **Procesi i markimit të hidrokarbureve (nga deklaratat e importit deri në daljen nga ambientet e zonës së lirë, Porto Romano)**

Importi i hidrokarbureve nis me njoftimin e mbërritjes së anijes në Port nga agjencitë spediconere detare ku i drejtohen kapitenerisë së portit, dispeçerisë së portit, doganës së portit dhe sigurisë MBM dhe Komisarariatit të policisë kufitare MBM Porto Romano Durrës, me të dhënat e anijes, datën dhe orën e mbërritjes dhe me të dhënat mbi llojin dhe sasinë e ngarkesës si dhe pritësin e mallit.

Pas marrjes së njoftimit, Dega e Doganës Durrës, nxjerr lejen mbi shkarkimin e anijes pas shqyrtimit të dokumentacionit (deklaratat e kapitenit, Manifesti i dërgesës, fatura e ngarkimit, certifikata e sasisë, certifikata e lëvizjes së mallrave, fatura e mostrës, certifikata e analizës, deklaratat e përgjithshme e kapitenit, deklaratat e inventarizimit të anijes, lista e ekuipazhit të anijes, lista e ndalesave të anijes, deklaratat e ekuipazhit, deklaratat e 10 porteve të fundit, të dhënat e anijes, manifesti i nisjes së mallrave, plani i magazinimit në Porto Romano, procesverbal mbiurvejimin dhe marrjen së mostrave të karburantit, procesverbal mbi marrjen



e mostrës para zhdoganimit nga ISHTI, kërkesa e DINGN mbi lejimin e zhdoganimit të karburantit mbi plotësimin e kërkesave të standardeve bashkëlidhur raporti i testimi nga ISHTI, Akt kontrolli me metodën e zhytjes nga grupi A/K detare, procesverbal mbi matjet dhe plumbosjet e depozitës para shkarkimit të anijes).

Procesi i markimit ne terminalin Porto Romano bëhet në këtë mënyrë :

Pasi mbushen me karburant në magazinën me anë të vinçit – urë, autobotet që transportojnë karburantin janë të detyruara të shkojnë tek vendndodhja e përcaktuar për markim, e cila ndodhet brenda zonës së magazinës.

Ekipit të markimit të G. F. I. i paraqitet dokumenti i transportit (faturë TVSH) që tregon shumën totale të karburantit, lexuesin përkatës të matësit në secilën prej ndarjeve të automjetit. (foto ilustruese ne anekse)

Nga ana e punonjësve të G. F. I. sh.p.k., bëhet një përlllogaritje e sasisë së Markuesit te Gatshëm për përdorim të nevojitur për naftën për secilën ndarje (dhomë të botit) dhe përdoren enë matëse për të hedhur manualisht sasinë e saktë të markuesit ne kapanxhë. (foto ilustruese ne anekse)

Më pas vijon me hedhjen e sasisë së markuesit të përgatitur në autobotin e ngarkuar. (foto ilustruese ne anekse)

Nga ana e punonjësve të G. F. I. sh.p.k. plotësohet formulari mbi konfirmimin e shërbimit të markimit ku shënohen të dhënat mbi llojin dhe volumin e karburantit, volumi i markuesit, të dhënat mbi autobotin, kompania e karburantit etj., si dhe shoferi i autobotit është dëshmitarë i hedhjes së dozës së caktuar të markuesit në karburant dhe për këtë duhet të firmos në dokumentin e markimit.

Më pas u vijua me plotësimin e procedurës së thjeshtuar doganore për lejimin e daljes së autobotit nga zona e lirë doganore. (foto ilustruese ne anekse)

#### **19. Titulli i gjetjes:** Problematika në lidhje me zbatimin e kontratës

**Situata:** Gjatë zhvillimit të procesit të auditimit, grupi i auditimit zhvilloi një verifikim në terren me objekt si më poshtë:

Kontroll për të verifikuar nëse shërbimet e markimit dhe monitorimit të ofruara nga koncesionari janë në përputhje me Ofertën Teknike, me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit si dhe kontratën koncesionare “Për Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “G. F. I.” S.A. dhe “P. C. P”A.G” të miratuar me VKM nr. 200, datë 13.03.2013. Nga verifikimi rezultoi që:

Verifikimi në terren mbi zbatimin e kontratës, u krye në bashkëpunim me punonjësit e Sektorit të Produkteve Energjitike, Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës, Dogana Shqiptare, pasi nga ana autoriteti kontraktor nuk është caktuar Menaxher i Projektit, gjë që e vështirësonte kryerjen e auditimit mbi zbatimin e kontratës.

Nga ana e grupit të auditimit u kërkua dokumentacioni në lidhje me trajnimet e vazhdueshme ku u evidentua se nuk është dokumentuar kryerja e trajnimeve të vazhdueshme ndërmjet punonjësve të subjektit G. F. I. sh.p.k. si dhe punonjësve të doganës përgjegjës mbi monitorimin dhe kontrollin mbi zhvillimin e koncesionit.

Procesi i markimit është tërësisht manual, hapat që ndiqen nga operatorët e G. F. I.-së për të realizuar procesin e markimit nuk janë sipas procedurës të përcaktuar në kontratë, nuk

garantohet përqendrimi i duhur (nuk ndodh homogjenizimi) i markuesit në lëndën djegëse si dhe nuk bëhen prova apo të merren mostra për të verifikuar nëse përqendrimi i markuesit është sipas normave të përcaktuar në marrëveshje, problematika funksionale këto, të prezantuara edhe nga ana e DPD-së.

Investimet nuk janë kryer sipas Planit të Investimeve të deklaruara nga shoqëria koncesionare.

**Kriteri:** -VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur midis MFE dhe bashkimit të përkohshëm të “G. F. I.“ S.A dhe “P. C. P“ A. G, i ndryshuar.

-Kontrata Koncesionare dhe Shtojcat e kontratës

-Plani i Biznesit të shoqërisë koncesionare, ku bën pjesë dhe Plani i Investimit

**Ndikimi/Efekti:** Mos arritje të objektivave të zhvillimit të koncesionit mbi Markimin e Karburanteve.

**Shkaku:** Mospërbushje të kushteve të kontratës

**Rëndësia:** E lartë

**19.1 Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masat për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga MFE dhe DPD, me qëllim (i) kryerjen e një vlerësimi të plotë mbi ecurinë e zbatimit të kontratës koncesionare edhe monitorimin e komponentëve të saj, (ii) evidentimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në përbushjen e detyrimeve nga ana e shoqërisë koncesionare, si dhe (iii) përlllogaritjen e impaktit financiar të këtyre mos përbushjeve nga ana e shoqërisë koncesionare, në raport me propozimin.

## 2.4. Auditimi i amendimit të kontratës

### 2.4.1 Auditimi i amendimit të kontratës për një periudhë 1 vjeçare, mbi arsyet dhe kushtet që çuan në zgjatjen e kontratës

Urdhri i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 202 datë 29.07.2022, “Mbi caktimin e personit përgjegjës në emër të AK me qëllim përgatitjen e procesit të transferimit dhe marrjen në dorëzim të aseteve të kontratës koncesionare për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve” dhe memoja nr.17543/1 datë 01.11.2022 nuk iu vu në dispozicion grupit të auditimit, por me memon nr.7826 prot., datë 28.04.2023, personi përgjegjës në emër të AK, për përgatitjen e procesit të transferimit dhe marrjes në dorëzim të aseteve të koncesionarit, sipas parashikimeve në nenin 20 të kontratës, i ri përcjell informacionin e verifikimit në terren që i ishte bërë e ditur që nga memoja nr.17543/1 datë 01.11.2022.

Urdhri nr.222 datë 23.09.2022, “Për ngritjen e grupit të punës me qëllim vlerësimin e funksionimit aktual të projektit dhe dhënien e propozimeve për vijimësinë e tij pas përfundimit të afatit të kontratës koncesionare për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve” të përbëra nga:

- Znj.I. Z., përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
- Z.E. D., përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
- Znj.E. V., përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave
- Z.D. Ç., përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave
- Z.E. M., përfaqësues i AKSHI

Raporti përfundimtar sipas pikës 4/4 të urdhrin nr. 222 datë 23.09.2022 ku citohet që: “Grupi i punës të paraqesë pranë titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportin

*përfundimtar me propozimet konkrete dhe dokumentacionin përkatës'' nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit gjatë fazës në terren por me observacionin mbi akt-konstatimin. Gjithashtu grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion qëndrimi zyrtar i shoqërisë G. F. I. nr. 60/10 datë 04.10.2022 protokolluar në AK me nr.17924/2 prot., datë 05.10.2022 për mosnjohjen e datës së përfundimit të kontratës sipas parashikimeve në të. Ky qëndrim del e qartë nga memoja e ri përcjellë nr.7826 prot., datë 28.04.2023 Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave konkretisht se nuk mund të procedohet me zbatimin e nenit 20 të kontratës dhe ka propozuar që AK t'i drejtohet Avokaturës së Shtetit lidhur me saktësimin e datës së koncesionit. Gjithashtu me emailin e datës (që nuk iu vu në dispozicion grupit të auditimit) i është kërkuar shoqërisë koncesionare'' *Të vendosi në dispozicion një listë të aseteve të koncesionit në zbatim të nenit 20 pika 4 të kontratës koncesionare. Kjo listë duhet të shoqërohet me vlerën kontabël të tyre, vlerën e aseteve në kohën e blerjes së tyre, amortizimin dhe vlerën aktuale''*. Shoqëria koncesionare nuk i është përgjigjur emailit përse i është kërkuar.*

Gjithashtu me emailin e datës (që nuk iu vu në dispozicion grupit të auditimit) i është kërkuar shoqërisë koncesionare'' *Të vendosi në dispozicion një listë të aseteve të koncesionit në zbatim të nenit 20 pika 4 të kontratës koncesionare. Kjo listë duhet të shoqërohet me vlerën kontabël të tyre, vlerën e aseteve në kohën e blerjes së tyre, amortizimin dhe vlerën aktuale''*. Shoqëria koncesionare nuk i është përgjigjur emailit përse i është kërkuar'', në plotësim të kushteve të urdhrin nr. 222 datë 23.09.2022.

**20. Titulli i gjetjes:** Përmbajtja e memos ka evidentuar konstatime nga deklaratimet e GIP, pa u shoqëruar me verifikimet e nevojshme mbi vlerësimin e funksionimit aktual të projektit dhe dhënien e propozimeve për vijimësinë e tij, nga anëtarët e grupit, përfaqësues të AK, sipas urdhrin, pika 4 e tij.

**Situata:** Gjatë zhvillimit të auditimit në terren, në lidhje me amendimin e kontratës koncesionare, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion Urdhri i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 202 datë 29.07.2022, ''Mbi caktimin e personit përgjegjës në emër të AK me qëllim përgatitjen e procesit të transferimit dhe marrjen në dorëzim të aseteve të kontratës koncesionare për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve'' dhe memoja nr.17543/1 datë 01.11.2022.

Me anë të observacioneve nga personat përgjegjës, nuk është përcjellë praktika e ndjekur nga titullari i AK për marrjen e masave konkrete në lidhje me pamundësinë e ushtrimit të detyrave të urdhrin nr.222 datë 23.09.2022.

Pamundësia e përmbushjes së detyrave të caktuara i është komunikuar titullarit të AK me vonesë të pajustificuar.

**Kriteri:** Kontrata koncesionare e miratuar me VKM nr.200,

Urdhri nr.222 datë 23.09.2022 ''Për ngritjen e grupit të punës me qëllim vlerësimin e funksionimit aktual të projektit dhe dhënien e propozimeve për vijimësinë e tij pas përfundimit të afatit të kontratës koncesionare për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve''

**Ndikimi/Efekti:** Mosvënia në dispozicion e listës së aseteve të koncesionit e shoqëruar me vlerën kontabël të tyre, vlerën e aseteve në kohën e blerjes së tyre, amortizimin dhe vlerën aktuale''.

**Shkaku:** Mosnjohja nga koncesionari e datës së përfundimit të kontratës sipas parashikimeve në të.

**Rëndësia:** E Lartë

**20.1 Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masat për analizimin e situatës duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse në parregullsitë e evidentuara për këtë kontratë, duke ndërmarrë masa të menjëhershme ligjore për eliminimin e tyre, si dhe shqyrtimin e mundësive reale për hartimin e dokumentacioneve sqaruese/plotësuese sipas rastit, me efekte deri në përfundim të afatit të projektit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e Grupit të punës të ngritur për vlerësimin e funksionimit të projektit dhe dhënien e propozimeve për vijimësinë e tij pas përfundimit të afatit të kontratës koncesionare, të përbërë nga: znj. I. Z., z. E. D., znj. E. V., z. D. Ç., z. E. M..

Në lidhje me dy Memot e sipërcituara nr. 17543/1 datë 01.11.2022 dhe nr. 7826 datë 28.04.2023 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nga këto të fundit nuk dokumentohet asnjë shqyrtim apo trajtim të problematikave të konstatuara në këto Memo, por duke vijuar me urdhërin nr.147 datë 29.06.2023 ‘‘Për ngritjen e grupit të punës për negocimin me shoqërinë koncesionare ‘‘***Për ndryshimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve miratuar me VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 të lidhur mes ish Ministrisë së Financave si Autoritet Kontraktues dhe bashkimit të përkohshëm të ‘‘G. F. I.‘‘ s.a dhe ‘‘P. C. P.‘‘ A. G*** i përbërë nga:

- Z. A. B. Anëtar,(Ministria e Financave dhe Ekonomisë);
- Z. E. Gj. Anëtar,(Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve);
- Z. O. K. Anëtar,(Drejtoria e Përgjithshme e Doganave);
- Z. B. F. Anëtar,(Drejtoria e Përgjithshme e Doganave);
- Z. B. T. Anëtar,(Ministria e Financave dhe Ekonomisë);

Referuar memos me nr.11975/1 prot., datë 12.07.2023 dhe nr.11975 prot., datë 01.08.2023 (të cilat kanë pasaktësi ne vendosjen në numrin e vendosur) me objekt: Raporti i grupit të punës së ngritur me urdhrin nr.147 datë 29.06.2023 ‘‘Për ngritjen e grupit të punës për negocimin me shoqërinë koncesionare ‘‘***Për ndryshimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve miratuar me VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 të lidhur mes ish Ministrisë së Financave si Autoritet Kontraktues dhe bashkimit të përkohshëm të ‘‘G. F. I.‘‘ S.A dhe ‘‘P. C. P.‘‘ A. G*** mbi çështjet e ngritura nga data 03-11 korrik 2023 të dala nga mbledhjet për zbatimin e urdhrin si vijon:

Kontrata neni 4 pika 5 parashikon:

*Palët bien dakord se kohëzgjatja e Koncesionit do të shtyhet, vetëm kur ekzistojnë arsyet e mëposhtme objektive të pavarura nga vullneti i Palëve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë dhe vonojnë zbatimin e Projektit të Koncesionit. Në çdo rast, shtyrja e afatit nuk do të jetë më e shkurtër se periudha e vonësës së shkaktuar.*

- i. *Palët bien dakord se kohëzgjatja e Koncesionit do të shtyhet në rast të një ngjarje të konsideruar Forcë Madhore, kohëzgjatja e së cilës nuk kalon 120 ditë, për një periudhë kohore të barabartë me kohëzgjatjen e Forcës Madhore dhe për periudhën kohore që në mënyrë të arsyeshme konsiderohet e nevojshme për të ndrequr dëmet e shkaktuara.*

- ii. Në rast se Koncesionar ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë të Kontratës së Koncesionit, Koncesionar duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues me shkrim për vonesën, shkakun dhe periudhën e ndërprerjes së shërbimeve. Autoriteti Kontraktues duhet të vlerësojë objektivisht kërkesën dhe në rast se është dakord me vonesën, shtyrja e afatit do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të Kontratës.

Pretendimet e koncesionarit siç citohet në raport fillojnë me mos-markimin e naftës Bruto, për shkaqe jashtë kontrollit të tij. Si pasojë kontrata ngelet e pa përmbushur dhe se njoftimi nga shoqëria ka përmbushur kërkesën për të njoftuar AK për mos-markimin e naftës Bruto. Pretendime të tjera konsistojnë edhe në indeksimin e çmimit të markimit për shkak inflacioni, çmimi duhej të ishte në EURO ose USD si dhe shuma e investimeve të kryera në lidhje me markimin e naftës Bruto duhej të ishin kompensuar në kohëzgjatjen e kontratës.

Në lidhje sa më sipër koncesionari paraqiti tre propozime:

#### **Propozimi i parë**

1. Kohëzgjatja e kontratës për një afat 10 vjeçar, shoqëruar me masa shtesë për krijimin e kushteve për markim-monitorimin edhe te naftës bruto.
2. Koncesionari do të kryej markim-monitorimin e të gjitha produkteve duke përmirësuar teknologjinë dhe siguruar injektimin automatik të markuesit. Brenda 3 muajve nga nënshkrimi i amendimit të Kontratës, AK-së do t'i paraqitet plani i implementimit për teknologjinë e re. Pas miratimit të AK, ky i fundit siguron kushtet e nevojshme që koncesionari të instalojë pajisjet e injektimit automatik. Koncesionari përmbyll procesin e instalimit brenda 4 muajve nga krijimi i kushteve për instalim.
3. Koncesionari do të markojë më një marker me element të shtuar sigurie sipas kërkesave të AK. Markerit mund të ndryshohet në rast se vlerësohet e nevojshme nga konstatimet në treg, për të garantuar integritetin e procesit. Koncesionari garanton se marker do të jetë i pajisur me certifikime që vërtetojnë aftësinë e tij për të mos ndryshuar karakteristikat e karburanteve, për të mos shkaktuar dëme në motorin e mjeteve motorike, si dhe do të shoqërohet me raportin toksikologjik dhe MSDS. Gjithashtu, pajisjet dedektuese do të jenë të pajisura me certifikata CE dhe EMS dhe do të kalibrohen në mënyrë periodike.
4. Duke qenë se ka kaluar një dekadë nga nënshkrimi i kontratës, se ka pasur ndryshime të mëdha në tregun financiar, se lënda e parë dhe teknologjia sigurohen jashtë vendit dhe paguhen nga Koncesionari në EUR/USD, kërkohet që faturimi i tarifës së markimit të kryhet në monedhë EUR ose USD, në bazë të kursit të ditës të nënshkrimit të kontratës. Në alternativë, kërkohet të paktën indeksimi i çmimit të markimit më bazë vjetore, duke përllogaritur normën zyrtare të inflacionit.
5. Për të rikuperuar dëmin e pësuar, kërkohet që nëse të ardhurat e realizuara në vitet pasardhëse rriten mbi 15% në raport me të ardhurat e vitit 2022, shoqëria të përfitojë një bonus prej të paktën 1% të ardhurave shtesë.

#### **Propozimi i dytë**

1. Zgjatja e afatit të kontratës për një periudhë 20 vjeçare, duke përjashtuar naftën bruto.
2. Koncesioni do të kryej markim-monitorimin vetëm të produkteve të bardha dhe solar-mazutit, duke përmirësuar teknologjinë dhe siguruar injektimin automatik të

markuesit. Brenda 3 muajve nga nënshkrimi i amendimit të Kontratës, AK-së do t'i paraqitet plani i implementimit për teknologjinë e re. Pas miratimit të AK, ky i fundit siguron kushtet e nevojshme që koncesionari të instalojë pajisjet e injektimit automatik. Koncesionari përmbyll procesin e instalimit brenda 4 muajve nga krijimi i kushteve për instalim.

3. Koncesionari do të markojë më një marker me element të shtuar sigurie sipas kërkesave të AK. Markerit mund të ndryshohet në rast se vlerësohet e nevojshme nga konstatimet në treg, për të garantuar integritetin e procesit. Koncesionari garanton se marker do të jetë i pajisur me certifikime që vërtetojnë aftësinë e tij për të mos ndryshuar karakteristikat e karburanteve, për të mos shkaktuar dëme në motorin e mjeteve motorike dhe do të shoqërohet me raportin toksikologjik dhe MSDS. Gjithashtu, pajisjet dedektuese do të jenë të pajisura me certifikata CE dhe EMS dhe do të kalibrohen në mënyrë periodike.
4. Duke qenë se ka kaluar një dekadë nga nënshkrimi i kontratës, se ka pasur ndryshime të mëdha në tregun financiar, se lënda e parë dhe teknologjia sigurohen jashtë vendit dhe paguhet nga Koncesionari në EUR/USD, kërkohet që faturimi i tarifës së markimit të kryhet në monedhë EUR ose USD, në bazë të kursit të ditës të nënshkrimit të kontratës. Në alternativë, kërkohet të paktën indeksimi i çmimit të markimit më bazë vjetore, duke përllogaritur normën zyrtare të inflacionit.
5. Për të rikuperuar dëmin e pësuar, kërkohet që nëse të ardhurat e realizuara në vitet pasardhëse rriten mbi 15% në raport me të ardhurat e vitit 2022, shoqëria të përfitojë një bonus prej të paktën 1% të të ardhurave shtesë.
6. Kontrata duhet të parashikojë një depozitë për mundësinë e rishikimit të saj në rast se AK do të sigurojë kushtet për markimin e naftës bruto.

### **Propozimi i tretë**

1. Zgjatja e kontratës 20 vjeçare, duke përfshirë naftën bruto si dhe produktet e zeza (solar-mazut).
2. Koncesioni do të kryejë markim-monitorimin vetëm të produkteve të bardha, duke përmirësuar teknologjinë dhe siguruar injektimin automatik të markuesit. Brenda 3 muajve nga nënshkrimi i amendimit të Kontratës, AK-së do t'i paraqitet plani i implementimit për teknologjinë e re. Pas miratimit të AK, ky i fundit siguron kushtet e nevojshme që koncesionari të instalojë pajisjet e injektimit automatik. Koncesionari përmbyll procesin e instalimit brenda 4 muajve nga krijimi i kushteve për instalim.
3. Koncesionari do të markojë më një marker me element të shtuar sigurie sipas kërkesave të AK. Markerit mund të ndryshohet në rast se vlerësohet e nevojshme nga konstatimet në treg, për të garantuar integritetin e procesit. Koncesionari garanton se marker do të jetë i pajisur me certifikime që vërtetojnë aftësinë e tij për të mos ndryshuar karakteristikat e karburanteve, për të mos shkaktuar dëme në motorin e mjeteve motorike, si dhe do të shoqërohet me raportin toksikologjik dhe MSDS. Gjithashtu, pajisjet dedektuese do të jenë të pajisura me certifikata CE dhe EMS dhe do të kalibrohen në mënyrë periodike.
4. Duke qenë se ka kaluar një dekadë nga nënshkrimi i kontratës, se ka pasur ndryshime të mëdha në tregun financiar, se lënda e parë dhe teknologjia sigurohen jashtë vendit dhe paguhet nga Koncesionari në EUR/USD, kërkohet që faturimi i tarifës së markimit të kryhet në monedhë EUR ose USD, në bazë të kursit të ditës të nënshkrimit të kontratës. Në

alternativë, kërkohet të paktën indeksimi i çmimit të markimit më bazë vjetore, duke përlllogaritur normën zyrtare të inflacionit.

5. Për të rikuperuar dëmin e pësuar, kërkohet që nëse të ardhurat e realizuara në vitet pasardhëse rriten mbi 15% në raport me të ardhurat e vitit 2022, shoqëria të përfitojë një bonus prej të paktën 1% të të ardhurave shtesë.
6. Kontrata duhet të parashikojë një depozitë për mundësinë e rishikimit të saj në rast se AK do të sigurojë kushtet për markimin e naftës bruto.

Me anë të Memos nr. 11975/1 datë 12.07.2023,propozimet sipas grupit të punës konsistojnë si më poshtë:

### **Propozimi i parë**

1. Zgjatje e afatit të kontratës prej 15 vitesh, me kusht markimin vetëm të produkteve të bardha, duke përjashtuar markimin e naftës bruto dhe produkteve të zeza, solar e mazut;
2. Koncesionari të kryejë markim-monitorimin e të gjitha produkteve (vetëm produktet e bardha) duke përmirësuar teknologjinë dhe siguruar injektimin automatik të markuesit. Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e amendimit të Kontratës, AK-së t'i paraqitet plani i implementimit për skemën dhe teknologjinë e re. Pas miratimit të AK, ky i fundit siguron kushtet e nevojshme që koncesionari të instalojë pajisjet e injektimit automatik (ndryshimin e VKM nr.498, datë 30.5.2013 "*Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës*") për t'iu përshtatur dhe mundësuar injektimin automatik pranë subjekteve të detyruara). Koncesionari të përfundojë procesin e instalimit brenda 4 muajve nga krijimi i kushteve për instalim me kusht që markimi për produktet e bardha të mos ndërpritet për asnjë çast.
3. Koncesionari të markojë me një marker që i përshtatet skemës së re por që ka një standard të barabartë ose më të lartë se markeri aktual. Marker i ri të ketë elementë të shtuar sigurie në krahasim me markerin që përdoret aktualisht. Marker i ri do të ndryshohet minimalisht 2 (dy) herë në vit, për të garantuar integritetin e procesit. Marker i ri në çdo rast të jetë i pajisur me certifikime që vërtetojnë aftësinë e tij për të mos ndryshuar karakteristikat e karburanteve, për të mos shkaktuar dëme në motorët e mjeteve motorike, si dhe të shoqërohet me raportin toksikologjik dhe MSDS. Gjithashtu, pajisjet dedektuese të jenë të pajisura me certifikata CE dhe EMS dhe të kalibrohen në mënyrë periodike.
4. Amendimi të parashikojë edhe mundësinë e fillimit të markimit të naftës bruto dhe/ose produkteve të zeza, solar e mazut me kërkesë paraprake të AK-së dhe miratimin e koncesionarit, me kusht që në rast të tillë të shkurtohet kohëzgjatja e kontratës në proporcion me pjesën e përmbushur të kontratës deri në atë moment dhe kostot shtesë që mund të nevojitet të kryhen nga shoqëria koncesionare për markimin e produkteve shtesë, pasi në të kundërt përfshirja e naftës bruto për të njëjtën periudhë kohore do të përbënte tejkalim të hapësirës për ndryshim të parashikuar nga kontrata.

### **Propozimi i dytë**

1. Zgjatje e afatit të kontratës prej 14 vitesh e 9 muajsh, me kusht markimin e produkteve të bardha dhe solar-mazut, pa përfshirë markimin e naftës bruto.
2. Koncesionari të kryejë markim-monitorimin e të gjitha produkteve (vetëm produktet e

bardha dhe solar-mazut) duke përmirësuar teknologjinë dhe siguruar injektimin automatik të markuesit. Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e amendimit të kontratës, AK-së t i paraqitet plani i implementimit për skemën dhe teknologjinë e re. Pas miratimit të AK, ky i fundit siguron kushtet e nevojshme që Koncesionari të instalojë pajisjet e injektimit automatik (ndryshimin e VKM nr.498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës” për t iu përshtatur dhe mundësuar injektimin automatik pranë subjekteve të detyruara). Koncesionari të përfundojë procesin e instalimit brenda 4 muajve nga krijimi i kushteve për instalim me kusht që markimi për produktet e bardha e ato të zeza të mos ndërpritet për asnjë çast.

3. Koncesionari të markojë me një marker që i përshtatet skemës së re por që ka një standard të barabartë ose më të lartë se markeri aktual. Marker i ri të ketë elementë të shtuar sigurie në krahasim me markerin që përdoret aktualisht. Marker i ri do të ndryshohet të paktën dy herë në vit, për të garantuar integritetin e procesit. Marker i ri në çdo rast të jetë i pajisur me certifikime që vërtetojnë aftësinë e tij për të mos ndryshuar karakteristikat e karburanteve, për të mos shkaktuar dëme në motorët e mjeteve motorike, si dhe të shoqërohet me raportin toksikologjik dhe MSDS. Gjithashtu, pajisjet dedektuese të jenë të pajisura me certifikata CE dhe EMS dhe të kalibrohen në mënyrë periodike.
4. Amendimi të parashikojë edhe mundësinë e fillimit të markimit të naftës bruto me kërkesë paraprake të AK dhe miratimin e koncesionarit, me kusht që në rast të tillë të shkurtohet kohëzgjatja e kontratës në proporcion me pjesën e përmbushur të kontratës deri në atë moment dhe kostot shtesë që mund të nevojitet të kryhen nga shoqëria koncesionare për markimin e produkteve shtesë, pasi në të kundërt përfshirja e naftës bruto për të njëjtën periudhë kohore do të përbënte tejkalim të hapësirës për ndryshim të parashikuar nga kontrata.

### **Propozimi i tretë**

1. Zgjatje e afatit të kontratës prej 6 vitesh, me kusht markimin e të gjithë produkteve të parashikuara aktualisht nga Kontrata;
2. Koncesionari të kryejë markim-monitorimin e të gjitha produkteve (naftë bruto, produktet e bardha, si dhe solar-mazut) duke përmirësuar teknologjinë dhe siguruar injektimin automatik të markuesit. Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e amendimit të Kontratës, AK-së t'i paraqitet plani i implementimit për skemën dhe teknologjinë e re. Pas miratimit të AK, ky i fundit siguron kushtet e nevojshme që Koncesionari të instalojë pajisjet e injektimit automatik (ndryshimin e VKM nr.498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës” për t’iu përshtatur dhe mundësuar injektimin automatik pranë subjekteve të detyruara). Koncesionari të përfundojë procesin e instalimit brenda 4 muajve nga krijimi i kushteve për instalim me kusht që markimi të mos ndërpritet për asnjë çast.
3. Koncesionari të markojë me një marker që i përshtatet skemës së re por që ka një standard të barabartë ose më të lartë se markeri aktual. Marker i ri të ketë elementë të shtuar sigurie në krahasim me markerin që përdoret aktualisht. Marker i ri do të ndryshohet të paktën dy herë në vit, për të garantuar integritetin e procesit. Marker i ri në çdo rast të jetë i pajisur me certifikime që vërtetojnë aftësinë e tij për të mos ndryshuar karakteristikat e karburanteve, për të mos shkaktuar dëme në motorët e mjeteve motorike, si dhe të shoqërohet me raportin toksikologjik dhe MSDS. Gjithashtu, pajisjet dedektuese të jenë të pajisura me certifikata



Me anë të Memos nr. 01.08.2023, Grupi i punës i ngritur me urdhërin nr. 147 datë 29.06.2023 ndryshon mendim duke bërë një propozim të ri duke sugjeruar zgjatjen e kontratës me afat 1 (një) vit për ti dhënë kohën e nevojshme AK që të ndjekë një nga tre mundësitë:

1. Për sigurimin e mëtejshëm të markim-monitorimit duke ri negociuar me koncesionarin për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve duke vlerësuar kushtin që nuk heq dorë nga pretendimet
2. Nisjen e procesit të dorëzimit ose
3. kryerjen e një procedure të re koncesionare

Për sa më sipër u miratua me VKM nr. 489 datë 09.08.2023 “Për miratimin e kontratës shtesë për ndryshimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe bashkimit të përkohshëm të “G. F. I.“ S.A dhe “P. C. P“ A. G miratuar me VKM nr. 200, dt. 13.03.2013” sipas aneksit I që i bashkëlidhet vendimit, konkretisht ky aneks konsiston në ndryshimin e nenit 4 pika 4.1 e kontratës, nenit 19 pika 1, si vijon:

*4.1 Kohëzgjatja e koncesionit është 11 (njëmbëdhjetë vjet) duke filluar nga data efektive.*

*19.1 Kontrata koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 11 (njëmbëdhjetë) vjeçar të përcaktuar në nenin 4.1 të kësaj kontrate.*

Parashikimet e tjera të kontratës mbeten të pandryshuara.

***Për sa më sipër, nga grupi i auditimit u konstatua:***

- Problematikat e këtij koncesioni nisin që në propozimin e projekt-idesë nga grupi i identifikimit të propozimit për markimin e monitorimin e naftës bruto si dhe solar/mazut. Nuk është marrë në konsideratë fakti se nafta bruto është një produkt që nuk zotërohet nga shteti shqiptar për rrjedhojë nuk lindin pretendime mbi përdorimin e saj. Nafta bruto nuk përfshihet si objekt i akcizës. Problematikë e cila vijon edhe me propozimet për amendimin e kontratës dhe në miratimin e saj.
- Gjithashtu nga ana e Ministrisë së Financave, GP, nuk i ka kërkuar mendim/informacion shoqërive naftë nxjerrëse (si: B. P. A LTD) dhe Shoqërisë së Hidrokarbureve.
- Në asnjë moment nuk u mor në konsideratë një vlerësim teknik mbi zbatimin e detyrimeve respektive të kontratës koncesionare. Në amendimin e kontratës u morën në konsideratë vetëm pretendimet e G. F. I. në lidhje në mosplotësimin e kushteve të kontratës dhe jo anasjelltas.
- Nuk janë ndërmarrë veprime konkrete për të eliminuar pengesat e hasura për zbatim të plotë të kontratës si shkak -pasojë e veprimeve /mosveprimeve që në miratimin e kontratës dhe amendimit të saj.
- Autoritetet përgjegjëse nuk kanë një analizë mbi efektivitetin apo përfitimet e shtetit shqiptar nga kjo kontratë që me nënshkrimin e saj.

*Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganës, , protokolluar në institucion me nr. 645/14, datë 20.05.2024.*

**Pretendimi i subjektit (i përmbledhur):** Në pikat dhe tekstin përkatës të përfshira në kuadratin më sipër, del se Grupi i Audituesve ka konstatuar mangësi në mungesa të "formateve të raportimit" dhe "treguesve të raportimit", në procesin e raportimit për ecurinë e këtij koncesioni. Këto mangësi rezultojnë tek të dy aktet;

Kontrata Koncesionare" dhe VKM nr. 200 datë 13.03.2013

Këto mangësi kanë rrjedhur që në hapat e parë të draftimit të termave të kësaj kontrate dhe mosparashikimi elementëve në kontratë, bën që procesi i monitorimit dhe vlerësimit të mos vijojë i standartizuar.

Në pikat dhe tekstin përkatës të përfshira në kuadratin më sipër, shprehet se;

"Drejtoria e Përgjithshme të Doganave (DPD), në cilësinë e përfaqësuesit ekzekutiv të autoritetit të kontratës,

theksojmë se ky cilësim apo emërtim nuk është i mbështetur. Në Kontratën e Koncesionit dhe as në VKM-të që rregullojnë aktivitetin e Kontratës Koncesionare të Markimit të Karburanteve nuk ekziston ky përshkrim, cilësim, përcaktim, emërtim apo funksion i përcaktuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Gjithashtu theksojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në VKM 200 datë 13.03.2013 dhe në vetë Kontratën e Koncesionit për "Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve", nuk përmendet apo ngarkohen me attribute, detyrime ligjore apo kontraktuale për ngritjen e grupit të punës për procedurën monitorimit dhe vlerësimin e kontratës. Theksojmë se, në bazë të kontratës koncesionare duhet të ishte Autoriteti Kontraktues që të përcaktonte detyra konkrete apo grupe pune specifike në lidhje me këto procese.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Grupi i auditimit mori në shqyrtim observacionet e dërguara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të doganave, si dhe u realizuar dhe Takimi i Mirëkuptimit ku u diskutuan çështjet e prekura në observacione mbi të cilat përfaqësuesit e DPD morën sqarimet përkatëse dhe për disa nga çështjet e diskutuara dhe të rëna dakord u kryen ndryshimet përkatëse përgjatë materialit.

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se nuk kishte inventar të dokumenteve të vendosura në dispozicion grupit të auditimit, korrespondencat nuk ishin të plotësuara si një praktikë e vetme, si dhe shumica e dokumenteve në dosje ishin fotokopje ose në formate të papërfunduara në versionin final, veprime në kundërshtim me Normat Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.  
(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3.1) faqe 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**1.1.Rekomandimi:** Nga ana e Titullarit të Ministrisë së Financave të merren masa për hartimin e një urdhri ose udhëzimi për hartimin e gjurmës së auditimit për koncesionet dhe në këtë kuadër, disiplinimin në mënyrë përfundimtare nga njësi përgjegjëse, të mënyrës së administrimit, protokollimit, ruajtjes, digjitalizimit dhe arkivimit të dokumentacionit të kontratave koncesionare dhe atyre PPP, duke përfshirë të gjithë fazat e tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Propozimi i pakërkuar për dhënien me koncesion të këtij shërbimi nuk rezultoi të jetë mbështetur në prioritetet strategjike të qeverisë për periudhën në fjalë deri në momentin e propozimit për dhënien me koncesion të këtij shërbimi. Gjithashtu nuk rezultoi të jetë kryer një studim me analiza të nevojshme kosto-përfitim nga strukturat përkatëse, për të parashikuar kostot respektive të këtij shërbimi, për të identifikuar nëse ky projekt ka qenë i përballueshëm për buxhetin e shtetit dhe për të vlerësuar mbrojtjen e interesit të konsumatorëve lidhur me sasinë, cilësinë dhe nivelin e tarifës të aplikuar për këtë shërbim të markimit të karburanteve. Sa më sipër në kundërshtim me Ligjin nr. 9663, dt.18.12.2006, “Për koncesionet” i ndryshuar neni 4, “Fusha e zbatimit të koncesionit” dhe neni 9, pika 2.  
(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1.1) faqe 13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**2.1.Rekomandimi:** Ministria e Financave të marrë masat që për koncesionet e mundshme në të ardhmen, të kryejë analiza të detajuara, të cilat duhet të bazohen në respektimin e parimeve të vlerës për para, në përputhshmëri me objektivat strategjike kombëtare dhe sektorial, në rentabilitetin teknik dhe tregtar të koncesionit, etj., me qëllim mbrojtjen e interesave shtetërore dhe të konsumatorëve lidhur me sasinë, cilësinë dhe nivelin e shërbimit që do të përfitohet.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Gjatë analizimit të zhvillimit të procedurës mbi pranimin e propozimit të pakërkuar të dhënies me koncesion të markimit dhe monitorimit të karburanteve, rezultoi se është tejkaluar afati ligjor 90 ditor i parashikuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9663, datë 08.12.2006, i ndryshuar “Për koncesionet”, neni 23, pika 2/a.  
(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1.1) faqe 13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**3.1.Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave të marrin masa për zbatimin e procedurave për vlerësimin dhe miratimin e projekteve koncesionare me dokumentacion të plotësuar, si dhe të respektojnë afatet ligjore mbi shprehjen e interesit mbi propozimet e pakërkura në lidhje me miratimin e zhvillimit të koncesioneve.

**Në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Gjatë analizimit të zhvillimit të procedurës së dhënies me koncesion të procesit të markimit të karburanteve, rezultoi se nuk janë përfshirë dhe konsideruar grupet

e interesit si në rastin e **Shoqatës së Shoqërive të Hidrokarbureve**, (të cilët me anë të shkresës nr. 19279 Prot., datë 10.12.2012, kanë kërkuar përfshirjen si palë e interesuar për shqyrtimin e kontratës së koncesionit në marrjen e mendimeve dhe konsultimet, duke listuar dhe disa shqetësime në lidhje me qëllimin e kontratës së koncesionit). Gjithashtu dhe nga ana e Ministrisë së Financave, nuk i është kërkuar mendim/informacion shoqërive (si: **B. P. A. LTD**), si palë kryesore interesi, duke sjellë problematika në procesin e zbatimit të koncesionit. Sa më sipër në kundërshtim me neni 9, Ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.  
(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1.1) faqe 13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**4.1.Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Avokaturës së Shtetit, ATRAKO, Autoritetit të Konkurrencës, apo edhe institucione të tjera të angazhuara në dhënien e mendimeve gjatë fazës së hartimit të kontratave koncesionare, përpara miratimit të projekt akteve përkatëse të kësaj fushe, të marrin masat për njoftimin, konsultimin publik dhe shqyrtimin e problematikave të palëve të interesit, me qëllim harmonizimi dhe garantimin e barazisë në të drejtat dhe detyrimet mes palëve.

**Në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Raporti përmbledhës i hartuar dhe i miratuar nga Grupi i Punës gjatë fazës së zhvillimit të procedurës së koncesionit, nuk përmban analiza të kryera për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe të monitorimit. Vlerësimi i kryer është sipërfaqësor, përmbledhës, paraqet vetëm konkluzione dhe nuk shoqërohet me studim të plotë në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga shoqëria G. F. I.. Sa më sipër në kundërshtim me Ligji nr. 9663, datë 08.12.2006, i ndryshuar “Për koncesionet”, kreu II, neni 9 pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1.1) faqe 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**5.1.Rekomandimi:** Ministria e Financave, gjatë hartimit të Raportit Përmbledhës në lidhje me propozimet e pakërkuara për zhvillimin e koncesioneve të bazohet në urdhrin e titullarit mbi kompetencat e tyre si dhe të hartojë analiza të detajuara konkretisht si: analiza e rentabilitetit, të përshtatshmërisë financiare dhe vlerës për para, të përputhshmërisë së projektit të koncesionit me objektivat strategjike kombëtare dhe sektorial, të rentabilitetit teknik dhe përputhshmërisë financiare si dhe aftësisë së projektit për të tërhequr koncesionarë të mundshëm dhe financime private.

**Në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Gjatë fazës së vlerësim të propozimit të pakërkuar, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk rezulton të ketë një vlerësim nga Autoriteti i Konkurrencës në kuadër të bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe të detyrimeve të organeve të administratës qendrore e vendore. Sa më sipër në kundërshtim me pikën 1, Neni 69, Ligji nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1.1) faqe 13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**6.1.Rekomandimi:** Ministria e Financave, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe të detyrimeve të organeve të administratës qendrore e vendore, gjatë zhvillimit të procedurave koncesionare të marrë në konsideratë vlerësimin nga ana e Autoritetit të Konkurrencës sipas legjislacionit në fuqi.

**Në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i fazës së zhvillimit të procedurës së koncesionit, rezulton se nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Procedurës nuk janë zbatuar detyrimet në lidhje me dokumentacionin e procesit të vlerësimit si dhe zbatimin e afatit ligjor të publikimit sipas kërkesave të VKM nr. 27, dt.19.01.2007, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” i ndryshuar, Kreu IX, pika 2 germa b.

Gjithashtu mungon dokumentacioni thelbësor i procedurës si: Procesverbalet që vërtetojnë analizën që ka bërë NJHD dhe KVO; Subjektet pjesëmarrëse në procedurë; Procedura e ndjekur (me një fazë); Mënyra e përzgjedhjes së fituesit; Regjistrin e koncesionit për projektin konkret që është përgjegjësi e Njësisë së hartimit të dokumentacionit/KVO.

Në përbërjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave janë emëruar anëtarë të cilët kanë marrë pjesë në Komisionin e Hartimit të Dokumenteve të procedurës konkurruese, konkretisht znj. A. D., në kundërshtim me VKM nr. 27. Dt.19.01.2007, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” i ndryshuar, Kreu VIII, pika 1.

Në raportin përmbledhës mbi vlerësimin e ofertave të projektit “Për dhënie me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë” nr. 14859 Prot., datë 18.09.2012 citohet shqyrtimi i dokumentacionin ligjor dhe kualifikues, por nuk listohet dokumentacioni i kërkuar konform kërkesave ligjore konkretisht VKM nr. 27. Dt.19.01.2007, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” i ndryshuar, Kreu IX, pika 2 germa b.

-Gjithashtu siç citohet në raportin përmbledhës mungojnë testet fizike të kërkuara. Nga njoftimi i fituesit të publikuar deri në momentin e nënshkrimit të kontratës, ka kaluar një periudhë 5 mujore.

- Grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion procedura e plotë e ndjekur për negocimin e kontratës që nga ftesa për ofertë deri në lidhjen e kontratës, përfshirë dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave për caktimin e afateve të negocimit të kontratës. Sa më sipër në kundërshtim me VKM nr.27 datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” i ndryshuar kreu IX pika 3 germa c, Kreu VIII, pika 1, i ndryshuar, Kreu IX, pika 2 germa b, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.1) faqe 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1.Rekomandimi:** Ministria e Financave të analizojë problematikat mbi zhvillimin e procedurës së koncesionit të markimit dhe monitorimit të karburanteve duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, si dhe në të ardhmen të marrin masa për vijimin e procedurave për publikimin, vlerësimin dhe miratimin e projekteve koncesionare me dokumentacion të plotë

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të koncesionit, ka rezultuar se nuk janë zgjidhur apo marrë në konsideratë problematikat e lidhura me markimin e naftës bruto si dhe monitorimin e produktit solar/mazut, çështje këto të ngritur që në fillim të propozimit të pakërkuar.

-Kontrata nuk parashikon formate tip raportimi se çfarë konkretisht duhet të monitorohet dhe si duhet të kryhet ky monitorim nga menaxheri i projektit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganava e më pas Ministria e Financave, pra mungojnë treguesit e matshëm të efektivitetit/performancës së këtij koncesioni.

-Kontrata nuk parashikon se si do të procedohet me transferimin e pronësisë intelektuale dhe të teknologjisë sekrete (Solucioni i markimit të përdorur nga koncesionari), duke evidentuar kështu një risk të shtuar nëse në përfundimin e kontratës të gjitha asetet, sistemet hardware dhe software do të rezultojnë jofunksionale duke sjellë pamundësinë e vijimit të ofrimit të shërbimit me largimin e Koncesionarit.

-Kontrata nuk ka parashikuar masa për parandalimin e lënies si kolateral të aseteve të kësaj kontrate për qëllimet e angazhimeve financiare të shoqërisë Koncesionare, duke përbërë kështu një risk të shtuar mbi efektet negative që mund t'i shkaktohen buxhetit të shtetit dhe funksionimit normal të këtij koncesioni.

-Kontrata nuk ka parashikuar penalitete për koncesionarin në rastet kur shërbimet e markimit dhe të monitorimit të ofruara nuk janë në përputhje me ofertën teknike, me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DSK si dhe përcaktimet e Shtojcës nr. 4 të kësaj kontrate.

Sa më sipër në kundërshtim me Ligjin nr. 9663, datë 08.12.2006, i ndryshuar “Për koncesionet” pika 2/a, neni 23 si dhe pika 2/c, neni 23;

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.2) faqe 28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1.Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave të marrin masat për analizimin e situatës duke identifikuar përgjegjësitë përkatëse në parregullsitë e evidentuara në kontratën e nënshkruar, dhe të ndërmarrë masa të menjëhershme ligjore për eliminimin e tyre, si dhe shqyrtimin e mundësive reale për hartimin e dokumentacioneve sqaruese/plotësuese sipas rastit, me efekte deri në përfundim të afatit të projektit.

Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Avokaturës së Shtetit, ATRAKO, Autoritetit të Konkurrencës apo edhe institucione të tjera të angazhuara në dhënien e mendimeve gjatë fazës së hartimit të kontratave koncesionare, përpara miratimit të projekt ligjeve përkatëse, të marrin masat që garantojnë mbrojtjen e interesave të shtetit, nëpërmjet korrigjimit të këtyre parregullsive në mënyrën e formulimit të kontratave që mund të hartohen e miratohen në të ardhmen.

## **Menjëherë dhe në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Ministria e Financave nuk ka ngritur një grup pune (të përhershëm për afatin e kontratës koncesionare të miratuar me VKM nr. 200 datë 13.03.2013) për monitorimin dhe zbatimin e kësaj kontrate me specialistë të fushës, ku të përfshiheshin së paku një ekonomist, një jurist dhe një inxhinier i fushës, me ndarje të qartë të detyrave, për mbikëqyrjen e përshtatshme të zbatimit të kontratës, në kundërshtim me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.1 dhe pika 3.2.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3.1) faqe 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1.Rekomandimi:** Ministria e Financave të marrë masa për:

(i) ngritjen e një grupi pune (të përhershëm për afatin e kontratës) për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate me specialistë të fushës, monitorimin periodik të përmbushjes së objektivave dhe indikatorëve.

(ii) hartimin e procedurave të detajuara të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së këtij Koncesioni, duke përfshirë mënyrën si do të kryhet monitorimi i plotë periodik e gjithëvjetor, detyrat dhe përgjegjësitë specifike të personave përgjegjës, etj..

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e autoritetit të përcaktuar në Vendimin nr. 498, datë 30.05.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, nuk ka hartuar dhe miratuar asnjë plan veprimi apo plan trajnimi, për të përcaktuar periodicitetin dhe shtrirjen e këtyre trajnimeve, aftësimin e punonjësve të doganës në procesin e markimit dhe monitorimit të karburantit, në kundërshtim me Kontratën koncesionare, Pika 7.2.2, Neni XI dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.1 “*Mjedisi i Kontrollit të Brendshëm*”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3.1) faqe 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1.Rekomandimi:** Nga ana e Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të merren masa për hartimin dhe miratimin e planeve periodike mujore dhe vjetore për trajnimin e punonjësve të administratës shtetërore të përfshirë në procesin e monitorimit të kontratave koncesionare.

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Ministria e Financave në cilësinë e autoritetit kontraktor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e autoritetit të përcaktuar në Vendimin e KM nr. 498, datë 30.05.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, nuk kanë hartuar dhe miratuar regjistër ose strategji rrishtu mbi këtë proces, ku në vijim të rrishteve të identifikuara, të arsyetohet përgjigja ndaj rrishtit dhe të merren masat përkatëse, në kundërshtim me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.2 “Menaxhimi i Rrishtit”; pika 2.2.9 e Kapitullit II “Rolet dhe aktorët në sistemin e MFK-së”, germa c.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3.1) faqe 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1.Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me qëllim hartimin e Regjistrit të Rrishtit për aktivitete e procese që lidhen me shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, me qëllim identifikimin, vlerësimin dhe minimizimin e rrishteve përkatëse.

**Menjëherë**

**12. Gjetje nga auditimi:** Ministria e Financave në cilësinë e autoritetit kontraktor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e autoritetit të përcaktuar në Vendimin e KM nr. 498, datë 30.05.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, nuk ka hartuar dhe miratuar hartën e procesit të punës, gjurmën e auditimit dhe planin e kontrollit të brendshëm, sipas formatit të kërkuar nga Manuali i MFK, për procesin e kryerjes së markimit dhe monitorimit; njësitë përgjegjëse për procesin sipas hallkave përkatëse, etj.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3.1) faqe 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1.Rekomandimi:** Nga ana e Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të merren masa për hartimin dhe miratimin e hartës së procesit të punës, gjurmën e auditimit dhe planin e kontrollit të brendshëm sa i përket procesit të kryerjes së markimit dhe monitorimit, njësitë përgjegjëse për procesin sipas hallkave përkatëse, etj., në një formë të tillë që t’i shërbejë monitorimit të kontratës së koncesionit dhe garantimin e informacionit të plotë lidhur me gjetjet që kanë të bëjnë me këtë proces pune.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, për vitin 2023 deri në datën e auditimit në terren rezultoi i paplotësuar pozicioni i Menaxherit të Projektit, në kundërshtim me nenin 22 të kontratës, pika 4 “Përfaqësimi i Palëve”, e cila parashikon emërimin e një Menaxheri Projekti i cili do të jetë përgjegjës, në emër të Palës, të marrë komunikimet mbi të gjitha çështjet e lidhura me ekzekutimin e Kontratës së Koncesionit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3.1) faqe 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**13.1.Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të marrin masat që të mos krijohen vakanca në lidhje me pozicionin e Menaxherit të Projektit, duke garantuar vijueshmërinë mbi zbatimin dhe përmbushjen e kushteve të kontratës.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se dokumentacioni i administruar nga Grupi i Auditimit në lidhje me raportimin dhe monitorimin e zbatimit të Kontratës Koncesionare, nga ana e MFE dhe DPD, është i paplotë dhe nuk jep informacion për kontrollet e kryera përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Gjithashtu konstatohet se të njëjtat problematika në ofrimin e shërbimeve përsëriten vit pas viti dhe nuk rezultoi të jenë marrë masa për zgjidhjen e tyre apo të jenë vendosur sanksione.

Nga MFE dhe DPD nuk janë ndërmarrë hapa për të orientuar monitorimin e kontratës koncesionare në kuadër të vlerësimit të performancës së saj dhe vlerës së shtuar të ofrimit të shërbimit të monitorimit dhe markimit dhe se nuk mund të mbetet vetëm në kuadër të verifikimit të ofrimit të shërbimit.

Sa më sipër në kundërshtim me VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve” të lidhur midis MFE dhe bashkimit të përkohshëm të “G. F. I.” S.A. dhe “P. C. P” A.G, i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3.1) faqe 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**14.1.Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masat për ngritjen e një grupi pune për kryerjen e një analize të plotë kosto përfitim me qëllim konstatimin e problematikave, marrjen e masave për zgjidhjen e tyre ose vendosjen e sanksioneve; si dhe vlerësimin performancës së shoqërisë koncesionare dhe vlerës së shtuar të ofrimit të shërbimit të monitorimit dhe markimit.

#### **Menjëherë**

**15. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në përmbushje të rolit dhe kompetencave ligjore, ka ushtruar kontrolle në përmbushje të pikës 5.8 të Kontratës Koncesionare në vitet 2016, 2017 dhe 2021. Me shkresën nr. 18628/2 prot., datë 03.10.2016, dhe shkresën nr. 7878/1 prot., datë 10.05.2021, nga ana e DPD janë përcjellë në Ministrinë e Financave raportimet e kontrolleve të ushtruar në koncesionarin “G. F. I. A.” shpk mbi monitorimin dhe zbatimin e Kontratës Koncesionare, ndër të tjera edhe mbi vlerësimin e investimit.

Konkluzionet e grupeve të punës mbi vlerësimin e investimit nuk janë bazuar në situacione punimesh, fatura dhe dokumentacion tjetër me natyrë vërtetuese, por vetëm në pasqyrat financiare dhe argumentet e shoqërisë koncesionare.

Pavarësisht korrespondencave vijuese ndërmjet palëve të përfshira në proces, Ministrisë së Financave, autoriteteve doganore, shoqërisë koncesionare, autoriteteve shtetërore, jo vetëm që



nuk kanë kryer një vlerësim të thelluar të investimit, duke u bazuar në dokumentacion vërtetues e justifikues për të saktësuar vlerën e investimit të kryer, por nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim të mirëfilltë për analizimin e shkaqeve që kanë sjellë moskryerjen e këtij vlerësimi, për të nxjerrë përgjegjësitë dhe për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e situatës.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, shoqëria nuk rezulton të ketë përmbushur plotësisht këto detyrime pasi nga analiza e DPD, investimi i kryer nga shoqëria koncesionare rezulton në vlerë më të ulët se ai i parashikuar në propozim si dhe nga ana e strukturave të ngarkuara me monitorimin e kësaj kontrate nuk rezulton të jenë ndërmarrë hapa konkrete mbi evidentimin e situatës dhe marrjen e masave ndaj shoqërisë koncesionare. Sa më sipër në kundërshtim me VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve” të lidhur midis MFE dhe bashkimit të përkohshëm të “G. F. I.” S.A dhe “P. C. P” A. G, i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3.2) faqe 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**15.1.Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masat për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga MFE dhe DPD, me qëllim (i) kryerjen e një vlerësimi të plotë të investimit, duke evidentuar devijimet e mundshme nga propozimi fillestar, (ii) evidentimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në përmbushjen e detyrimeve nga ana e shoqërisë koncesionare, si dhe (iii) përllogaritjen e impaktit financiar të këtyre mos përmbushjeve nga ana e shoqërisë koncesionare, në raport me propozimin.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë Koncesionare, për periudhën 2013 – 2022, rezultoi se nuk është ndjekur struktura e investimeve e paraqitur në shtojcën nr. 5 të Kontratës Koncesionare “Plani i Investimeve”, duke krijuar problematika në verifikimin e investimeve për zërat specifik. Gjithashtu referuar të dhënave të Pasqyrave Financiare rezultoi se realizimi i investimeve është në masën 68%.

Sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë Koncesionare, për periudhën 2013 – 2022, rezultoi se kanë ndodhur pakësime në zërat e llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale, konkretisht:

- Llogaria 212 “Ndërtesa” është pakësuar në vlerën 77,971,890 lekë, në vitin 2019.
- Llogaria 213 “Makineri dhe Pajisje” është pakësuar në vlerën 1,645,346 lekë, në vitin 2018.
- Llogaria 2182 “Kompjuterat dhe pajisje informatike” është pakësuar në vlerën 879,705 lekë, në vitin 2018.

Në shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare nuk ka asnjë informacion mbi arsyet përse kanë ndodhur këto pakësime, të cilat ndikojnë në mënyrë direkte në përmbushjen e detyrimit të kryerjes së investimeve sipas shtojcës nr. 5 të kontratës.

Në llogarinë nr. 212 “Ndërtime”, nga viti 2013 deri në vitin 2018 është përfshirë edhe zëri “Përmirësime në qiramarrje” në vlerë totale 19,073,079 lekë. Vlerësojmë se sipas klasifikimit ekonomik të llogarive kontabël zëri “përmirësime në qiramarrje” klasifikohet si shpenzime qiraje dhe jo si investim, duke krijuar rritje artificiale të vlerave të investimit.

Në klasën e Aktiveve Afatgjata Jo materiale janë përfshirë shpenzime nisje në vlerën 31,227,670 lekë, në vitin 2018, por nuk ka asnjë shpjegim apo analizë analitike se kujt i referohet kjo vlerë dhe për cilën pjesë të planit të investimit është kryer.

Nga auditimi mbi kryerjen e investimeve nga shoqëria koncesionare në zbatim të pikës 5.8 të Kontratës koncesionare e cila përcakton, ndër të tjera, detyrimin e shoqërisë për të kryer investimin sipas afatit të parashikuar në përputhje me Shtojcën 5 të Kontratës, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion që vërteton përmbushjen e detyrimit të kryerjes së investimit nga shoqëria koncesionare sipas afateve të përcaktuara në Aneksin 1 të Planit të Investimit. Sa më sipër në kundërshtim me VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 *“Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur midis MFE dhe bashkimit të përkohshëm të “G. F. I.” S.A dhe “P. C. P” A. G, i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.*

Gjatë zhvillimit të procesit të auditimit, grupi i auditimit zhvilloi një verifikim në terren mbi zbatimin e kontratës.

Nga ana e grupit të auditimit u kërkua dokumentacioni në lidhje me trajnimet e vazhdueshme ku u evidentua se nuk është dokumentuar kryerja e trajnimeve të vazhdueshme ndërmjet punonjësve të subjektit G. F. I. sh.p.k. si dhe punonjësve të doganës përgjegjës mbi monitorimin dhe kontrollin mbi zhvillimin e koncesionit.

Procesi i markimit është tërësisht manual, hapat që ndiqen nga operatorët e G. F. I.-së për të realizuar procesin e markimit nuk janë sipas procedurës të përcaktuar në kontratë, nuk garantohet përqendrimi i duhur (nuk ndodh homogjenizimi) i markuesit në lëndën djegëse si dhe nuk bëhen prova apo të merren mostra për të verifikuar nëse përqendrimi i markuesit është sipas normave të përcaktuar në marrëveshje, problematika funksionale këto, të prezantuara edhe nga ana e DPD-së.

Investimet nuk janë kryer sipas Planit të Investimeve të deklaruara nga shoqëria koncesionare. Sa më sipër në kundërshtim me VKM nr. 200, dt. 13.03.2013 *“Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve”* të lidhur midis MFE dhe bashkimit të përkohshëm të “G. F. I.” S.A dhe “P. C. P” A. G, i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3.2) faqe 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**16.1.Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masat për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga MFE dhe DPD, me qëllim (i) kryerjen e një vlerësimi të plotë mbi ecurinë e zbatimit të kontratës koncesionare edhe monitorimin e komponentëve të saj, (ii) evidentimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në përmbushjen e detyrimeve nga ana e shoqërisë koncesionare, si dhe (iii) përlllogaritjen e impaktit financiar të këtyre mos përmbushjeve nga ana e shoqërisë koncesionare, në raport me propozimin.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zhvillimit të auditimit në terren, në lidhje me amendimin e kontratës koncesionare, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion Urdhri i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 202 datë 29.07.2022, *“Mbi caktimin e personit përgjegjës në emër të AK me qëllim përgatitjen e procesit të transferimit dhe marrjen në dorëzim të asetëve të kontratës koncesionare për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve”* dhe memoja nr.17543/1 datë 01.11.2022.

Me anë të observacioneve nga personat përgjegjës nuk është përcjellë praktika e ndjekur nga titullari i AK për marrjen e masave konkrete në lidhje me pamundësinë e ushtrimit të detyrave të urdhrit nr.222 datë 23.09.2022.

Pamundësia e përmbushjes së detyrave të caktuara i është komunikuar titullarit të AK me vonesë të pajustificuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4.1) faqe 52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**17.1.Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masat për analizimin e situatës duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse në parregullsitë e evidentuara për këtë kontratë, duke ndërmarrë masa të menjëhershme ligjore për eliminimin e tyre, si dhe shqyrtimin e mundësive reale për hartimin e dokumentacioneve sqaruese/plotësuese sipas rastit, me efekte deri në përfundim të afatit të projektit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**